# PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL 2025 – 2033

# KOMUNA KAMENICË

[Maj 2025]

**TABLE OF CONTENTS**


1. Hyrje
1.1. Qëllimi i planit zhvillimor komunal
1.2. Lista e kontribueseve
1.2.1. Anëtarët e Ekipit Komunal për Planifikim
1.3. Vendimet kyçe te KK te Kamenicës qe ndërlidhen me PZHK-në 1
1.4. Korniza Strategjike 1
Strategjitë sektoriale dhe planet e mëparshme komunale 1
Plani Hapësinor i Kosovës 1
1.5. Procesi i pjesëmarrjes publike 1
2. Profili i komunës 2
2.1. Të dhënat bazë 2
2.1.1. Historiku 2
2.1.2. Pozita dhe gjeografia fizike 2
2.2. Demografia 2
2.2.1. Zhvillimi Demografik 2
2.2.2. Projeksionet e popullsisë 3
2.2.3. Vlerësimi i gjendjes 3
2.3. Ekonomia 3
2.3.1. Ndërmarrjet 3
2.3.2. Punësimi 3
2.3.3. Vlerësimi i gjendjes: Ndërmarrjet & Punësimi 3
2.3.4. Bujqësia 3
2.3.5. Pyjet 4
2.3.6. Industria 4
2.3.7. Vlerësimi i gjendjes: Bujqësia 4
2.3.8. Infrastruktura dhe Furnizimi me ujë 4
2.3.9. Infrastruktura e kanalizimit 4
2.3.10. Vlerësimi i gjendjes: kanalizimi 4
2.3.11. Infrastruktura e energjisë elektrike 4
2.3.12. Vlerësimi i gjendjes: energjisë elektrike 4
2.3.13. Infrastruktura dhe shërbime e telekomunikacionit 4
2.3.14. Vlerësimi i gjendjes: telekomunikacioni 4
2.3.15. Menaxhimi i mbetjeve 5
2.3.16. Vlerësimi i gjendjes: mbetjet 5
2.4. Infrastruktura dhe shërbimet e transportit 5
2.4.1. Transporti rrugor 5
2.4.2. Infrastruktura për këmbësorë dhe biçikleta 5
2.4.3. Linjat transportuese nderkomunale, urbane dhe rurale 5
2.4.4. Hapësirat ekzistuese për parkim 5
2.4.5. Vlerësimi i gjendjes: Transporti 5
2.5. Infrastruktura dhe shërbimet sociale e publike 5
2.5.1. Institucionet shëndetësore 5
2.5.2. Institucionet arsimore 6
2.5.3. Institucionet kulturore 6
2.5.4. Institucionet sportive dhe rekreative 6
2.5.5. Hapësira të Hapura Publike 6
2.5.6. Institucionet e Mirëqenies Sociale dhe Komunitetit 6
2.5.7. Institucionet fetare 6
2.5.8. Ndërtesat e administratës dhe sigurisë 7
2.5.9. Varrezat Publike 7

2.5.10. Vlerësimi i gjendjes ........ 7
2.6. Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri ........ 7
2.6.1. Sipërfaqet me rrezikshmëri ........ 7
2.7. Trashëgimia kulturore, arkitekturale dhe arkeologjike ........ 8
2.7.1. Trashëgimia arkitekturale ........ 8
2.7.2. Trashëgimia arkeologjike ........ 8
2.7.3. Trashëgimia shpirtërore ........ 8
2.8. Trashëgimia natyrore – monumentet natyrore ........ 8
2.8.1. Biodiversiteti ........ 8
2.9. Ndikimi hapësinor dhe mundësitë e zhvillimit nga asetet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore ........ 8
2.10. Vlerësimi i gjendjes ........ 8
2.11. Vendbanimet ........ 9
2.11.1. Vendbanimet sipas karakterit ........ 9
2.11.2 Vendbanimet sipas funksionit ........ 9
2.11.3. Vendbanimet sipas madhësisë (numrit të banorëve) ........ 9
2.11.4. Vendbanimet sipas lartësisë mbidetare ........ 9
2.11.5. Trendi i zhvillimit të vendbanimeve ........ 9
2.11.6. Ndërtimet pa leje ........ 9
2.11.7. Vendbanimet joformale ........ 9
2.11.8. Vlerësimi i gjendjes: Vendbanimet ........ 9
2.12. Shfrytëzimi i tokës ........ 9
2.12.1. Projeksionet e shfrytëzimit të tokës në raport me PZHK-në e fundit të komunës ........ 10
2.13. Banimi ........ 10
2.13.1. Fondi i banimit ........ 10
2.13.2. Shfrytëzimi i njësive të banimit ........ 10
2.13.3. Kushtet e banimit ........ 10
2.13.4. Trendet e ndërtimit dhe çmimet mesatare për njësi banimi ........ 10
2.13.5. Banimi Social ........ 10
2.13.6. Dendësia e banimit ........ 10
2.14. Vlerësimi i gjendjes: Banimi ........ 10
2.15. Vlerësimi i kapaciteteve administrative ........ 10
2.15.1. Kapacitetet financiare ........ 10
2.15.2. Korniza afatmesme buxhetore komunale (KAB) ........ 11
2.15.3. Investimet kapitale ........ 11
2.16. Vlerësimi i Kapaciteteve investive ........ 11
3. Korniza e zhvillimit hapësinor ........ 11
3.1. Korniza e zhvillimit hapësinor ........ 11
3.2. Qëllimet dhe objektivat zhvillimore ........ 11
3.2.1. Infrastruktura publike ........ 11
3.2.2. Infrastruktura sociale (kultura, sporti, hapësirat publike, varrezat) ........ 11
3.2.3. Trashëgimia kulturore dhe natyrore, mjedisi dhe fatkeqësitë natyrore ........ 11
3.2.4. Ekonomia ........ 11
3.2.5. Vendbanimet dhe Banimi ........ 11
3.2.6. Infrastruktura dhe shërbimet e transportit ........ 11
3.2.7. Infrastruktura teknike ........ 12
3.3. Koncepti i zhvillimit hapësinor ........ 12
3.3.1. Skenarët e propozuar ........ 12
3.3.2. Elementet e konceptit ........ 13
3.3.3. Tërësitë hapësinore ........ 13
3.3.4. Zhvillimet sipas sektorëve ........ 12

4. Prioritetet strategjike zhvillimore dhe plani i veprimit 15
4.1. Prioritetet strategjike 15
4.2. Plani i veprimit 15
5. Zbatimi dhe monitorimi i planit 16
5.1. Dispozitat për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së 16
5.1.1. Dispozitat mbi rendin kronologjik apo etapat e implementimit 16
5.1.2. Dispozitat lidhur me bashkëpunim 17
5.1.3. Hyrja në fuqi 17
5.1.4. Vlefshmëria 17
5.1.5. Vlerësimi 17

Harta 1 Pozita Gjeografike e Komunës së Kamenicës 24
Harta 2 Shpërndarja e ekonomive familjare sipas vendbanimeve 28
Harta 3 Dendësia e popullsisë sipas vendbanimeve 29
Harta 4 Harta e bonitetit të tokës 36
Harta 5 Mbulimi më shërbime të ujësjellësit në komunë 44
Harta 6 Mbulueshmëria me rrjet të kanalizimit 46
Harta 7 Rrjeti i energjisë elektrike 48
Harta 8 Rrjeti i telekomunikacionit 50
Harta 9 Mbulueshmëria me shërbim 51
Harta 10 Rrjeti rrugor 53
Harta 11 Rrjeti rrugor i asfaltuar, dhe i pa-asfaltuar 53
Harta 12 Harta e parkingjeve ne qytetin e Kamenicës 57
Harta 13 Objektet shëndetësore 60
Harta 14 Objektet Arsimore 62
Harta 15 Objektet Sportive 64
Harta 16 Harta e institucioneve të mirëqenies dhe komunitetit 67
Harta 17 Institucionet publike dhe sociale 71
Harta 18 Harta e varrezave dhe objekteve fetare 73
Harta 19 Zonat e rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësive tjera 77
Harta 20 Erozionet 78
Harta 21 Shpërndarja hapësinore e aseteve të trashëgimisë kulturore 83
Harta 22 Vendbanimet 91
Harta 23 Trendi i ndërtimeve 1970 – pas vitit 2006 96
Harta 24 Kufijtë ndërtimor të vendbanimeve 97
Harta 25 Ndërtimet pa leje në komunë 97
Harta 26 Shfrytëzimi ekzistues i tokës 99
Harta 27 Dendësia e popullsisë për km$^2$ 104
Harta 28 Ndërtimet me leje 105
Harta 29 Harta e Konceptit të Zhvillimit Hapësinor 135
Harta 30 Harta e tërësive hapësinore 136
Ne vijim, janë radhitur hartat e planifikuara te Planit Zhvillimor komunal 2025-2033: Harta 31 Harta e tërësive hapësinoreHarta 32 Harta e zhvillimit hapësinor të planifikuar 139
Harta 33 Harta e shfrytëzimit të planifikuar të tokës_ZONA URBANE 140
Harta 34 Harta e shfrytëzimit të planifikuar të tokës_Komuna Kamenicë 140
Harta 35 Harta e planit të zhvillimit ekonomik 141

Harta 36Harta e planit të infrastrukturës së transportit ........ 141
Harta 37 Harta e planit të transportit urban dhe rural ........ 142
Harta 38Harta e planit të energjisë elektrike dhe termike ........ 142
Harta 39Harta e planit të hapësirave sportive ........ 143
Harta 40Harta e planit të hapësirave të hapura publike dhe të gjelbra ........ 143
Harta 41 Harta e planit për menaxhimin e mbeturinave dhe riciklim ........ 144
Harta 42 Harta e planit për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore ........ 144
Harta 43 Harta e planit për mbrojtjen nga rreziqet natyrore ........ 145
Harta 44 Harta e planit të ujësjellësit dhe kanalizimit ........ 145
Harta 46 Harta e sistemit të ujitjes dhe drenazhimit ........ 146
Harta 47 Harta e planit të hapësirave publike dhe sociale ........ 146
Harta 48 Harta e planit të menaxhimit të varrezave ........ 147
Harta 49Harta e planit të telekomunikacionit dhe instalimeve të ngjashme ........ 147
Harta 50 Harta e planit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore ........ 148

Tabela 1 Koncepti zhvillimit nga Plani Hapësinor i Kosovës, 2010 – 2020+ ........ 18
Tabela 2 Numri i popullsisë 1948 - 2021 në komunën e Kamenicës ........ 26
Tabela 3Të dhënat nga regjistrimet e popullsisë në periudhat prej vitit 1948 – 2011 ........ 27
Tabela 4 Struktura e popullsisë sipas grup-moshave dhe gjinisë ........ 27
Tabela 5 Grup moshat, numri dhe % ........ 28
Tabela 6 Popullsia sipas përgatitjes shkollore ........ 30
Tabela 7Projeksionet e popullsisë ........ 30
Tabela 8 Projeksionet e popullsisë sipas vendbanimeve ........ 32
Tabela 9 Numri ndërmarrjeve ekonomike sipas aktiviteteve dhe madhësia e tyre ........ 34
Tabela 10 Boniteti i tokave – klasa II deri VII ........ 37
Tabela 11 Vendbanimet që furnizohen me ujë të pijes nga burimet nëntokësore të cilat shfrytëzohen përmes puseve ........ 42
Tabela 12 Vendbanimet me shërbim të ujësjellësit qe ofrohet nga KRU Hidromorava ........ 43
Tabela 13 Gjendja e ofrimit me ujësjellës në komunë ........ 44
Tabela 14 Trendi i prodhimit të ujit ne m³ për vitet 2013 deri 2022 ........ 45
Tabela 15 Vendbanimet që kanë qasje në rrjet të kanalizimit ........ 45
Tabela 16 Tabela Numri i konsumatorëve të KEDS ........ 48
Tabela 17 Institucionet shëndetësore në komunën e Kamenicës ........ 59
Tabela 18 Institucionet arsimore në komunë ne Kamenicës ........ 62
Tabela 19 Objektet sportive ........ 65
Tabela 20 Hapura Publike sipas tipologjisë ........ 65
Tabela 21 Sipërfaqet e ndërtuara dhe te tjera ........ 65
Tabela 22 Institucionet e mirëqenies sociale dhe komunitetit ........ 66
Tabela 23 : Lista e objekteve fetare/xhamive - funksionale ........ 69
Tabela 24 Lista e objekteve fetare/xhamive – funksionale (jo-funksionale) ........ 70
Tabela 25 Inventari i institucioneve administrative regjistri sipas vendbanimeve, 2018 ........ 70
Tabela 26 Vlerësimi i nevojave hapësinore për administratë bazuar në kërkesën e NTPH prej 0.60m2/banorë ........ 71
Tabela 27 Sipërfaqet ekzistuese te varrezave ........ 73
Tabela 28 Sipërfaqja e tokës sipas kategorisë së shfrytëzimit të tokës - HILUCS ........ 101
Tabela 29 Numri i ekonomive familjare dhe njësive të banimit ........ 102
Tabela 30 Tipologjia e ndërtesave të banimit ........ 102

Tabela 31 Njësitë e pabanuara në Kosovë dhe Kamenicë ........ 103
Tabela 32 Krahasimi i dendësisë së banimit me dendësinë nga normat e planifikimit ........ 106
Tabela 33 Struktura e Buxhetit sipas burimeve te Financimit, 2023 ........ 108
Tabela 34 Pasqyra dhe trendët e planifikimit te buxhetit sipas kategorive ekonomike, 2019- 2023 109
Tabela 35 Projeksioni i buxhetit total të komunës sipas kategorisë së shpenzimeve ........ 110
Tabela 36 Struktura e shpenzimeve buxhetore, sipas klasifikimit ekonomik 2022 ........ 111
Tabela 37 Trendi i parashikimit të hyrave vetanake komunale ........ 112
Tabela 38 Shfrytëzimi i tokës (gjendja ekzistuese dhe e propozuar) ........ 149
Tabela 39 Skema e monitorimit të zbatimit të veprimeve ........ 170
Tabela 40 Matrica e monitorimit dhe vlerësimit ........ 171

## LISTA E AKRONIMEVE DHE SHKURTESAT

| | |
|---|---|
| AKP | Agjencia Kosovare e Privatizimit |
| AKK | Asociacioni i Komunave të Kosovës |
| ASK | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| BB | Banka Botërore |
| BE | Bashkimi Evropian |
| BKK | Buxheti i Konsoliduar i Kosovës |
| BPV | Bruto Produkti i Vendit |
| ESK | Enti Statistikor i Kosovës |
| FMN | Fondi Monetar Ndërkombëtar |
| GND | Të ardhurat nacionale në dispozicion |
| HZK | Harta Zonale Komunale |
| IKMN | Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës |
| IPH | Instituti për Planifikim Hapësinor |
| IVE | Indeksi i varfërisë më ekstreme |
| IZhNj | Indeksi i zhvillimit njerëzor |
| KAB | Kornizën Afatmesme Buxhetore |
| KKS | Kuvendi Komunal i Kamenicës |
| KURK | Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit |
| MMPH | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor |
| MBPZhR | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural |
| NVM | Ndërmarrje të vogla dhe të mesme |
| OBSH | Organizata Botërore e Shëndetësisë |
| OJQ | Organizata joqeveritare |
| PRrH | Plani Rregullues i Hollësishëm |
| PZHK | Plani Zhvillimor Komunal |
| PZHU | Plani Zhvillimor Urban |
| QRTK | Qendra Regjionale e Trashëgimisë Kulturore |
| VJF | Vendbanime Jo Formale |
| ZGjC | Zyre e Gjendjes Civile |
| ZKL | Zyra e Komuniteteve Lokale |

# 1. Hyrje

## 1.1. Qëllimi i planit zhvillimor komunal

Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, Komuna është ligjërisht e detyruar që të hartojë Planin Zhvillimor Komunal, një plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet zhvillimore afatgjata për:

- Zhvillim ekonomik;
- Mjedis dhe sipërfaqet me rrezikshmëri;
- Infrastrukturë teknike;
- Vendbanimet;
- Infrastrukturë e transportit dhe transporti;
- Vendbanimet Joformale (VJF)
- Infrastrukturë publike dhe sociale;
- Shfrytëzimin e tokës;
- Asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike;

Ky plan strategjik multi-sektorial përcakton vizionin, parimet, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik për tetë (8) vitet e ardhme, bazohet në shqyrtimin dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese, aspiratat e qytetarëve dhe palëve të cilat janë të interesuara të investojnë në Komunën e Kamenicës dhe është përgatitur në përputhje me kërkesat ligjore të Udhëzimeve Administrative vijuese në fuqi:

- UA për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor;
- Udhëzim Administrativ Mbi Normat Teknike Të Planifikimit Hapësinor; dhe
- UA mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal.

Ky Plan Zhvillimor Komunal është përgatitur nën udhëheqjen e koordinatorit, Drejtorisë për Urbanizëm dhe drejtorive të tjera përkatëse komunale dhe në përputhje me Planin Hapësinor të Kosovës, i cili përcakton kornizën e përgjithshme zhvillimore për Komunën e Kamenicës. Për këtë qëllim janë mbajtur një varg seminaresh, ku janë diskutuar propozimet e planifikimit me ekipin ndër-disiplinor.

Ky Plan bazohet në njohuritë e ekspertëve të disiplinave të ndryshme shkencore. Plani Zhvillimor Komunal siguron zhvillimit hapësinor dhe këshilla të mëtutjeshme për çështjet themelore të planifikimit. Pas aprovimit të tij nga komuna, Plani Zhvillimor Komunal do të luajë një rol vendimtar në tërheqjen dhe orientimin e investimeve publike, private, publiko-private dhe komerciale. Për më tepër, ky dokument do të shërbejë si bazë për hartimin e kushteve zhvillimore dhe ndërtimore të Hartës Zonale të Komunës.

Plani Zhvillimor Komunal i Kamenicës do të sigurojë një kornizë të zhvillimit afatgjatë të Komunës dhe qytetit, duke përcaktuar qëllimet afatgjate zhvillimore dhe duke identifikuar prioritetet strategjike që synojnë:

- një ekonomi të zhvilluar me më shumë vende të reja të punës,
- zhvillim të përparuar social dhe mundësi të barabarta për të gjithë

- mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit te vet, resurseve natyrore dhe kulturore
- infrastrukturë të integruar dhe shërbime efikase për qytetarët

Plani Zhvillimor Komunal përcakton alokimin e resurseve financiare dhe njerëzore të komunës. Për shkak të karakterit strategjik dhe multisektoral, ai është i orientuar kah veprimi dhe tenton t'i minimizojë konfliktet në mes të sektorëve të ndryshëm të jetës në Komunë, dhe të maksimalizojë sinergjitë.

Procesi i hartimit të PZhK-së është shoqëruar vazhdimisht me shqyrtime publike dhe takime në nivel qendror e vendor, sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ Nr.05/2014 për Përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut Në Planifikim Hapësinor, të cilat i kanë shërbyer grupit të punës në përpilimin dhe Vizionit për zhvillimin e ardhshëm të territorit të Kamenicës. Plani Zhvillimor Komunal është një dokument që përcakton Vizionin për të ardhmen, kornizën e zhvillimit hapësinor, strategjitë dhe masat për zbatim të zhvillimit hapësinor në territorin e Komunës të Kamenicës, për periudhën e 2023-2031, duke u bazuar në vlerësimin e gjendjes ekzistuese.

Një ndër qëllimet e projektit është të promovojë planifikimin e integruar, i cili fillimisht integron planifikimin hapësinor dhe zhvillimor duke adresuar çështjet zhvillimore në fushat kryesore. Planifikimi i integruar përfshin bashkimin e niveleve të ndryshme të planifikimit duke përmirësuar efikasitetin e planifikimit zhvillimor Komunal. Plani Zhvillimor Komunal (PZHK), do të luanë një rol të rëndësishëm në ofrimin e bazës për tërheqjen dhe orientimin e investimeve në Komunë. Korniza e propozuar e zhvillimit hapësinor të komunës së Kamenicës bazohet në rezultatet e hulumtimeve të bëra në fazën e parë të procesit - Profilin e zhvillimit hapësinor të Kamenicës si dhe në dokumentet udhëzuese të zhvillimit hapësinor të nivelit qendror – Plani Hapësinor i Kosovës, Udhëzimet Administrative për hartimin e planeve Komunale si dhe Analiza Hapësinore e Komunës së Kamenicës, të hartuara nga Instituti i Planifikimit Hapësinor të Kosovës në MMPH.

## 1.2. Lista e kontribueseve

### 1.2.1. Anëtarët e Ekipit Komunal për Planifikim

| | |
|---|---|
| Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor | Uran Berisha |
| | Ilir Kastrati |
| | Mehmet Thaçi |
| | Muhamet Thaçi |
| | Shaban Kastrati |
| | Mexhid Zylfiu |
| | Hasan Rapuca |
| | Arif Skoverqani |
| Drejtoria e Pronës , Kadastrit dhe Gjeodezisë | Fadil Hoti |
| | Ramush Ismajli |
| Drejtoria e Arsimit | Afrim Dervishi |
| | Visar Dermaku |
| Drejtoria e Buxhetit dhe Financave | Ardita Dërmaku |
| | Selami Zylfiu |

| | |
|---|---|
| Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural | Shpend Morina |
| | Bektesh Dermaku |
| Drejtoria e Shërbime Publike, Ambient & Inspektorat | Hyseni Jerliu |
| | Fitim Lenjani |
| Drejtoria e Ekonomisë, Zhvillimit dhe Diasporës | Qëndresa Kastrati |
| Drejtoria e Mbrojtjes dhe Shpëtimit | Florentina Kryeziu Dërmaku |
| Drejtoria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit, | Petrit Matoshi |
| | Shehat Rrudhani |
| Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale | Eurona Hoda |
| | Durim Biqkaj |
| Drejtoria e Administratës së Përgjithshme | Fisnik Kastrati |
| | Hyrije Dërvodeli |

Kompanitë Publike

| | |
|---|---|
| KEDS | Ragmi Hoda |
| Hidromorava | Sherif Thaçi |
| PTK | Xhevat Krasniqi |
| Eko-Higjiena | Shejnaze Masurica |

Konsulentët

| | |
|---|---|
| Konsulent - Planer Urban | Dukagjin Bakija |
| Konsulent - Planer Urban | Sadije Deliu |
| Ekspert i GIS-it | Idriz Shala |
| Konsulent per hartim dhe planifikim te projekteve | Vildane Maliqi |
| Konsulent për hartim dhe zbatim te projekteve | Leotrim Spahiu |
| Konsulent për hartimin e projekteve | Kelmend Kastrati |
| Konsulent për hartim dhe planifikim te projekteve | Vjollcë Kryeziu |

1.2.2 Anëtarët e Ekipit Këshillues te Komunitetit (EKK)

Përfaqësuesit nga bashkësitë lokale të komunës, etj.,:

| | |
|---|---|
| Ruzhdi Qehaja | Këshilli Lokal-Qendra Kamenicë, Rubovci |
| Murat Demaj | Këshilli Lokal-Lagjja Malësia-Kamenicë, Tugjec, Gmicë, Zajqec, Meshinë |
| Agim Maliqi | Këshilli Lokal-Lagjja Iliria-Kamenicë |
| Burim Imeri | Këshilli Lokal-Lagjja Çamëria-Kamenicë, Hajnoc |
| Sinan Morina | Këshilli Lokal-Hodonoc |
| Ilir Tahiri | Këshilli Lokal-Berivojcë |
| Isuf Canaj | Këshilli Lokal-Koretin |
| Mumin Zubaku | Këshilli Lokal-Topanicë, |
| Xhavit Ajeti | Këshilli Lokal-Petroc, |
| Rabit Kastrati | Këshilli Lokal-Karaqevë e Epërme, |

| | |
|---|---|
| Selver Lenjani | Këshilli Lokal-Karaqevë e Poshtme, |
| Jeton Kryeziu | Këshilli Lokal-Rogoçicë, |
| Albert Thaqi | Këshilli Lokal-Muçiverc, Dajkoc, Qarakoc, Krenidel |
| Islam Rexhepi | Këshilli Lokal-Shipashnicë e Poshtme |
| Rabit Dërmaku | Këshilli Lokal-Shipashnicë e Epërme, |
| BojanStojanovic | Këshilli Lokal-Boscë, Grizimë, Strelicë, Moqar, Bratiloc, Feriqevë, Konstadincë |
| Sejdi Latifaj | Këshilli Lokal-Hogosht, Dazhnicë, Poliqkë, Marovcë, Vriqec, Velegllavë e epërme, Lisockë, Zhujë, Shahiq, Gjyrishec |
| Endrit Beqiri | Këshilli Lokal-Kopërnicë, Kolloleq |
| Besim Cakolli | Këshilli Lokal-Strezoc, Krilevë, Leshtar, Vaganesh, Rahovicë, Kremenatë I, Kremenatë II, Gragjenik |
| Feim Maliqi | Këshilli Lokal-Busavatë |

Përfaqësuesit nga shoqëria civile:

| | |
|---|---|
| Lavdim Klaiqi | OJQ ProActive |
| Sherafedin Vranja | OJQ DardanaPress |

Përfaqësuesit nga grupet fetare:

| | |
|---|---|
| Hoxhë Bujar Fera | Bashkësia Islame |
| Protojerej, Srdjan Milenkovic | Kisha Ortodokse |

Përfaqësuesit nga shoqatat profesionale dhe bizneset:

| | |
|---|---|
| Mitat Jerliu | Shoqata e Bletareve |
| Hamit Pireva | Shoqata e Pronareve te Pyjeve Private |
| Nexhmije Kallaba | Biznes Kosova Tourism |

Ekspertet e fushave:

| | |
|---|---|
| Imran Morina | Arkitekt |
| Refik Latifaj | Gjeolog |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

KUVENDI I KOMUNËS-KAMENICË
Më:03.05.2016

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 shkronja d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008), nenit 46, paragrafi 46.2, pika a) të Statutit të Komunës së Kamenicës, nenit 12 të Rregullores Nr.01/2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunave si dhe propozim-vendimit Sh.02, Nr.12320, të datës 28.04.2016 , Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë: 29.04.2016 mori:

**VENDIM**

1. **Shfuqizohet** vendimi Sh.01, Nr.21438 i datës:15.07.2015-të për Lejimin e Revidimit të Planit Zhvillimor Komunal Sh.01, Nr15525 i datës: 08.05.2014-të.
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës së Kamenicës.

**Vendimi iu dërgohet:**
1x1 Kryetarit të Komunës
1x1 Kryesuesit të Kuvendit
1x1 MAPL-së
1x1 Shërbimit profesional të K.K-së
1x1 Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapsinor
1x1 Zyrës së përkthimeve

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Bujrush Dërmaku**

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria – Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Kabinet of the Minister*

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 08.03. 2024 |
| REFERENC-Ë: | 24/503/62/MMPHI |
| PËR/ZA/TO: | Komuna e Kamenicës |
| CC: | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| NGA/OD/FROM: | Liburn Aliu , Ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Vendim |

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka pranuar kërkesën nga Komuna e Kamenicës me nr.: 24/503/62/DMMU, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për Raportin për Vlerësim Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria – Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

***Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Kabinet of the Minister***

Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke u bazuar në nenin 93 paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 10 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratën Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7, 01 Mars 2019), nenin 11 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr.34/22 dt. 18.11.2022), Shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 13 të Ligjit për Vlerësim Strategjik Mjedisor Nr. 03/L-230 (Gazeta Zyrtare Nr. 83 / 29 tetor 2010 ), nxjerr:

## VENDIM

I APROVOHET kërkesa e Komunës së Kamenicës për paisje me Pëlqim Mjedisor për Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal.

## Arsyetim

Gjatë shqyrtimit të kërkesës së Komunës së Kamenicës, Komisioni për shqyrtimin e Raporteve të VSM-së i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka konstatuar se Komuna e Kamenicës ka ofruar të gjitha dokumentet e parapara me Ligjin Nr. 03/L-230 për Vlerësim Mjedisor si dhe i ka përmbushur të gjitha obligimet tjera ligjore përfshirë organizimin e debatit publik,





publikimin e Raportit të VSM në ueb faqen e Komunës për komente dhe trajtimin e komenteve të marura nga palët e interesit.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të të njejtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
Nr.: 24/503/ /24 datë: 08.03. 2024

Prishtinë

T'i dërgohet:
1. *Parashtruesit të kërkesës*
2. *Komisionit për VSM*
3. *Inspektoratit të MMPHI-së*
4. *Zyrës të Sekretarit të Përgjithshëm*
5. *Kabinetit të Ministrit*
6. *Arkivi i MMPHI*
7. *Divizionit për komunikim me publikun*
8. *Kuvendit të Komunës së Kamenicës*

z. Liburn Aliu
Ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.





PRISHTINË / A
503 2/24
11.03.24

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada-Government*

***Ministria e Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës***
***Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture***
***Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure***

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave/Departament za Zaštitu Sredine i Voda
Department of Environment Protection and Waters

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| REFERENCË: | 24/503/62/DMMU | | | | |
| PËR/ZA/TO: | Liburn Aliu , Ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. | | | | |
| CC: | Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI | | | | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMNI-së | | | | |
| NGA/OD/FROM: | Abdullah Pirçe, Kryesues i Komisionit për VSM | | | | |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Përgjigje kërkesës së Komunës së Kamenicës për VSM për PZHK 2023-2031 | | | | |
| Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.: | 1517 | Lokacioni: Kucni: Extension: | Ish Pallati i Mediave, Rilindja Prishtinë. | Data: Datum: Date: | 08.03. 2024 |
| PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION | | | | | ☐ |
| PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL | | | | | ☒ |
| PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE | | | | | ☒ |
| PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS | | | | | ☐ |
| VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION | | | | | ☐ |
| SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED | | | | | ☒ |
| SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED | | | | | ☒ |
| SHËNIM DHE PËRGJIGJE/ BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN | | | | | ☒ |
| PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION | | | | | ☐ |
| AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE | | | | | |



Komisioni për vlerësim e Raportit për Vlerësim Strategjik Mjedisor ka shqyrtuar kërkesën e Komunës së Kamenicës për paisje me Pëlqim Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal me Nr. prot. 24/503/62/DMMU. Gjatë shqyrtimit janë analizuar dokumentet e bashkangjitura kërkesës si: Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor, proces verbali nga Debati Publik, lista e pjesëmarrësve në debat si dhe dokumente tjera të bashkangjitura.

Bazuar në Ligjin për Vlerësim Strategjik Mjedisor Nr.03/L-230, Komisioni për VSM ka konstatuar se dokumentacioni i prezantuar i përmbushë kriteret e parapara me Ligjin Nr. 03/L-230 për Vlerësim Strategjik Mjedisor, dhe i propozon Ministrit që Komunës së Kamenicës të **i lëshohet Pëlqimi Mjedisorë** për Vlerësimin Strategjik Mjedisorë për Planin Zhvillimor Komunal.

Bashkëngjitur me mendim profesional e gjeni draft vendimin.

Komisioni:

Abdullah Pirçe, kryesues
Malsore Jonuzi, anëtare
Riza Muçolli, anëtar
Musli Kozhani, anëtar
Leonora Durmishi, anëtare

dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor do të bëjë hapja e shqyrtimit publik të Draft dokumentit të Planifikimit Hapësinor - Plani Zhvillimor Komunal e Komunës së Kamenicës.

**Neni 8**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor në Komunën e Kamenicës.

**Neni 9**

Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjete (15) ditë pas regjistrimit në zyrën protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal MAPL-ë, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

**Vendimi i dërgohet :** Kryetarit të Komunës , MAPL-së, DUPH-së, Shërbimit profesional të Kuvendit , zyrës për përkthime dhe QShQ-së.

**Liridon Kastrati**

**Kryesues i Kuvendit të Kamenicës**

**ARSYETIM**

Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor në Komunën e Kamenicës, pas pranimit të vendimit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vendimit SP-02 nr. 4633-2/24 të datës 27.09.2024 "Vendim për pëlqim për hapje të shqyrtimit publik, të projekt Planit Zhvillimor të Komunës së Kamenices 2024-2032", i ka propozuar zyrës ligjore të Kuvendit të Komunës së Kamenicës propozim vendimin për Hapjen e shqyrtimit publik për projekt Planin Zhvillimor të Komunës së Kamenices 2024-2032.

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Br. 06 Nr. 34982
Nr. i fab. 1 Data 05/11 2024
KAMENICË

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
**KOMUNA E KAMENICËS**
OPŠTINE KAMENICA MUNICIPALITY OF KAMENICA

Në bazë të nenit 3 , paragrafi 2, nënparagrafi 2.2, nenit 4 , paragrafi 3, pika 3.1 , nenit 5, nenit 6, nenit 7, nenit 8. nenit 10, nenit 11, nenit 12, nenit 13 dhe nenit 14 të **Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.05/ 2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të** planifikimit **hapësinor, si dhe parimet dhe procedurat për** pjesëmarjen e publikut në **planifikim hapësinor, Komuna e Kamenicës** organizon:

**SHQYRTIM PUBLIK**

**Për të gjithë qytetarët e Komunës së Kamenicës, grupet e interesit dhe palët e interesuara për shqyrtimin publik të Projekt-Planit Zhvillimor të Komunës së Kamenicës për vitet 2024-2032**

Ky dokument do të jetë në shqyrtim publik nga data **14.11.2024** deri më datën: **14.12.2024**, ndërsa prezantimi-konsultimi publik me qytetarë do të **mbahet me 14.11.2024**, në sallën mbledhjeve të Kuvendit Komunal (me fillim nga ora 16:00).

Pjesa grafike e PZHK së, në formatin letër, do të mbahet e ekspozuar gjatë kësaj periudhe 30 ditore në shtëpinë e kulturës (salla e bibliotekës së qytetit), ndërsa komentet dhe sugjerimet lidhur me dokumentin në fjalë mund t'i dërgoni deri më datë **14.12.2024** në e-mailin: uran.berisha@rks-gov.net

Për më shumë detaje për **Projekt - Planin Zhvillimor të Komunës së Kamenicës për vitet 2024-2032**, mund t'i vizitoni vegzat e mëposhtme:

Uebfaqen zyrtare:
https://kk.rks-gov.net/kamenice/category/konsultime-publike/

Facebook-un zyrtar:
https://www.facebook.com/KomunaKamenice/

Uran Berisha

Drejtor i Drejtorisw pwr Urbanizwm dhe Planifikim Hapwsinor

### 1.4. Korniza Strategjike

**Strategjitë sektoriale dhe planet e mëparshme komunale**

Gjatë përgatitjes së Planit Zhvillimor Komunal, EKP ka analizuar dhe ka analizuar Planin Zhvillimor Komunal 2013 – 2023+, Planin Zhvillimor Urban, Planet Rregulluese Urbane, Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023 – 2027, Planin Komunal për Menaxhim të Mbeturinave, dhe investimet kapitale të nivelit qendror dhe të komunave fqinje të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e komunës së Kamenicës. Të gjitha planet dhe strategjitë janë analizuar në raport me gjendjen ekzistuese ne terren, trendet dhe nevojat për zhvillim dhe potencialisht ndryshim të kahjes së zhvillimit për të arritur vizionin dhe qëllimet e PZHK-së.

**Plani Hapësinor i Kosovës**

Plani Hapësinor i Kosovës 2010 – 2020+ është dokument i planifikimit hapësinor, i përgatitur nga niveli i qeverisjes qendrore për të siguruar zhvillim të baraspeshuar dhe të qëndrueshëm për regjionet dhe komunat e Republikës së Kosovës. Të gjitha komunat janë të detyruara të i përmbahen zhvillimeve të planifikuara në Planin Hapësinor i Kosovës, Strategjia për Zhvillim Hapësinor, 2010 – 2020+, i cili mbështetet në vizionin vijues për të ardhmen:

*"Kosova vend sovran i integruar në Bashkësinë Evropiane me zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik, infrastrukturë dhe teknologji moderne, me mundësi arsimimi për të gjithë, fuqi punëtore të kualifikuar, një vend që ka respekt për mjedisin, trashëgimin natyrore dhe kulturore për tërë territorin e vet dhe vendet fqinje, me një shoqëri të hapur që e promovon llojllojshmërinë dhe shkëmbimin e ideve, duke respektuar të drejtat e të gjithëve".*[1]

Planit Hapësinor të Kosovës përcakton Strategjinë Zhvillimore Hapësinore për territorin e Republikës së Kosovës, që bazohet në: Zhvillimi i rrjetit të fuqishëm urban për zhvillim ekonomik; Zhvillimi dhe ruajtja e burimeve natyrore; dhe Zhvillimi i lidhjeve strategjike.

Strategjia për zhvillim hapësinor e Planit Hapësinor të Kosovës përcakton veçoritë karakteristike dhe zhvillimet e planifikuar të regjioneve kryesore në Kosovë.

[1] MMPH, Plani Hapësinor i Kosovës, Strategjia për Zhvillim Hapësinor, 2010 – 2020+, Prishtinë, 2010




Tabela 1 Koncepti zhvillimit nga Plani Hapësinor i Kosovës, 2010 – 2020+

Plani Hapësinor i Kosovës 2010 – 2020+ ka përcaktuar regjionin e Kamenicës si pjesë përbërëse e zonës "Urat e Kosovës- Hapësirë e Verdhë" që kanë këto përparësi dhe mundësi të zhvillimit:

- Traditë dhe trendi aktual i fuqishëm për tregti;
- Tradicionalisht hapësirë ku bashkëjetojnë, punojnë, me shkallë të lartë të tolerancës, grupe të ndryshme etnike;
- Hapësirë e cila në nuk është afektuar shumë nga pasojat e luftës së fundit, krahasuar me viset tjera në Kosovë;
- Mundësi për ndërtim të transportit efikas publik, për shkak të motorizimit ende jo të lartë,
- Trendi i ndërtimeve (banimit individual, kolektiv, afarist) dëshmi e potencialit investiv privat,
- Mundësi për orientimin e kapitalit privat drejt investimeve të rëndësishme sipas planeve zhvillimore;
- Toka kualitative, e përshtatshme për zhvillim të bujqësisë, industrisë përpunuese e shërbyese, agrobiznes;
- Prezenca e resurseve natyrore, rekreative, shëruese, të ujërave termal, mundësi për zhvillim të turizmit malor, rekreativ e shërues;

Për këtë zonë është paraparë zhvillimi i shërbimeve tregtare, agro-industriale dhe turistike. Komuna e Kaçanikut, Artanës, Vitisë, Kamenicës dhe Shtërpcës gjithashtu janë të përfshira në këtë zonë. Sipas Planit Hapësinor, "Urat e Kosovës - Hapësirë e Verdhë" kanë këto veçori:

- Tokë bujqësore të kualitetit të lartë;
- Resurse të ujërave minerale;
- Hapësira të lira të gjelbra;
- Aktivitete ekonomike tregtare, industriale dhe turistike - malore, transitore dhe shëndetësore.

Vizioni nga PHK parasheh një rol të rëndësishëm për Urat e Kosovës – Hapësira e verdhë si një lidhje ndërmjet Kosovës dhe vendeve fqinje, me synimet kryesore vijuese:

- Zhvillimi i rrjetit të vendbanimeve që siguron qasje të lehtë dhe kushte për jetë dhe punë atraktive në qytete të mëdha të Gjilanit, Kamenicës, si dhe nëpër fshatra të vogla;
- Mbështetja e ekonomisë së qëndrueshme të urbanizmit lokal;
- Konkurrencë në tregun e brendshëm dhe të jashtëm;
- Zhvillimi i infrastrukturës (transport rrugor, hekurudhor, ajror, teknologjia e informimit dhe komunikimit TIK) për të krijuar lidhje të përshtatshme ndër-urbane me pjesë të tjera të Kosovës dhe jashtë vendit.

### 1.5. Procesi i pjesëmarrjes publike

Komuna e Kamenicës bazuar në Ligjin për Planifikim Hapësinor ka filluar procesin e hartimit te PZHK-së. Procesi i hartimit ka filluar me vendimin për hartim të PZHK-së të marrë nga Kuvendi I komunës së Kamenicës me 25/11/2021. Bartës i procesit të hartimit të PZHK-së është përcaktuar Drejtoria për urbanizëm dhe mbrojtje mjedisi, të mbështetur nga drejtoritë tjera të komunës. Në proces të hartimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve, Komuna ka themeluar dy mekanizma:

· Ekipin Komunal për Planifikim (EKP) - të përbërë nga të gjitha drejtoritë e komunës së Kamenicës. EKP ka shërbyer si platformë për të mbledhë informata nga të gjitha drejtoritë dhe kompanitë publike në komunë, si dhe për të dhënë kontribut në përmbajtjen e PZHK në të gjitha fazat e hartimit të tij. Për më shumë EKP ka shërbyer për të harmonizuar kërkesat dhe projektet të gjithë sektorëve në komunë.

· Ekipin Këshillues të Komunitetit (EKK) – të përbërë nga të gjitha komunitetet në komunën e Kamenicës. Anëtarët e EKK-së janë përfaqësues të shoqërisë civile, minoriteteve, të rinjëve, grave, të moshuarve, personave më aftësi të veçanta, bizneseve, dhe kryetarë të bashkësive lokale e fetare. EKK ka shërbyer si urë lidhëse në mes të komunës dhe qytetarëve të komunës. Detyrë primare e EKK-së ka qenë komunikimi me qytetarë rreth përmbajtjes së PZHK-së në faza të ndryshme të hartimit.

**Më 07 tetor 2022** është mbajtur takimi fillestar për procesin, përmbajtjen dhe metodologjinë e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal në përputhje me Udhëzimin administrativ nga

MMPHI - nr. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal. Takimi u mbajt në prani të Kryetarit, Drejtorit dhe zyrtarëve nga të gjitha drejtoritë dhe Zyra e Kryetarit.

Sipas kërkesave ligjore, i gjithë procesi i hartimit të PZHK-së ka kaluar në katër faza kryesore: profili, vlerësimi i gjendjes, koncepti i zhvillimit hapësinor, si dhe prioritetet strategjike dhe plani i veprimit. Hartimi i të gjitha fazave është përcjellur me pjesëmarrje aktive të gjithë akterëve, përfshi edhe qytetarët e komunës. Punëtoritë për çdo fazë janë organizuar së bashku me EKP dhe EKK për të diskutuar përmbajtjet e çdo kaptine për fazat përkatëse të planit.

Kaptina e parë e profilit të PZHK është prezantuar dhe plotësuar nga EKK dhe EKP në **punëtorinë e parë dhe e dytë janë mbajtur më 15 dhe 16 mars 2023**. Punëtoritë janë udhëhequr nga grupi i ngushtë punues i planit. Metodologjia e punës në punëtori është bazuar në punë grupore, ku pjesëmarrësit janë ndarë në grupe bazuar në temat zhvillimore për të gjitha sektorët e komunës. Në ditën e parë është punuar në të gjeturat e gjendjes ekzistuese, ndërsa në të dytën, janë diskutuar dhe plotësuar sfidat zhvillimore, ku është bërë vlerësimi i gjendjes së komunës bazuar në të dhënat e EKP dhe problemeve të identifikuara nga qytetarët**.** Punëtoria ka shërbyer për të krahasuar të dhënat e mbledhura, gjendjen në terren dhe nevojat dhe problemet e qytetarëve nga pikëpamja e tyre.

**Në punëtorinë e tretë, të mbajtur me 26 prill 2023**, është diskutuar Koncepti i Zhvillimit të komunës së Kamenicës. Në këtë sesion së bashku me të gjithë akterët është hartuar bashkërisht deklarata e Vizionit, dhe janë elaboruar fillimisht skenarët për zhvillim si pjesë e Kornizës Zhvillimore. Për më shumë, janë diskutuar dhe plotësuar qëllimet dhe objektivat si mjet për zbatim të Vizionit të komunës.

**Më 17 maj 2023 është organizuar punëtoria e katërt**, ku edhe një herë janë diskutuar Vizioni, Prioritetet Strategjike dhe validuar skenarët dhe korniza për zhvillim, qëllimet dhe objektivat. Punëtoria ka shërbyer që të gjithë akterët të ofrojnë pikëpamjet e tyre finale rreth zhvillimit të përgjithshëm përmes politikave përkatëse të komunës.

**Në punëtorinë e fundit të organizuar me 20 korrik 2023** janë diskutuar dhe validuar prioritetet strategjike si dhe është hartuar **plani i veprimit të PZHK**. Në të njëjtën kohë, kjo punëtori ka shërbyer për komunën që të analizojë kapacitetet e tyre financiare në raport me prioritetet strategjike dhe veprimet për fushat e ndryshme.

I gjithë procesi i pjesëmarrjes në përgjithësi ka qenë dinamik, sepse qytetarët kanë qenë mjaft aktiv në proces të hartimit. Procesi i pjesëmarrjes karakterizohet me angazhim të qytetarëve dhe administratorëve të fshatrave edhe jashtë punëtorive të lartpërmendura, përmes takimeve në drejtori të urbanizmit varësisht prej kërkesave dhe problemeve të tyre specifike.

*Foto nga disa nga punëtoritë e organizuara*










**Shqyrtimi publik**

Shqyrtimi publik për Projekt – Planin Zhvillimor Komunal të Kamenicës 2025 – 2033 është zbatuar sipas procedurave ligjore të përcaktuara. KK Kamenicë fillimisht ka marrë vendim për pëlqim për hapjen e shqyrtimit publik, dhe më tutje ka vazhduar me njoftimin për hapjen e shqyrtimit publik.

Shqyrtimi publik ka qenë i hapur nga 14.11.2024 deri me 14.12.2024, dhe janë ftuar të gjitha grupet dhe palët e interesit. Prezantimi për publik i Projekt – PZHK 2024 – 2032 është bërë me datën 14.11.2024 në sallën e Kuvendit Komunal Kamenicë, dhe më tutje pjesa narrative dhe hrtografike ka qenë në dispozicion të publikut. Pjesa grafike e dokumentit – hartat e printuara kanë qenë të ekspozuara për 30 ditë në shtëpinë e kulturës (salla e bibliotekës së qytet), dhe në të njëjtën kohë libri zyrtar për komente dhe sugjerime ka qenë i qasshëm gjatë gjithë kohës në të njëjtën sallë. Përveç kopjeve fizike të pjesës narrative dhe hartave, qytetarët kanë mundur t'i qasen dokumentit në format digjital përmes uebfaqës dhe faqes së facebook-ut zyrtar të komunës. (https://kk.rks-gov.net/.../Projekt-PLANI-ZHVILLIMOR...).

Gjatë periudhës 30 ditore të shqyrtimit publik të PZHK-së, qytetarët kanë bërë 45 kërkesa me shkrim, ndër to 41 janë bërë përmes librit të shënimeve që është mbajtur për 30 ditë në sallën ku është publikuar materiali i PZHK-së, 4 kërkesa janë bërë përmes QSHQ-së, ndërsa 3 kërkesa palë i kanë dorëzuar mbas afatit 30 ditor. Palët kanë kërkuar ridestinim të gjithësejt 251 parcelave, ku për 160 parcela janë aprovuar, ndërsa për 91 parcela janë refuzuar. Arsyet e refuzimit apo aprovimit janë bazuar më detajisht janë dhënë në raportin e shqyrtimit publik.

Kërkesat që kanë dominuar nga palët gjatë shqyrtimit publik të PZHK-së kanë qenë kërkesat për destinim të sipërfaqeve për; turizëm rural, parqe solare, parqe të erës, zgjerim i kufinjëve të vendbanimeve (kryesisht malore), mihje sipërfaqësore, zona industriale, etj. Të gjitha këto dhe materialet nga mbajtja e punëtorive gjatë hartimit të PZHK-së janë të paraqitura në raportin e shqyrtimit publik.

Profili i komunës

## 1.6. Të dhënat bazë

### 1.6.1. Historiku

Emri i qytetit "Kamenica", përmendet në librin e borxhlinjve të Mikel Llukarit në vitet '30-të të shek. XV me emrin Chameniza. Pastaj, përmendet në defterin turk të Vilajetit Vëllk të Kamenicë 1455. Gjatë luftës së dytë botërore ishte pjesë e zonës okupuese bullgare, ndërsa në nëntor të 1944 ripushtohet nga Jugosllavia komuniste.

Në vitin 1959 Kamenica fiton statusin "Komunë", si njësi e barabartë me komunat tjera në vend.

### 1.6.2.Pozita dhe gjeografia fizike

Komuna e Kamenicës shtrihet në Lindje të Kosovës, e cila gjendet në qendër të Evropës Juglindore dhe ka një sipërfaqe prej 10,887 km$^2$. Kosova kufizohet me Shqipërinë,

Maqedoninë, Serbinë dhe Malin e Zi. Pozita gjeografike e Komunës së Kamenicës është perimerike në skajin më lindor të Kosovës por është urë lidhëse në mes të Kosovës dhe komunave të Serbisë Jugore kryesisht të banuara me shqiptar.

Komuna e Kamenicës shtrihet në Lindje të Kosovës dhe kufizohet në:

- Jug-Perëndim me komunën e Ranillugut;
- Perëndim me komunën Novobërdës;
- Veri-Perëndim me Prishtinën;
- Veri me Komunën e Medvegjës dhe Leskovcit;
- Lindje me Vrajën; dhe
- Lindje dhe Jug-Lindje me Bujanocin.

Nëpërmjet magjistrales Gjilan-Bujanoc, lidhet me qendrat tjera të Kosovës. Gjilani ndodhet në largësi 30 km, ndërsa distanca e Kamenicës nga kryeqendra e Kosovës, Prishtina është 40 km, kurse nga Kryeqyteti i Maqedonisë, Shkupi është 85 km. Distanca rrugore Kamenicë-Tiranë është 410 km, kurse me portin e Durrësit 440 km. Me Prishtinën mundë të lidhet edhe me rrugë më të shkurtër, nëpër Novobërdë dhe Llabjan, ku në të dy drejtimet rruga shkurtohet për 20-25 km.

Stacioni më i afërt Hekurudhor është në Ferizaj dhe Bujanoc. Aeroportet më të afërta janë ai i Prishtinës 90km dhe i Shkupit 130km. Lidhjet ajrore për Kamenicë realizohen përmes aeroportit “Adem Jashari” që është në largësi prej 85 km.

**Topografia**: Territori i komunës së Kamenicës gjendet në lartësinë mbidetare mbi 500m dhe ne këtë nivel gjendet një pjesë vendbanimeve, rrugëve, objekteve ekonomike dhe objekteve të tjera si dhe lumenjve me degët e tyre. Në aspektin topografik të përthyeshmërisë së terrenit pjesa qendrore dhe kryesisht pjesa fushore ka topografi të bute, ku ekuidistanca me dy izohipsave 10m është disa qindra metra, ndërsa pjesët lindore dhe perëndimore të komunës karakterizohet me përthyeshmëri të madhe të terrenit të përberë nga disa qindra rrjedhe ujore kryesisht të përkohshme.




Harta 1 Pozita Gjeografike e Komunës së Kamenicës

**Klima:** Komuna e Kamenicës ka klimë të mesme kontinentale, me verë të nxehtë dhe dimër të ftohtë. Temperatura mesatare e janarit është –1°C, ndërsa ajo e korrikut 21.50°C. Temperaturat maksimale absolute janë në muajin gusht +37°C, kurse minimale absolute janë në janar –32 °C. Reshjet atmosferike mesatarisht sillen prej 499 – 675 l/m2.

Në pjesët malore të Kamenicës ku lartësitë mbidetare janë mbi 1000 metra temperaturat janë më të ulëta dhe periudha vegjetative është më e vonshme. Klima në komunën e Kamenicës ndryshon edhe në pjesët e ndryshme të vendit, në pjesët veri-lindore dhe veri-perëndimore të Kamenicës kemi temperatura më të ulëta (për 3.0 Co) të reshura më shumë, kurse në pjesën jugore ku shtrihet lugina e lumenjve parametrat klimatik ndryshojnë.

Vlera mesatare vjetore e lagështirës relative është 76.8%. Muaji më i thatë është gushti 66%, kurse më me lagështi janë nëntori dhe dhjetori 84%. Sasitë mesatare vjetore të reshurave arrin ne 596l/m2, ndërkaq në zonën malore shtohen në 800 l/m2. Muajt më të pasur me shi janë nëntori dhe maji me 76.1 dhe 71.9 l/m2, kurse në viset malore muaji i dhjetorit me 101.0 l/m2. Muaji më i thatë është korriku dhe gushti. Erërat më të shpeshta janë ato veriore me dhe më të rrallat janë ato jug – perëndimore me , kurse shpejtësia mesatare e erës është 3m/sek.

**Hidrografia**: Territor i Komunës së Kamenicës në tërësi i takon derdhjes së lumit Morava e Binçës dhe atë rrjedhës së mesme. Karakterizohet me tre lumenj kryesor: lum burimor Krivareka, lumi i Hogoshtit dhe lumi i Desivojces. Lumi Krivareka buron në malet e Gollakut dhe deri në hyrje te fshatit Hajnovc i takon lumenjve me ndotje të kategorisë së parë (lum i pastër). Prej fshatit Hajnovc e deri ne hyrje të Kamenicës i takon shkallës së dytë (ndotje e lehtë). Pas daljes nga vendbanimi i Kamenicës e deri ne bashkim me lumin Morava i takon shkallës së dytë shndërrohet në lum me ndotje të kategorisë dytë (ndotje e lartë).

Shkarkimi i ujërave të zeza dhe industriale pa asnjë trajtim paraprak lëshohen në Lumin Krivareka dhe rritë shkallën e ndotjes së lumit. Lumi Hogosht është i pastër deri ne hyrje te vendbanimeve (ujëra burimore) pas shkarkimit të ujërave të zeza dhe hedhjeve të mbeturinave ne shtretërit e lumenjve kalon në shkallën e ndotjes dytë. Lumi i Desivojces deri ne vendbanimin e Shipashnicës se Epërme i takon shkalles se par te pastërtisë, nga aty e deri në Moravë i takon shkallës më të lartë të ndotjes. Shkarkimi i ujërave të zeza në rrjedhjet lumore pa trajtim paraprak rrit shkallën e ndotjes së lumenjve .

Qyteti i Kamenicës me shkarkon 6.5 l/s ose 47,671 $m^3$/vit ujëra të zeza të pa trajtuara. Në këtë shifër nuk janë llogaritur objektet shoqërore, industriale etj. Përveç shkarkimit të ujërave të zeza, lumenjtë ndoten dhe degradohen edhe nga mbeturinat e popullatës lokale dhe marrja e inerteve pa kriter.

## 1.7. Demografia

### 1.7.1. Zhvillimi Demografik

Analiza e zhvillimit demografik shqyrton të dhënat nga regjistrimet e popullsisë për periudhën e viteve 1948-2011. Vlen te theksohet qe regjistrimi i vitit 2011 ka regjistruar vetëm banorët e përhershme të komunës, duke mos i kalkuluar banorët e përkohshëm, studentët dhe të punësuarit të cilët përkohësisht jetojnë në komunë.

- **Numri i banorëve**

Regjistrimi i fundit i popullsisë, ai i vitit 2011 prezanton vetëm numrin e popullsisë rezidente. Sipas regjistrimit të vitit 2011, komuna e Kamenicës kishte 36 085 banorë.

Te dhënat nga regjistrimi paraqesin rritje graduale te popullsisë në komunën e Kamenicës nga viti 1948 deri ne vitin 1991 nga 29 937 banore ne 45 013, përderisa pastaj pason tkurrje graduale e popullsisë nga regjistrimi i vitit 1991 deri ne vitin 2011, respektivisht numri banoreve nga regjistrimi I fundit zyrtar bien ne 36 085 banorë. Fenomeni i urbanizimit te qyteteve që vërehet në shumicën e qyteteve në Kosovë, sidomos në periudhën e pasluftës, pra migrimi i brendshëm fshat-qytet - duket të jetë prezent edhe ne Komunën e Kamenicës, kjo dëshmohet edhe nga rritja e përqindjes (%) se pjesëmarrjes se qytetit në komunë, nga 2.53% ne vitin 1948 ne 20.32% ne vitin 2011.




Tabela 2 Numri i popullsisë 1948 - 2021 në komunën e Kamenicës

| Kamenicë | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Popullsia | 36'085 | 35'711 | 35'261 | 33'599 | 31'285 | 30'891 | 30'750 | 29'454 | 27'823 | 27'948 | 26'166 |

Tabela: Vlerësimi i popullsisë 2011 - 2021

| | Popullsia | | Ekonomitë Familjare (EF) | | Madhësia e Familjes | | Pjesëmarrja e qytetit në komunë (%) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Komuna | Qyteti | Komuna | Qyteti | Komuna | Qyteti | |
| 1948 | 29 937 | 756 | 4 268 | 197 | 7,0 | 3,8 | 2,53% |
| 1953 | 31 843 | 929 | 4 527 | 198 | 7,0 | 4,7 | 2,92% |
| 1961 | 34 064 | 1 298 | 4 896 | 303 | 7,0 | 4,3 | 3,81% |
| 1971 | 37 475 | 2 422 | 5 451 | 512 | 6,9 | 4,7 | 6,46% |
| 1981 | 40 325 | 5 383 | 6 118 | 1 046 | 6,6 | 5,1 | 13,35% |
| 1991[2] | 45 013 | 9 312 | 6 905 | 1 727 | 6,5 | 5,4 | 20,69% |

[2] Regjistrimi nga Entit Federativ te Statistikës në Beograd

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2011 | 36 085 | 7 331 | 6 419 | 1 400 | 5,6 | 5,2 | 20,32% |
| 2021 | 26 166 | | | | | | |

Tabela 3Të dhënat nga regjistrimet e popullsisë në periudhat prej vitit 1948 – 2011

- **Madhësia e familjes**

Nga regjistrimi I vitit 2011, madhësia mesatare e familjes në qytet del te jete pak më e vogël se në vendbanimet tjera ne komune. Në qytet mesatarisht familjet i kanë nga 5.2 anëtarë, përderisa në nivel te komunës i kanë 5.6 anëtarë.

- **Lëvizjet natyrore të popullsisë**

Të dhënat e shtimit natyror janë analizuar nga statistikat e lindjeve dhe vdekjeve në Kosovë për vitin 2021. Gjatë vitit 2021 në komunën e Kamenicës janë shënuar 428 lindje dhe 359 vdekje. Bazuar në këto të dhëna është llogaritur shkalla e natalitetit, mortalitetit dhe shtimit natyror në promilë dhe në përqindje. Shkalla e natalitetit në komunën e Kamenicës ka shënuar rënie të konsiderueshme në krahasim me periudhat e më hershme kohore dhe sot është 16.3 promil apo 1.63 %. Shkalla e mortalitetit është 13.72 promil apo 1.37 %. Në bazë të këtyre shkalleve të natalitetit dhe mortalitetit del se shtimi natyror i popullsisë në komunë është 2.6 promilë apo 0.26 %.




Tabela 4 Struktura e popullsisë sipas grup-moshave dhe gjinisë

- **Mosha dhe struktura gjinore e popullsisë**

Nga piramida e popullsisë vërehet se grup-moshat e reja 10 deri 14 vjeç, 15-19 vjeç dhe 20-24 vjeç kanë pjesëmarrje më të madhe në popullsinë e përgjithshme. Struktura e popullsisë sipas gjinisë në komunën e Kamenicës është 51.4% burra/djem dhe 48.6% gra/vajza. Popullsia aktive apo e aftë për pune, grup-mosha 15-64 vjeç përben shumicën e popullsisë me pjesëmarrje prej 67.2%, ndërsa grup-mosha e fëmijëve dhe rinjve 0-14 vjeç merr pjesë me 24.7% ,duke lënë pas grup-moshën 65 vjeç+ me pjesëmarrje të ulët në popullsinë e përgjithshme me vetëm 8.1%.

| Grup mosha | 0 - 9 | 10 - 19 | 20 - 29 | 30 - 39 | 40 - 49 | 50 - 59 | 60 - 69 | 70 - 79 | 80 + |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri | 5 389 | 7 263 | 6 074 | 5 282 | 4 644 | 3 293 | 2 196 | 145 | 494 |
| Si % | 14,9% | 20,1% | 16,8% | 14,6% | 12,9% | 9,1% | 6,1% | 0,4% | 1,4% |

Tabela 5 Grup moshat, numri dhe %




Harta 2 Shpërndarja e ekonomive familjare sipas vendbanimeve

- **Dendësia e popullsisë**

Komuna e Kamenicës ka një sipërfaqe prej 416.6 km², me një dendësi prej 84.2 banorë/km² që është nën mesataren në nivel vendi prej 163.2 banorë/km². Dendësinë më të lartë të popullsisë e ka qyteti me rreth 1045,8 banorë në km². Vendbanimet tjera me dendësi të madhe janë vendbanimet: Petroc (348,2 banorë në km²), Koretin (308.2 banorë në km²) dhe Topanicë (250.4 banorë në km²) dhe Rogaçice (231 banorë në km²). Dendësia më e vogël e popullsisë është në vendbanimet: Bratilloc, Gjyrishec, Feriqeve, Svircë, Zajçec, Gogolloc, Sedllar dhe Meshine, perderisa vendbanimet: Vaganesh, Kremenata I, Graxhenik, Kremeata II, Velegllave e Poshtme nuk janë të populluara.

- **Struktura etnike**

Në aspektin etnik, shqiptarët në komunën e Kamenicës përbëjnë shumicën e popullsisë (94.7%),  serb janë 4.3 % ndërsa etnitë tjera kanë pjesëmarrje shumë të vogël dhe së bashku përbëjnë vetëm 1% të popullsisë së përgjithshme të komunës së Kamenicës.




Harta 3 Dendësia e popullsisë sipas vendbanimeve

- **Niveli i arsimimit**

Niveli i arritur i arsimit merret si tregues bazë i gjendjes së përgjithshme të arsimit të një popullate. Në territorin e komunës së Kamenicës, nga popullsia e përgjithshme e moshës 10 vjeç e lart, sipas regjistrimit të popullsisë më 2011, afërsisht 4,54% ishin analfabetë. Prej tyre, gra/vajza janë në numër dukshëm më të madh, 3,62% në raport me burra/djem 0,92%.

| Popullsia (e moshës 10 vjeçare e më shumë) sipas përgatitjes shkollore | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | burra/ djem | Si % | gra/vajza | Si % | Gjithsej |
| Nuk dinë shkrim dhe lexim | 316 | 0,92% | 1 198 | 3,62% | 4,54% |
| Dinë shkrim dhe lexim | 904 | 2,64% | 1 085 | 3,28% | 5,92% |
| Nuk kanë përfunduar arsimin | 1 220 | 3,57% | 2 283 | 6,89% | 10,46% |
| Shkollë fillore | 2 215 | 6,48% | 3 244 | 9,80% | 16,27% |
| Mesëm të ulët | 4 832 | 14,13% | 5 827 | 17,60% | 31,73% |
| Të mesëm të lartë | 6 080 | 17,78% | 3 018 | 9,11% | 26,89% |
| Të diplomuar | 1 361 | 3,98% | 511 | 1,54% | 5,52% |
| Diplomë pasuniversitare (Master, PhD) | 81 | 0,24% | 24 | 0,07% | 0,31% |
| **Gjithsej** | **17 009** | **49,74%** | **17 190** | **51,91%** | |
| **Total te vlerësuar** | **34 199** | | | | |

Tabela 6 Popullsia sipas përgatitjes shkollore

### 1.7.2. Projeksionet e popullsisë

| Viti | Popullsia | Trendi | % |
|---|---|---|---|
| 2011 | 36 085 | ⬇ | -- |
| 2017 | 30 750* | ⬇ | - 14,78% |
| 2018 | 29 454* | ⬇ | - 4,21% |
| 2019 | 27 823* | ⬇ | - 5,54% |
| 2020 | 27 948* | ⬆ | + 0,45% |
| 2021 | 26'166 | ⬇ | |
| **2025** | **25 381**** | ⬇ | **- 3.00%** |
| **2032** | **25,127**** | ⬇ | **- 1.00%** |
| **Gjithsej popullsia e Kamenicës e vlerësuar, 2017-2021<br>**Projeksioni popullsisë 2022-2030* | | | |

Tabela 7Projeksionet e popullsisë

Metodologjia e hartimit të Planit Zhvillimor të Komunës së Kamenicës, ka adaptuar nocionin e popullatës rezidente, e cila është popullsia që zyrtarisht është e regjistruar dhe jeton në një territor të caktuar dhe diaspora, e cila është ekonomikisht shumë prezentë në Kamenicë, pavarësisht që fizikisht është prezentë më pak se grupet tjera shoqërore. Për të realizuar parashikimin e afërt të popullsisë për komunën e Kamenicës për periudhën 2022-2030, është analizuar dinamika e rritjes së popullsisë bazuar në trendët e fundit 2011-2021 të zhvillimeve demografike: nataliteti, mortalitetit, shtimi natyror, bilanci i migrimeve dhe potenciali i kthimit te diasporës.

Bazuar në të dhënat nga publikimet e vlerësimeve të popullsisë nga viti 2011 deri 2021 është llogaritur shkalla e natalitetit, mortalitetit dhe shtimit natyror në përqindje (%). Në bazë të këtyre shkalleve të natalitetit dhe mortalitetit del se shtimi natyror i popullsisë në komunë afatshkurtër është negativ -3.00%, me përmirësime tek -1% deri ne vitin 2032. Në bazë të këtyre të dhënave është bërë parashikimi i popullsisë për tetë vjeçarin e ardhshëm të komunës së Kamenicës me projeksion mesatar negative -2%.

| | Gjithsej | burra/djem | | gra/vajza | | Territori (km2) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Berivojcë | 1 553 | 796 | 2,2% | 757 | 2,1% | 8,11 |
| Bllatë | 35 | 22 | 0,06% | 13 | 0,04% | 1,19 |
| Boscë | 86 | 44 | 0,12% | 42 | 0,12% | 4,42 |
| Bratilloc | 29 | 16 | 0,04% | 13 | 0,04% | 4,35 |
| Busovatë | 804 | 440 | 1,22% | 364 | 1,01% | 10,66 |
| Dajkoc | 378 | 186 | 0,52% | 192 | 0,53% | 3,13 |
| Dazhnicë | 80 | 42 | 0,12% | 38 | 0,11% | 4,14 |
| Desivojcë | 177 | 88 | 0,24% | 89 | 0,25% | 16,14 |
| Feriqevë | 61 | 33 | 0,09% | 28 | 0,08% | 6,36 |
| Gmicë | 85 | 39 | 0,11% | 46 | 0,13% | 12,13 |
| Gogolloc | 10 | 6 | 0,02% | 4 | 0,01% | 2,35 |
| Gragjenik | 2 | 1 | 0,00% | 1 | 0,00% | 6,03 |
| Grizimë | 461 | 237 | 0,66% | 224 | 0,62% | 4,09 |
| Gjyrishec | 58 | 31 | 0,09% | 27 | 0,07% | 8,91 |
| Hajnoc | 460 | 236 | 0,65% | 224 | 0,62% | 13,73 |
| Hodonoc | 2 446 | 1 249 | 3,46% | 1 197 | 3,32% | 14,81 |
| Hogosht | 1 705 | 880 | 2,44% | 825 | 2,29% | 15,47 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Kamenicë** | **7 331** | **3 747** | **10,38%** | **3 584** | **9,93%** | **7,01** |
| Karaçevë e Epërme | 1 413 | 719 | 1,99% | 694 | 1,92% | 11,27 |
| Karaçevë e Poshtme | 940 | 486 | 1,35% | 454 | 1,26% | 4,32 |
| Kolloleq | 181 | 94 | 0,26% | 87 | 0,24% | 8,13 |
| Kopernicë | 1 183 | 615 | 1,70% | 568 | 1,57% | 8,33 |
| Koretin | 3 476 | 1 744 | 4,83% | 1 732 | 4,80% | 11,28 |
| Kostadincë | 48 | 28 | 0,08% | 20 | 0,06% | 5,26 |
| Kranidell | 131 | 64 | 0,18% | 67 | 0,19% | 9,86 |
| Kremenatë I | 7 | 4 | 0,01% | 3 | 0,01% | 6,89 |
| Kremenatë II | 0 | 0 | 0,00% | 0 | 0,00% | 2,16 |
| Krilevë | 586 | 301 | 0,83% | 285 | 0,79% | 16,85 |
| Lajçiqi | 160 | 84 | 0,23% | 76 | 0,21% | 9,19 |
| Leshtar | 446 | 228 | 0,63% | 218 | 0,60% | 4,91 |
| Lisockë | 98 | 54 | 0,15% | 44 | 0,12% | 7,95 |
| Marocë | 64 | 32 | 0,09% | 32 | 0,09% | 2,28 |
| Meshinë | 25 | 12 | 0,03% | 13 | 0,04% | 8,07 |
| Moçar | 113 | 59 | 0,16% | 54 | 0,15% | 6,30 |
| Muçivërc | 1 520 | 807 | 2,24% | 713 | 1,98% | 7,09 |
| Novosellë | 311 | 165 | 0,46% | 146 | 0,40% | 1,53 |
| Petroc | 1 257 | 647 | 1,79% | 610 | 1,69% | 3,61 |
| Poliçkë | 217 | 118 | 0,33% | 99 | 0,27% | 9,81 |
| Qarrakoc | 60 | 30 | 0,08% | 30 | 0,08% | 3,71 |
| Rahovicë | 42 | 26 | 0,07% | 16 | 0,04% | 4,82 |
| Rogaçicë | 2 668 | 1 389 | 3,85% | 1 279 | 3,54% | 11,55 |
| Ruboc | 386 | 200 | 0,55% | 186 | 0,52% | 3,75 |
| Sedllar | 22 | 11 | 0,03% | 11 | 0,03% | 5,61 |
| Strelicë | 47 | 20 | 0,06% | 27 | 0,07% | 2,80 |
| Strezoc | 276 | 147 | 0,41% | 129 | 0,36% | 8,04 |
| Svircë | 59 | 25 | 0,07% | 34 | 0,09% | 10,48 |
| Shahiq | 34 | 18 | 0,05% | 16 | 0,04% | 1,56 |
| Shipashnicë e Epërme | 1 261 | 642 | 1,78% | 619 | 1,72% | 9,41 |
| Shipashnicë e Poshtme | 753 | 393 | 1,09% | 360 | 1,00% | 3,83 |
| Tërstenë | 100 | 58 | 0,16% | 42 | 0,12% | 9,97 |
| Topanicë | 2 061 | 1 065 | 2,95% | 996 | 2,76% | 8,23 |
| Tugjec | 130 | 66 | 0,18% | 64 | 0,18% | 13,70 |
| Vaganesh | 10 | 5 | 0,01% | 5 | 0,01% | 4,39 |
| Velegllavë e Epërme | 73 | 38 | 0,11% | 35 | 0,10% | 8,15 |
| Velegllavë e Poshtme | 0 | 0 | 0,00% | 0 | 0,00% | 2,97 |
| Vriqec | 78 | 30 | 0,08% | 48 | 0,13% | 4,18 |
| Zajçec | 46 | 25 | 0,07% | 21 | 0,06% | 8,40 |
| Zhujë | 42 | 17 | 0,05% | 25 | 0,07% | 2,94 |
| **KAMENICË** | **36 085** | **18 559** | **51,43%** | **17 526** | **48,57%** | **416,61ha** |

Tabela 8 Projeksionet e popullsisë sipas vendbanimeve

#### 1.7.3. Vlerësimi i gjendjes

Komuna e Kamenicës ka një sipërfaqe prej 416.6 $km^2$, me një dendësi prej 84.2 banorë/$km^2$ që është nën mesataren në nivel vendi prej 163.2 banorë/$km^2$. Dendësinë më të lartë të popullsisë e ka qyteti me rreth 1045,8 banorë në $km^2$.

Grup-moshat e reja 10 deri 14 vjeç, 15-19 vjeç dhe 20-24 vjeç kanë pjesëmarrje më të madhe në popullsinë e përgjithshme.

Në bazë të analizave të natalitetit dhe mortalitetit del se shtimi natyror i popullsisë në komunë është negativ -2.00%. Në bazë të dhënave demografike parashikohet qe rritja e popullsisë në 8 vjeçarin e ardhshëm do të ketë trend negativ -2%.

| ANALIZA SWOT – DEMOGRAFIA | |
|---|---|
| Përparësitë | Dobësitë |
| - Afërsisht 70% e popullsisë janë të aftë për punë (18-65 vjeç);<br>- Afërsisht 30% e popullsisë janë të ri: 15 – 25 vjeç | - Trend negativ të rritjes së popullsisë;<br>- Migrimi i brendshëm fshat – qytet dhe në komuna tjera të Kosovës; |
| Mundësitë | Rreziqet |
| - Programe për zhvillimi socio-ekonomik, duke targetuar të rinjtë; | - Largimi i rinisë jashtë komunës dhe vendit;<br>- Largimi i popullsisë të aftë dhe të kualifikuar për punë jashtë komunës dhe vendit; |

**Sfidat:**

- Kthimi i trendit pozitiv të rritjes së popullsisë.
- Zvogëlimi i trendit të migrimit të banorëve jashtë komunës dhe vendit;

### 1.8. Ekonomia

Pozitë atraktive gjeografike ja mundëson Komunës se Kamenicës potencialin për zhvillim e bashkëpunim ndërkufitar dhe ndër komunal, kjo së basku me resurset natyrore siq janë sipërfaqet pyjore, toka të punueshme, kullosa, pemishte, bimë të ndryshme mjekësore dhe pasuritë e tjera tokësore dhe nëntokësore. Për me tepër, Komuna e Kamenicës ka një tradite industriale (industria e përpunimit te lëngjeve, qeramikës, materialeve ndërtimore dhe drurit, etj.), prandaj nevojat për investime ne ketë industri janë te larta dhe për momentin te parealizueshme, por ne periudhën strategjike ne vazhdim besohet qe Komuna ne partneritet me sektorin privat dhe investitorët do te fillojnë me investime ne ketë drejtim.

#### 1.8.1. Ndërmarrjet

Sipas te të dhënave nga Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Diasporë, ne komunën e Kamenicës ne vitin 2022 figurojnë te jenë te regjistruar 2213 biznese. Prej tyre, dukë u bazuar

në anketën të zhvilluar për procesin e identifikimit të bizneseve, biznese aktive janë 1032 (në vitin 2022). Nga 58 vendbanimet ne komune, 18 vendbanime nuk ka asnjë lloj biznesi, 11 prej tyre kanë nga një biznes, 6 prej tyre kanë nga 2-3 biznese dhe 24 prej tyre kanë mbi 4 biznese te përqendruara ne vendbanim. Numri më i madh i bizneseve është i përqendruar në kryeqendrën komunale, Kamenicë (398), Rogaçicë (123) dhe Koretin (120). Përveç bizneseve të vogla dhe të mesme të cilat janë pjesa aktive dhe kryesore e jetës në komunën e Kamenicës, një rol shumë të madh luan edhe diaspora e kësaj ane e cila jeton dhe punon në botën perëndimore. Prania e tyre gjatë stinës së verës ndikon dukshëm ne qarkullimin e biznesit sidomos ne tregti dhe hotelieri. Roli më i madh janë investimet të cilat bëhen nga diaspora në ndërtimtari dhe objekte afariste.

| Lloji ndërmarrjeve | Madhësia | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1 deri 9 | | 10 deri 49 | | 50 + | | | |
| | Punëtorë | | Punëtorë | | Punëtorë | | Gjithsej | Gjithsej |
| | Biznese | Punëtorë | Biznese | Punëtorë | Biznese | Punëtorë | Biznese (%) | Punëtorë (%) |
| Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi | 110 | 210 | | | | | 110 | 210 |
| Xeheroret dhe gurëthyesit | 2 | 9 | | | | | 2 | 9 |
| Industria përpunuese | 120 | 302 | 2 | 37 | | | 122 | 339 |
| Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionim | 1 | 1 | | | | | 1 | 1 |
| Furnizimi me ujë; kanalizimi, menaxhimi me mbeturina dhe aktivitetet rehabilituese | 0 | 0 | | | | | 0 | 0 |
| Ndërtimtaria | 90 | 189 | 1 | 13 | | | 91 | 202 |
| Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave | 314 | 588 | 6 | 79 | | | 320 | 667 |
| Transporti dhe magazinimi | 92 | 123 | 1 | 20 | | | 93 | 143 |
| Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit | 85 | 234 | 1 | 14 | | | 86 | 248 |
| Informimi dhe komunikimi | 15 | 24 | | | | | 15 | 24 |
| Aktivitetet financiare dhe te sigurimit | 10 | 11 | | | | | 10 | 11 |
| Aktivitetet e patundshmërive | 1 | 1 | | | | | 1 | 1 |
| Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike | 28 | 38 | | | | | 28 | 38 |
| Aktivitetet administrative dhe shërbimet mbështetëse | 23 | 32 | | | | | 23 | 32 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i obligativ | 0 | 0 | | | | | 0 | 0 |
| Arsimi | 12 | 24 | | | | | 12 | 24 |
| Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale | 19 | 30 | | | | | 19 | 30 |
| Arte, argëtimi dhe rekreacioni | 21 | 30 | | | | | 21 | 30 |
| Aktivitetet tjera shërbyese | 78 | 92 | | | | | 78 | 92 |
| Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; mallra te pa diferencuara- dhe shërbime- aktivitetet prodhuese te ekonomive familjare për shfrytëzim vetanak | 0 | 0 | | | | | 0 | 0 |
| Aktivitetet e organizatave dhe organeve të huaja | 0 | 0 | | | | | 0 | 0 |

Tabela 9 Numri ndërmarrjeve ekonomike sipas aktiviteteve dhe madhësia e tyre

### 1.8.2. Punësimi

Duke u bazuar ne të dhëna zyrtare të komunës për bizneset aktive, numri i të punësuarve në sektorin privat të Komunës së Kamenicës është 2101, ndërsa në sektorin publik është 1,186 që paraqet 4.89% të popullsisë së aftë për punë (15-64 vjeç). Nga numri i të punësuarve në sektorin privat, 667 (32%) janë të punësuar në sektorin e tregtisë, 339 (16%) në industrinë prodhuese, 248 (12%) në sektorin e akomodimit dhe aktiviteteve të shërbimit të ushqimit, 210 (10%) në bujqësi dhe 202 apo 9.6% në ndërtimtari. Sektorët tjerë përfshijnë 21% të punësuarve. [3]

### 1.8.3.Vlerësimi i gjendjes: Ndërmarrjet & Punësimi

ANALIZA SWOT – Ndërmarrjet & Punësimi

| Përparësitë: | Dobësitë: |
|---|---|
| • Resurseve natyrore (Bentoniti, Deltina, Argjila, Tufi, kuarci, leuciti, thëngjilli, silikoni, Antimoni, Çeliku, Hekuri , etj)<br>• Zona të veçanta industriale – prodhuese: zona industriale Berivojcë, Topanicë dhe disa vendbanime e hapësira me mundësi industriale.<br>• Procesi i privatizimit (disa ndërmarrje si Magnoromi Riku Xim Strezoci, Niteksi janë privatizuar)<br>• Ekzistimi i kushteve për zhvillimin dhe kultivimin e kulturave bujqësore në prodhimin | • Teknologjia e vjetruar në kapacitete ekzistuese<br>• Kuadri i pamjaftueshëm profesional në kushtet e zhvillimeve globale<br>• Politika fiskale dhe kreditore jo e volitshme,<br>• Zhvillime të ngadalshme si dhe shfrytëzimi i vogël i kapaciteteve industriale,<br>• Mos shfrytëzimi adekuat i kushteve për prodhimin e drithërave, pemëtarisë, perimtarisë, blegtorisë, shpezëve etj<br>• Mos përkushtimi i duhur as nga sektori publik |

[3] Të dhënat pasqyrojnë gjendjen sipas regjistrimit të të punësuarve në ARBK

| | |
|---|---|
| e drithërave<br>● Ekzistimi i tokave dhe masave pyjore si resurs për zhvillim ekonomik | as privat ndaj kësaj fushe shumë të rëndësishme për zhvillim ekonomik<br>● Dëmtimi i resurseve natyrore në mënyrë të vazhdueshme. |

| Mundësitë: | Kërcënimet: |
|---|---|
| ● Tërheqja e investime të reja (vendore dhe të huaja)<br>● Ndërtimi i kapaciteteve nxjerrëse dhe përpunuese në zonat e reja ku kemi pasuri natyrore (Bentonit, Deltin, Argjilë, Tuf, Kuarcit, Leucit, etj.<br>● Aftësimi i resurseve njerëzore-profesionale<br>● Shfrytëzimi i huave dhe kredive nga komuna për përkrahjen e zhvillimit industrial<br>● Dhënia me koncesion e hapësirave dhe pasurive<br>● Përdorimi i drurit për Industri përpunuese | Trazira dhe jo qëndrueshmëri ekonomike<br>Shkatërrim i resurseve turistike |

### 1.8.4. Bujqësia

Komuna e Kamenicës nga sipërfaqja e sajë totale prej 41,611 ha, 47% shfrytëzohet si tokë e punueshme dhe kullosa, dhe 48% janë pyje. Do të thotë, afërsisht 90% e territorit të komunës ka potencial për shfrytëzim të bujqësisë dhe blegtorisë.




Harta 4 Harta e bonitetit të tokës

I gjithë territori i komunës është i përbërë nga tokat me klasa të bonitetit nga II deri në VII. Klasa VI ka mbulim më të madh të territorit me 48.2% (20’002 ha), pastaj klasa V me 14.3%

(5’957); klasa III me 11.45 ( 4’761 ha); pasuar me tutje nga klasat tjera si në figurën IV. Siç mund të vërehet në hartë toka me bonitet të klasës V, VI dhe VII është pjesa kodrinoro malore e komunës, derisa toka me bonitet te klasës II, III dhe IV është toka bujqësore.

Bujqësia luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë vendore si dhe mund të ndikojë në zbutjen e papunësisë, në sigurinë ushqimore duke përmirësuar mirëqenien qytetare dhe në uljen e importit të atyre produkteve agro - ushqimore të cilat mund të prodhohen në parcelat tona të pashfrytëzuara plotësisht.




Tabela 10 Boniteti i tokave – klasa II deri VII

Komuna e Kamenicës ka resurse për zhvillimin e pemëtarisë, blegtorisë, bletarisë, prodhimin e mishit, shpeztarisë si dhe duhet te kemi parasysh resurset pyjore te cilat mundësojnë kultivimin e frutave te malit dhe bimëve mjekuese te cilat mund te luajnë një rrol te konsiderueshëm ne zhvillimin e bujqësisë.

| **Drithërat** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Kategoritë** | **Prodhimi (t/ ha)** | | | | |
| | **2018** | **2019** | **2020** | **2021** | **2022** |
| **Gruri** | 6’930 | 6’000 | 6’525 | 6’600 | 6’080 |
| **Misëri** | 2’887.50 | 3’160 | 3’485 | 3’200 | 3’570 |
| **Elbi** | 157.50 | 105 | 105 | 120 | 150 |
| **Thekër** | 5.75 | 7.05 | 8.40 | 12.25 | 15 |
| **Tërshëra** | 36.25 | 43.20 | 104.40 | 138 | 180.40 |
| **Gjithsej:** | **10’017** | **9’315.25** | **10’227.80** | **10’070.25** | **9’995.40** |

Meqë një sipërfaqe e konsiderueshme janë pyje, kjo mundëson zhvillimin e florës dhe faunës. Nga analizat e gjendjes në komunë dihet se komuna e Kamenicës ka fond të konsiderueshëm të tokës bujqësore dhe të pyjeve e kullosave që paraqesin potencial të rëndësishëm ekonomik të kësaj komune.

| Drithërat | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Kategoritë | Trendet e rritjes/ zvogëlimit- viti: | | | | |
| | 2018- 2019 | 2019- 2020 | 2020- 2021 | 2021 - 2022 | 2018 - 2022 |
| Gruri | 13.41 % rënie | 8.75 % rritje | 1,14 % rënie | 7.87 % rënie | 7.87 % rënie |
| Misëri | 9.43 % rritje | 10.28 % rritje | 8.17 % rënie | 11.56 % rritje | 23.63 % rritje |
| Elbi | 33.33 % rënie | 0% | 14,28 % rritje | 25% rritje | 4.76 % rënie |
| Thekër | 22.60 % rritje | 19.14 % rritje | 45.83 % rritje | 22.44 % rritje | 160.86 % rritje |
| Tërshëra | 19.17 % rritje | 141.66 % rritje | 32.18 % rritje | 30.72 % rritje | 397.65 % rritje |
| **Gjithsej:** | **7 % rënie** | **10.33 % rritje** | **1.54 % rënie** | **0.74 % rënie** | **0.21 % rënie** |

Burimi: Anketa e ekonomive bujqësore - Të dhëna nga aplikimi për subvencione në MBPZHR.

| Perimet | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Kategoritë | Prodhimi (t /ha) | | | | |
| | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 |
| Speci | 310 | 435 | 585 | 787.50 | 1’000 |
| Domatja | 864.50 | 928.20 | 970 | 1’071 | 1’265 |
| Fasule | 330 | 320 | 302.25 | 412.50 | 527 |
| Patatja | 1’025 | 1’304 | 1’118 | 1’624 | 2’100 |
| Shalqi | 1’000 | 1’060.80 | 965 | 1’060 | 1’182.50 |
| **Gjithsej:** | **3’529.50** | **4’047.50** | **3’940.25** | **4’955** | **6’074.50** |

Trendi i kultivimit të drithërave tregon lëvizje përgjatë katër viteve të fundit, duke pësuar rënie dhe ngritje në sasi të kultivimit - t/ha për vit. Pothuajse në të gjitha vitet është raportuar rënie e kultivimit të drithërave, përveç në vitet 2019 – 2020 që është raportuar rritje deri në 10.33% Llojet që kultivohen më së shumti janë gruri, misri, elbi, thekura dhe tërshëra.

| Perimet | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Kategoritë | Trendet e rritjes/ zvogëlimit- viti: | | | | |
| | 2018- 2019 | 2019- 2020 | 2020- 2021 | 2021 - 2022 | 2018 - 2022 |
| Speci | 40.32 % rritje | 34.48 % rritje | 34.61 % rritje | 26.98 % rritje | 222.58 % rritje |
| Domatja | 7.36 % rritje | 4.50 % rritje | 10.41 % rritje | 18.11 % rritje | 46.32 % rritje |
| Fasule | 3.03 % rënie | 5.54 % rënie | 36.47 % rritje | 27.75 % rritje | 59.69 % rritje |
| Patatja | 27.21 % rritje | 14.26 % rënie | 45.25 % rritje | 29.31 % rritje | 104.87 % rritje |
| Shalqi | 6.08 % rritje | 9.03 % rënie | 9.84 % rritje | 11.55 % rritje | 18.25 % rritje |
| **Gjithsej:** | **14.67 % rritje** | **2.64 % rënie** | **25.75 % rritje** | **22.59 % rritje** | **72.10 % rritje** |

*Burimi: Anketa e ekonomive bujqësore - Të dhëna nga aplikimi për subvencione në MBPZHR.*

| Pemët | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Kategoritë | Prodhimi (t/ ha) | | | | |
| | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Mollë** | 799.80 | 897.60 | 994.50 | 1’092.50 | 1’240 |
| **Kumbullë** | 240 | 268.80 | 315 | 376 | 425 |
| **Dardhë** | 90 | 98.40 | 108.75 | 115.70 | 142.50 |
| **Arra** | 21.25 | 30 | 61.20 | 82 | 161.60 |
| **Mjedra** | 115.50 | 72 | 39.90 | 46.40 | 63 |
| **Gjithsej:** | **1’266.55** | **1’366.80** | **1’519.35** | **1’713** | **2’032.10** |

Sipërfaqet e kultivuara me perime përfshijnë vetëm 10.8 ha. Dominojnë sipërfaqet me speca me 39%, domatet 21%, trangujt 16%, dhe llojet tjera 24%. Speci dhe patatja janë dy kulturat me rritje më te lartë përgjatë 4 viteve të fundit – 220% dhe 100%.

| **Pemët** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Kategoritë** | **Trendet e rritjes/ zvogëlimit- viti:** | | | | |
| | **2018- 2019** | **2019- 2020** | **2020- 2021** | **2021 - 2022** | **2018 - 2022** |
| **Mollë** | 12.22 % rritje | 10.79 % rritje | 9.85 % rritje | 13.50 % rritje | 55.03 % rritje |
| **Kumbullë** | 12 % rënie | 17.18 % rritje | 19.36 % rritje | 13.03 % rritje | 77.08 % rritje |
| **Dardhë** | 9,33 % rritje | 10.51 % rritje | 6.39 % rritje | 23.16 % rritje | 58.33 % rritje |
| **Arra** | 41.17 % rritje | 104 % rritje | 33.98 % rritje | 97.07 % rritje | 560.47 % rritje |
| **Mjedra** | 37.66 % rënie | 44.58 % rënie | 16.29 % rritje | 35.77 % rritje | 45.45 % rënie |
| **Gjithsej:** | **7.91 % rritje** | **11.16 % rritje** | **12.74 % rritje** | **18.62 % rritje** | **60.44 % rritje** |

*Burimi: Anketa e ekonomive bujqësore - Të dhëna nga aplikimi për subvencione në MBPZHR.*

Sipërfaqet e kultivuara me pemë përfshijnë 51 ha. Sipërfaqet e kultivuara me mollë përfshijnë 69%, me kumbull 20%, pjeshkë 3%, dhe llojet tjera 9%. Të gjitha kulturat e listuara kanë pësuar rritje në kultivim në 4 vitet e fundit, përveç mjedrës – molla 55%, kumbulla 77%, dardha 58%, dhe më se shumti arra me 560%. Rreth 60% e popullatës së Komunës jeton ne zona rurale dhe merret me bujqësi. Megjithatë mekanizmi bujqësor është i vjetërsuar dhe parcelimi i tokave është shumë i vogël gjë që i bën të pa punueshme. Ndërsa në qytet kapaciteti prodhues është pothuajse zero dhe toka është e dëmtuar nga deponitë abuzive. Komuna e Kamenicës ka resurse edhe për zhvillimin blegtorisë. Në vitin 2022, numri i gjithmbarshëm i gjedheve ishte 3,572 – 24% më pak se 2018, përkatësisht 2’551 lopë dhe 1’021 mëshqerre. Përderisa numri i deleve ishte 4’269, ndërsa i qengjave 2’081 – 10% me shumë se në vitin 2018. Niveli mesatar i prodhimit të qumështit ka arritur në 918’360 litra, 24% më pak krahasuar me vitin 2018. Numri i shpezëve, pula dhe gjela, në vitin 2022 ishte 45’394 – 30% më shumë se në 2018. Numri i mekanizmave përpunues në sektor: traktor, motokultivator, autokombajna, spërkatëse dhe makina mjelëse për bujqësi dhe blegtori ka shënuar ngritje për 3% krahasuar me vitin 2018. Pozita e mirë gjeografike e Komunës, gjithashtu, bën të mundur lidhjet për shkëmbime tregtare me komunat fqinje si Medvegja, Bujanoci. Ndër degët që mund të zhvillohen në këtë drejtim janë: pemëtaria, prodhimi i mjaltit, kultivimi i peshkut dhe kultivimi i bimëve medicinal. Gjuetia është mjaft e zhvilluar. Prodhimi i mjaltit

dhe produkteve tjera te mjaltit mund te jap rezultate te mira pasi qe kemi njohës te mirë të kësaj veprimtarie si dhe kushtet klimatike dhe laramania bimore krijojnë kushte te mjaftueshme për kultivimin e bletëve. Mund te mendohen edhe mënyra për kultivimin e peshkut ,pasi lumenjtë e përshkojnë qytetin ne dy anët e saj. Megjithatë rreth 60% e popullatës jetojnë ne zona rurale dhe merret me bujqësi. Mekanizmi bujqësor është i vjetruar, parcelat punuese janë te vogla, mungojnë kooperativat dhe profilizimi i buqëve ,gjë qe tregon për nivelin jo te mire te bujqësisë.

### 1.8.5.Pyjet

Toka pyjore mbulon 20'123 ha apo 48% të territorit të komunës. Pyjet dëmtohen (prehen) vazhdimisht me arsyetimin qe lënda e drurit është burim kryesor për nxehje.

### 1.8.6. Industria

Komuna e Kamenicës ka një tradite industriale (industria e përpunimit te lëngjeve, qeramikës, materialeve ndërtimore dhe drurit), prandaj nevojat për investime ne këtë industri janë te larta dhe për momentin te parealizueshme, por ne periudhën strategjike ne vazhdim besohet qe Komuna ne partneritet me sektorin privat dhe investitorët do te fillojnë me investime ne këtë drejtim. Industria në komunë është e bazuar në eksploatim dhe përpunimin e mineraleve ekzistuese. Vitet 1970-90 shënojnë një zhvillim të theksuar të industrisë dhe tregtisë. Mbështetur në këto resurse në të kaluarën në komunë janë ngritur kapacitetet prodhuese. Ndërmarrjet industriale në të cilat është mbështetur ky zhvillim, ishin kryesisht të sektorit shoqëror. Investimi në zhvillimin e industrisë përpunuese të mineraleve (jo-metaleve dhe metaleve), të materialit ndërtimor dhe ndërtimtarisë, konsiderohen të jenë mbështetje e mirë për zhvillim ekonomik dhe punësim në qytet e komunë.

### 1.8.7.Vlerësimi i gjendjes: Bujqësia

| Përparësitë | Dobësitë |
|---|---|
| • Toka bujqësore pjellore;<br>• Kushtet e përshtatshme klimatiko-tokësore,<br>• Pozita gjeografike,<br>• Kushtet e mira për zhvillimin e agroturizmit<br>• Fuqia punëtore e mjaftueshme<br>• Tradita ne prodhimtarinë bujqësore dhe blegtorale | • Humbja e tokës bujqësore – shëndrrimi i destinimit te tokës bujqësore në ndërtimore;<br>• Parcelimi i ngastrave bujqësore ne sipërfaqe te vogla;<br>• Mungesa sistemit te ujitjes për tokat bujqësorë;<br>• Përdorimi i pakontrolluar i pesticideve ne mbrojtjen e kulturave bujqësore;<br>• Mungesa infrastrukturës përcjellëse ne pemishte intensive ne mbrojtje kundër breshëritë dhe ngricave te vonshme pranverore (rrjeta speciale);<br>• Mungesa e infrastrukturës rrugore fushore; |

| | |
|---|---|
| | • Mungesa e teknologjisë përpunuese të perimeve dhe produkteve blegtorale; |
| **Mundësitë** | **Kërcënimet** |
| • Rregullimi i sistemit te ujitjes;<br>• Përmirësimi infrastrukturës rrugore fushore;<br>• Rregullimi infrastrukturës te fermave bujqësore- blegtorale.<br>• Pikat grumbulluese dhe përpunuese për produktet bujqësore. | • Fatkeqësitë elementare natyrore, si breshëri, ngricat vonshme pranverore, vërshimet, thatësira ekstreme, etj.;<br>• Politika jo te favorshme ekonomike-fiskale;<br>• Teknologjia e re jo përgatitja profesionale teknike;<br>• Kërkesat e tregut;<br>• Kushtet ekonomike te dobëta ne tregun lokal dhe rajonal.<br>• Rreziqet nga konkurrenca jo-lojale e tregut në plasim të rendimenteve; |

**Sfidat:**

- Ruajtja e tokës bujqësore;
- Menaxhimi i mirëfilltë i tokës bujqësore – konsolidimi i parcelave
- Krijmi i sistemit të mirëfilltë të ujitjes;

**Infrastruktura teknike**

### 1.8.8. Infrastruktura dhe Furnizimi me ujë

Sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit në komunën e Kamenicës menaxhohet nga Kompania Rajonale e Ujësjellësit (KRU) "Hidromorava", njësia në Kamenicë. Komuna e Kamenicës furnizohet me ujë të pijes nga burimet nëntokësore të cilat shfrytëzohen përmes puseve me anë të pompave.

| Vendburimet | Nr. i puseve | Lokacioni | Kapaciteti mujor mesatar | Komente |
|---|---|---|---|---|
| Stacioni 1 | 4 të hapura + 3 me shpim | Lagjja Malësia | 2,9-3l/sec | |
| Stacioni 2 | 3 puse me shpim (1 funksional, 2 s'kanë ujë) | Qendra e qytetit | 3.8-4l/sec | |
| Stacioni 3 | 1 pus me shpim | Grizime | Rreth 1l/sec (ne baze të kërkesës) | |
| Stacioni 4 | 2 puse me shpim | Bashqe | 6.5-7l/sec | |
| Stacioni 5 | 2 puse me shpim që gjenden në lokacionin | Çamëria | 1-1.5l/sec | |

| Vendburimet | Nr. i puseve | Lokacioni | Kapaciteti mujor mesatar | Komente |
|---|---|---|---|---|
| | e stacionit 1 | | | |
| Stacioni 6 | 2 puse | Koretin | 2l/sec | Verës ka mungese |
| Stacioni 7 | 2 puse | Topanicë | 3.5l/sec | |
| Stacioni 8 | 2 puse | Karacevë e poshtme | 2.5-3l/sec | Ne përgjithësi stabil |
| Stacioni 9 | 4 puse që i mbushin 2 rezervuarë | Kopernicë (i furnizon Shipashnicë dhe Kopernicë/Kolloleq ) | 2.2-2.5l/sec | Ne përgjithësi stabil |
| Stacioni 10 (ne proces) | 2 puse me shpim | Muqivërcë | 20l/sec | |
| Stacioni 11 (ne proces) | 2 puse me shpim | Hogosht | Ende nuk dihet | |

Tabela 11 Vendbanimet që furnizohen me ujë të pijes nga burimet nëntokësore të cilat shfrytëzohen përmes puseve

Në total, kapaciteti eksploatues i ujit nga këto burime është rreth 50.000$m^3$ në muaj 725.932$m^3$/vit (19.34 litra/sec) – në vitin 2022. Në Kamenicë ka 5 fabrika për trajtimin e ujit të pijshëm: Hogosht; Bujnoc; Zajçec; Gmicë dhe Tërstenë.

Qyteti i Kamenicës, vendbanimi Berivojcë dhe një pjesë e Rubocit, furnizohen me ujë nga dy stacione pompimi. Sasia më e madhe e ujit në këto stacione vjen nga sistemi i drenazhimit i vendosur nën shtratin e Lumit ”KRIVA REKA”, i cili bënë furnizimin e katër (4) puseve të hapura dhe tri (3) puseve të shpuara nga të cilët përmes pompave horizontale dhe zhytëse mbushet rezervari me kapacitet prej 142 $m^3$ dhe pastaj me anë të pompave tjera bëhet shpërndarja në rrjetin kryesor të ujit. Pjesa më e madhe e banorëve të Komunës së Kamenicës që jetojnë në zonat rurale, furnizohen me ujë të pijshëm nga burime të ndryshme individuale (puse të hapura, kroje malore, lumenj etj.). Këto burime të ujit nuk janë të testuara për cilësi nga institucionet përkatëse.

**Gjendja fizike e rrjetit te ujësjellësit:** Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit në të gjithë komunën është L=72000.00m’. Gjendja e rrjetit është mjaftë e mire, duke qenë se janë zëvendësuar një sasi e madhe e gypave të azbestit me ato të polietilenit. Humbjet mesatare janë rreth 40%. Në vitin 2021 dhe 2022 është rreth 90% ujë nga sasia e përgjithshme e ujit të prodhuar, duke marrë parasysh edhe inkasimin e borxheve të vjetra.

**Mbulimi me shërbim të ujësjellësit:** Më poshtë janë paraqitur vendbanimet qe kanë qasje në rrjet të ujësjellësit që menaxhohet nga KRU Hidromorava – njësia Kamenicë.

| Nr. | Vendbanimet | Burimi dhe Kapaciteti | Nr. i Banorëve (në 2011) | Nr. i konsumat. (gjendja dhjetor 2022) |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Kamenicë | Malësia, Qendra e Qytetit dhe Grizime (Q=42l/s) | 7,331 | 2,155 |
| 2. | Berivojcë | Malësia,Qendra e Qytetit dhe Grizime (Q=42l/s) | 1,553 | 325 |
| 3. | Ruboc | Malësia,Qendra e Qytetit dhe Grizime (Q=42l/s) | 386 | 32 |
| 4. | Koretin | 2 puse vetanake (Q=40l/s) | 3,476 | 391 |
| 5. | Topanicë | 2 puse vetanake (Q=36/s) | 2,890 | 499 |
| 6. | Petrocë | 2 puse vetanake (Q=16/s) | 1,257 | |
| 7. | Kopernicë | 2 puse vetanake (Q=18/s) | 1,183 | 239 |
| 8. | Kolloleq | 2 puse vetanake (Q=12/s) | 181 | 68 |
| 9. | Shipashnicë e Epërme | 2 puse vetanake (Q=14/s) | 1,261 | 287 |
| 10. | Muqivërc | Në proces | 1520 | Ende nuk kanë |
| 11. | Shipasnicë e Poshtme | Në proces | 953 | Ende nuk kanë |
| 12. | Hodonovcë | Në proces | 2,446 | Ende nuk kanë |
| 13. | Rogaçicë | Në proces | 2,450 | Ende nuk kanë |
| 14. | Novosellë | Në proces | 280 | Ende nuk kanë |
| 15. | Dajkoc | Në proces | 373 | Ende nuk kanë |
| 16. | Hogosht | Në proces | 1705 | Ende nuk kanë |
| Gjithsej | | | | 4202 |

Tabela 12 Vendbanimet me shërbim të ujësjellësit qe ofrohet nga KRU Hidromorava

Vendbanimet që nuk kanë rrjet të ujësjellësit janë: Bllatë, Boscë, Bratilloc, Busovatë, Dajkoc, Dazhnicë, Desivojcë, Feriqevë, Grizimë, Gmicë, Gogolloc, Gragjenik, Gjyrishec, Hajnoc , Karaqevë e Epërme, Krilevë, Kostadincë, Kranidell, Kremenatë II, Lajçiqi, Lisockë, Leshtar, Marocë, Meshinë, Moçar, Poliçkë, Qarrakoc, Rahovicë, Strezofc, Sedllar, Strelicë, Svircë, Shahiq, Tërstenë, Tugjec, Vaganesh, Velegllavë e Epërme, Velegllavë e Poshtme, Vriqec, Zajçec dhe Zhujë me numër prej 15,310 banorë.

| | Numër | Banorë | % |
|---|---|---|---|
| Vendbanimet me shërbim të ujësjellësit të menaxhuar nga KRU Hidromorava | 9 | 19,518 | 56 |
| Vendbanimet që nuk kanë qasje në shërbim të ujësjellësit | 40 | 15,310 | 28 |
| Vendbanimet që janë në proces të vendosjes së shërbimit | 7 | 9,727 | 16 |

Tabela 13 Gjendja e ofrimit me ujësjellës në komunë




Harta 5 Mbulimi më shërbime të ujësjellësit në komunë

Në komunën e Kamenicës 56% banorëve kanë qasje në ujësjellës, dhe 44% nuk kanë qasje. Nga 44% që nuk kanë qasje, për 16% të tyre rrjeti i ujësjellësit është në proces të ndërtimit, që do të zbret përqindjen në 28.

Shprehur ne ekonomi familjare (EF), nga **6,419 EF** sa kanë qenë sipas regjistrimit të popullsisë te 2011, në sistemin e ujësjellësit janë të përfshira **3952 EF**. Nga **527** biznese aktive si dhe **59** institucione publike sa janë evidentuar nga Komuna e Kamenicës në vitin 2022, **197** biznese dhe **53** institucione publike kanë qasje në ujësjellës.

| Viti | Prodhimi $m^3$ qytet | Prodhimi $m^3$ fshatra | Prodhimi $m^3$ Totali |
|---|---|---|---|
| 2013 | 535,198 | - | 535,198 |
| 2014 | 569,580 | - | 569,580 |
| 2015 | 596,335 | - | 596,335 |
| 2016 | 625,903 | - | 625,903 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 2017 | 610,665 | - | 610,665 |
| 2018 | 488,274 | 49,117 | 537,391 |
| 2019 | 501,434 | 282,334 | 783,768 |
| 2020 | 442,079 | 232,513 | 674,592 |
| 2021 | 546,444 | 241,307 | 787,751 |
| 2022 | 451,947 | 273,985 | 725,932 |

Tabela 14 Trendi i prodhimit të ujit ne $m^3$ për vitet 2013 deri 2022

### 1.8.9. Infrastruktura e kanalizimit

Qyteti i Kamenicës dhe vetëm 12 fshatra të komunës kanë çasje në rrjet të kanalizimit. Vendbanimet që nuk kanë casje në rrjet të kanalizimit janë: Bllatë, Boscë, Bratilloc, Busovatë, Dajkoc, Dazhnicë, Desivojcë, Feriqevë, Gmicë, Gogolloc, Gragjenik, Grizimë, Gjyrishec, Hajnoc, Kopernicë, Kostadincë, Kranidell, Kremenatë I, Kremenatë II, Krilevë, Lajçiqi, Leshtar, Lisockë, Marocë, Meshinë, Moçar, Poliçkë, Qarrakoc, Rahovicë, Sedllar, Strelicë, Strezoc, Svircë, Shahiq, Tërstenë, Tugjec Vaganesh, Velegllavë e Epërme, Velegllavë e Poshtme, Vriqec, Zajçec dhe Zhujë me gjithsej 43 vendbanime dhe 8547 banorë.

| | **Numër** | **Banorë** | % |
|---|---|---|---|
| Vendbanimet me qasje në rrjet të kanalizimit | 13 | 26281 | 75 |
| Vendbanimet që nuk kanë qasje në rrjet të kanalizimit | 43 | 8547 | 25 |

Tabela 15 Vendbanimet që kanë qasje në rrjet të kanalizimit

**Trajtimi i ujërave të ndotura:** Të gjitha ujërat e ndotura në komunë shkarkohen në lumin Krivareka, në Berivojcë dhe në disa përroska të afërta. Momentalisht, në komunë nuk ekziston asnjë impiant i trajtimit të ujërave të ndotura, dhe rrjedhimisht ndotja e lumenjve është mjaftë e lartë.

Për më shumë, edhe ujërat e ndotura industriale nuk trajtohen në mënyrë përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

**Sistemi i drenazhimit të ujërave atmosferik:** Pjesa më e madhe e ujërave atmosferike mblidhen përmes rrjetit të kanalizimit – 30,000 m’. Drenazhimi i ujërave atmosferik është i ndarë nga rrjeti i kanalizimit vetëm në zonë urbane – qytet në gjatësi prej 1,000 m’.




Harta 6 Mbulueshmëria me rrjet të kanalizimit

### 1.8.10. Vlerësimi i gjendjes: kanalizimi

Komuna e Kamenicës ka burime të mjaftueshme të ujit që sigurohet nga 11 stacione të pompimit. Kapaciteti mesatar mujor ndryshon nga 2.2 lit/sec deri në 20 lit/sec. Në total kapaciteti mujor i ujit është 50,000 $m^3$, dhe 725,932 $m^3$ në vit. Gjendja e rrjetit të ujësjellësi është relativisht e mirë, mirëpo humbjet mesatare të ujit arrijnë në nivelin 40%. Ky nivel i lartë i humbjeve ndikon në qëndrueshmërinë financiare në sistem dhe rrjedhimisht në ofrim të shërbimeve.

Në komunë 25% të vendbanimeve nuk kanë qasje në rrjet të kanalizimit. Ndikimi negativ në mjedis dhe kualitet të ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor është shumë i madh, për shkak që ujërat e zeza të kanalizimit nuk trajtohen dhe të gjitha derdhen në lumin Krivarekë. Për më shumë sistemi i drenazhimit të ujërave atmosferik është i ndarë vetëm në zonën urbane, mirëpo jo edhe në zonën rurale.

| **Analiza SWOT – Ujësjellës, kanalizim** | |
|---|---|
| PËRPARËSITË | DOBËSITË |
| - Momentalisht komuna ka sasi të mjaftueshme e ujit për pije;<br>- 72% e vendbanimeve furnizohet me ujë të pijshëm;<br>- Cilësia e mirë e ujit – sistemi i | - 28% të vendbanimeve nuk kanë casje në ujë të pijshëm;<br>- Mungesa e sistemit të akumulimit të ujërave;<br>- Vendbanimet malore furnizohen me ujë |

| | |
|---|---|
| menaxhuar nga KRM Hidromorava;<br>- Rrjeti i mire i ujësjellësit – sistemi i gypave i riparuar; | të pijshëm nga burime të ndryshme individuale (puse, kroje malore etj.), të cilat nuk janë të testuara<br>- Humbjet e ujit, deri në 40%;<br>- Mungesa e koordinimit në mes të komunë dhe KRM Hidromorava; |
| - 75% të vendbanimeve kanë casje në rrjet të kanalizimit;<br>- Në zonë urbane është ndarë sistemi i ujërave atmosferik nga sistemi i ujërave të zeza të kanalizimit; | - 25% të vendbanimeve nuk kanë casje në rrjet të kanalizimit;<br>- Nuk ka trajtim të ujërave të zeza të kanalizimit, rrjedhimisht të gjitha ujërat e zeza shkarkohen në lumen Krivarekë<br>- Mungesa e sistemit për ujërat atmosferik në zonë rurale ;<br>- Rrjeti i vjetruar i sistemit të kanalizimit; |
| MUNDËSITË | RREZIQET |
| - Shfrytëzimi i investimeve të jashtme;<br>- Garantët qeveritarë;<br>- Aplikimi i arritjeve teknologjike;<br>- Investimet e qeverisë për diga – akumulimet e ujit; | - Ndryshimet klimatike – zvogëlimi i sasisë së ujërave në komunë nga thatësirat dhe reshjet e dobëta atmosferike<br>- Rrezikimi i skemave të ujitjes nga urbanizimi i egër i fshatrave; |

**Sfidat**

- Ofrimi me shërbim të ujësjellësit dhe kanalizimit për të gjitha vendbanimet e komunës.
- Parashikimi i investimeve për ujësjellës dhe kanalizim në raport me intensitetin për zhvillim – sidomos për zona të reja të banimit, objektet shumëbanesore.
- Ndarja e sistemit të drenazhimit – ujërat atmosferik nga sistemi i kanalizimit.
- Trajtimi i ujërave të zeza të kanalizimit në komunë.
- Akumulimi i ujërave

**Nevojat zhvillimore**

- Investim në sistem të ujësjellësit – mbulimi i tërësishëm i komunës me ujë të pijes
- Akumulimi i ujërave
- Investim në sistem të trajtimit të ujërave të zeza

### 1.8.11. Infrastruktura e energjisë elektrike

Komuna e Kamenicës furnizohet me energji elektrike nga tri rrjete të tensionit, Rrjeti i tensionit të ultë (0.4kV) me një gjatësi prej 322km, Rrjeti 10(20)kV me gjatësi prej afër 209km dhe Rrjeti 110kV me gjatësi afër 30km.

Ekziston një T.S 110/10(20)kV me fuqi 31.5 MVA. Furnizimi bëhet nga Gjilani përmes linjës 110kV dhe nga Bujanoci (Ristovci), gjithashtu përmes linjës 110kV.




Harta 7 Rrjeti i energjisë elektrike

Në territorin e Komunës gjendet një transformator: Transformatori 110/10(20) kV në një sipërfaqe prej 0.10 ha. Konsumi mesatar gjatë sezonës së verës është 11.2 MË/h, ndërsa gjatë dimrit është 12.5 MË/h. Ngarkesa maksimale gjatë sezonës verore është 12MË, gjersa gjatë asaj dimërore është 16MË.

| Klient te amvisërisë | Klient publik | Klient komercial | Gjithsej |
|---|---|---|---|
| 8790 | 125 | 984 | 9915 |

Tabela 16 Tabela Numri i konsumatorëve të KEDS

### 1.8.12. Vlerësimi i gjendjes: energjisë elektrike

Rrejti i sistemit të energjisë elektrike në komunë është mjaft i vjetërsuar. Shumica e ekonomive familjare kanë casje në rrjet përmes kabllove mbitokësore, që shfaqin rrezik permanent për qytetarët. Mirëmbajtja dhe zëvendësimi i kabllove, dhe eventualisht vendosja e tyre nën tokë duhet të jetë prioritet për kompaninë menaxhuese të sistemit.

| Analiza SWOT – ENERGJIA | |
|---|---|
| Përparësitë | Dobësitë |

| | |
|---|---|
| Kapaciteti i mjaftueshëm furnizues (31.5 MË);<br>Qasje për të gjithë qytetarët në sistem; | Rrjeti i ngarkuar;<br>Kabllot mbitokësore;<br>Mungesë e koordinimit në mes të komunës dhe kompanisë menaxhuese;<br>Kyçje ilegale; |
| Mundësitë | Rreziqet |
| Legjislacioni i kompletuar;<br>Grante nga donator për burime të reja për energji të ripërtritshme – solare | Rritja e çmimeve – pasojë e tregut global;<br>Ndërtimi i ndërtesave afër objekteve energjetike; |

**Sfidat**

- Planifikimi i investimeve në rrjet të energjisë bazuar në intensitetin e zhvillimit – sidomos të zonave për banim, objektet shumëbanesore;
- Riparim i rrjetit të kabllove mbitokësore;

**Nevojat zhvillimore**

- Rehabilitimi i rrjetit, sidomos në vendbanimet malore;
- Ndërtimi i nënstacioneve të reja;
- Zëvendësimi i linjave ajrore 230/400V me kabllo-gërshetë apo edhe kabllo nëntokësore;

#### 1.8.13. Infrastruktura dhe shërbime e telekomunikacionit

Territori i Kamenicës është i mbuluar mjaftë mirë me shërbime të telekomunikacionit. Pothuajse të gjitha vendbanimet e Kamenicës, kanë qasje në shërbimet e telefonisë mobile, të cilat ofrohen nga dy operatorët e licencuar nga ART-ja. Të dy operatorët mobil kanë të shpërndara antena individuale në lokacione të ndryshme të komunës. Numri i antenave të vendosura nga operatorët mobil sipas vendbanimeve dhe operatorëve në tërë territorin e komunës. Në Kamenicë ekzistojnë 2 kompani të mëdha IPKO dhe Kujtesa që ofrojnë shërbime interneti dhe disa kompani më të vogla lokale.

#### 1.8.14. Vlerësimi i gjendjes: telekomunikacioni

Në fushën e telekomunikacionit, komuna e Kamenicës qëndron mjaft mirë. Komuna mbulohet nga infrastruktura me kapacitet: E,3G, dhe LTE(4G) nga operator si IPKO, VALA dhe Art Motion. Në këtë sektor nuk ka sfida të identifikuara duke marr parasysh që shërbimi ofrohet nga kompani private.




Harta 8 Rrjeti i telekomunikacionit

### 1.8.15. Menaxhimi i mbetjeve

Shërbimi i grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave në komunën e Kamenicës ofrohet nga Kompani Rajonale e Mbeturinave “Eco-Higjiena” njësia në Kamenicë. Nga totali i numrit të përgjithshëm të amvisërive 72% kanë mbulueshmëri në shërbime, institucionet publike 100%, derisa nga 497 biznese aktive, 422 (85%)[4] marrin shërbimin e mbledhjes së mbeturinave. Më poshtë është paraqitur harta e mbulueshmërisë me shërbime për amvisëri, duke paraqitur numrin/përqindjen e amvisërive të shërbyera për vendbanim.

Grumbullimi i mbeturinave bëhet për sistemit derë më derë, me kontejnerë 120L dhe me qese të plastikës, dhe me kontejnerë të përbashkët 1.1m³. Zona rurale shërbehet përmes sistemit derë me derë, ndërsa zona urbane shërbehet përmes sistemit derë me derë dhe me kontejnerë të përbashkët. Të gjitha mbeturinat e grumbulluara në komunën e Kamenicës transportohen dhe deponohen në deponinë rajonale të mbeturinave në Velekincë të Gjilanit.

Sa i përket deponive ilegale, në territor të Kamnicës janë prezente në vitin 2023 tri deponi të mëdha në Berivojcë, Muqiverc dhe Rogaqicë, katër deponi të mesme në Busavatë, Berivojcë, Topanicë, dhe Dajkoc, si dhe 1 deponi e vogël në Hodonoc.

### 1.8.16. Vlerësimi i gjendjes: mbetjet

Grumbullimi i mbeturinave ofrohet nga KRM “Eco – Higjiena” njësia në Kamenicë. Grumbullimi bëhet me sistemin derë me derë – me kontejnerë të veçantë dhe me kontejnerë

[4] Raporti i punës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoriatit dhe 2022

të përbashkët. Momentalisht, 72% e amvisërive, 100% nga institucionet dhe 85% e bizneseve kanë qasje në rrjet të shërbimit. Mbeturinat e grumbulluara transportohen në deponinë rajonale në Velekincë të Gjilanit.




Harta 9 Mbulueshmëria me shërbim

| Analiza SWOT – Menaxhimi i mbeturinave | |
|---|---|
| Përparësitë | Dobësitë |
| 72% e amvisërive, 100% nga institucionet dhe 85% e bizneseve kanë qasje në rrjet të shërbimit<br>Plani komunal për menaxhim të mbeturinave;<br>Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave;<br>Krijimi i NPL KAMENICA | Mos ndarje e mbeturinave ne burim;<br>Mos menaxhim i duhur i hapësirave për hedhje të mbeturinave – hapësirat përreth kontejnerëve;<br>Mungesa e lokacionit për deponimin e mbeturinave të ngurta dhe mbetjeve shtazore |
| Mundësitë | Rreziqet |
| Angazhimi më i madh i OJQ-ve mjedisore;<br>Grantet nga donatorët për ndarje të mbeturinave; | Rritja e ndotjes;<br>Shfaqja e sëmundjeve infektive; |

**Sfidat**

- Përfshirja e të gjitha vendbanimeve në shërbim të grumbullimit të mbeturinave;
- Inicimi i ndarjes së mbeturinave në burim – zvogëlimi i sasisë së mbeturinave qe shkon në deponi;
- Riciklimi i mbeturinave;
- Identifikimi i lokacionit për deponimin e mbeturinave të ngurta dhe mbetjeve shtazore

**Nevoja zhvillimore**

- Investime kapitale në makineri për grumbullim dhe transport të mbeturinave;
- Investime kapitale në infrastrukturë – kontejnerë për grumbullim të mbeturinave;
- Identifikimi i lokacionit dhe funksionalizmi i deponisë për mbeturina të ngurta / ndërtimore;
- Identifikimi i lokacionit dhe funksionalizimi i deponisë për mbetje shtazore.

### 1.9. Infrastruktura dhe shërbimet e transportit

Komuna e Kamenicës posedon një rrjet të rrugëve që ofrojnë lidhje të mira me komunat tjera në Kosovë dhe shtetet fqinje. Komuna e Kamenicës ka këto distanca me komunat fqinje: 30km me komunën e Gjilanit, me Novobërdën nëse kalojnë rrugës për Gjilan ka një gjatësi prej afro 50 km, ndërsa nëse kalojmë neper rrugën qe përshkon shumë fshatra te Komunës se Kamenicës, si fshatrat Busavatë etj. është afro 25 km më shkurt, me Komunën e Prishtinës ne rruge gjatësore që kalon përmes Gjilanit është afro 75 km, ndërsa ajo që kalon kah Artana është rreth 50 km. Distanca e qendrës së komunës me qendrat tjera të territorit të Serbisë, me Komunën e Bujanocit është rreth 25 km, dhe me komunën e Medvegjes rreth 35 km.

#### 1.9.1. Transporti rrugor

Transporti në Kamenicë, kryesisht realizohet përmes rrugëve automobilistike me një rrjet te rrugëve prej 589.4 km gjatësi. Rrjeti i rrugëve nacionale dhe rajonale që administrohen nga niveli qendror, është në gjatësi prej 112 km. Rrugët lokale janë në gjatësi prej 477.4 km dhe janë përgjegjësi e komunës. Komuna e Kamenicës i ka te rregulluar 281.6 km gjatësi të rrugëve lokale, ndërsa 304.62 km kanë mbetur të parregulluara. Një pjesë e madhe e rrjetit të rrugëve lokale janë të kategorizuara – 477.4 km.




Harta 10 Rrjeti rrugor




Harta 11 Rrjeti rrugor i asfaltuar, dhe i pa-asfaltuar

Investimet në infrastrukturën e transportit kryesisht kanë në fokus lëvizjen e automjeteve private, përderisa transporti i pa motorizuar nuk është adresuar në mënyrë sistematike si

model i lëvizshmërisë në tërë komunën. Trotuaret dhe shtigjet për këmbësorë janë adresuar deri në një masë, kryesisht bazuar në investimet primare në rrugë. Me fokus të veçantë duhet te trajtohen ato segmente të rrugëve që kalohen nga fëmijët në baza ditore (shtëpi-shkollë-shtëpi) apo segmentet nga njëri fshat në tjetrin.

| | | **Kategoritë e rrugëve** | | | | **Gjendja fizike** | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Emri i vendbanimit | Rruge total (km) | Rrugë lokale (km) | Rrugë regjionale (km) | Rrugë nacionale (km) | Auto udhë (km) | Rrugë të asfaltuara (km) | Rrugë me zhavorr (km) |
| Berivojcë | 15.3 | 14.3 | 1.0 | 0 | 0 | 11 | 4.3 |
| Bllatë | 1.5 | 1.5 | 0.0 | 0 | 0 | 1.5 | 0.0 |
| Boscë | 7.0 | 4.4 | 2.6 | 0 | 0 | 5.5 | 1.5 |
| Bratilloc | 4.6 | 2.9 | 1.7 | 0 | 0 | 1.7 | 2.9 |
| Busovatë | 19.5 | 14.0 | 5.5 | 0 | 0 | 5.5 | 14.0 |
| Dajkoc | 2.8 | 2.8 | 0.0 | 0 | 0 | 2.2 | 0.6 |
| Dazhnicë | 6.3 | 6.3 | 0.0 | 0 | 0 | 2.8 | 3.5 |
| Desivojcë | 15.0 | 11.9 | 3.1 | 0 | 0 | 3.1 | 11.9 |
| Feriqevë | 10.5 | 8.3 | 2.2 | 0 | 0 | 10.5 | 0 |
| Gmicë | 11.0 | 10.4 | 0.6 | 0 | 0 | 2.3 | 8.7 |
| Gogolloc | 4.7 | 4.7 | 0.0 | 0 | 0 | 0 | 4.7 |
| Gragjenik | 5.9 | 5.9 | 0.0 | 0 | 0 | 0 | 5.9 |
| Grizimë | 10.4 | 8.7 | 1.7 | 0 | 0 | 2.5 | 7.9 |
| Gjyrishec | 9.8 | 9.8 | 0.0 | 0 | 0 | 0 | 9.8 |
| Hajnoc | 19.2 | 11.9 | 7.3 | 0 | 0 | 12.2 | 7.0 |
| Hodonoc | 15.6 | 12.1 | 3.5 | 0 | 0 | 8.7 | 6.9 |
| Hogosht | 18.8 | 16.4 | 2.4 | 0 | 0 | 15.4 | 3.4 |
| Kamenicë | 36.5 | 30.7 | 5.8 | 0 | 0 | 26.6 | 9.9 |
| Karaçevë e Epërme | 12.8 | 12.3 | 0.5 | 0 | 0 | 9.5 | 3.3 |
| Karaçevë e Poshtme | 10.4 | 6.0 | 4.4 | 0 | 0 | 9 | 1.4 |
| Kolloleq | 6.7 | 4.6 | 2.1 | 0 | 0 | 4.2 | 2.5 |
| Kopernicë | 14.3 | 12.0 | 2.3 | 0 | 0 | 13 | 1.3 |
| Koretin | 26.5 | 23.3 | 3.2 | 0 | 0 | 20 | 6.5 |
| Kostadincë | 9.5 | 9.5 | 0.0 | 0 | 0 | 0 | 9.5 |
| Kranidell | 10.6 | 8.8 | 1.8 | 0 | 0 | 2.7 | 7.9 |
| Kremenatë I | 7.6 | 7.6 | 0.0 | 0 | 0 | 0 | 7.6 |
| Kremenatë II | 2.6 | 2.6 | 0.0 | 0 | 0 | 0 | 2.6 |
| Krilevë | 18.4 | 11.7 | 6.7 | 0 | 0 | 10.4 | 8.0 |
| Lajçiqi | 15.5 | 13.9 | 1.6 | 0 | 0 | 1.6 | 13.9 |
| Leshtar | 10.3 | 9.1 | 1.2 | 0 | 0 | 5 | 5.3 |
| Lisockë | 14.5 | 14.5 | 0.0 | 0 | 0 | 13 | 1.5 |
| Marocë | 2.5 | 2.5 | 0.0 | 0 | 0 | 0 | 2.5 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Meshinë | 15.4 | 13.6 | 1.8 | 0 | 0 | 7 | 8.4 |
| Moçar | 7.3 | 7.3 | 0.0 | 0 | 0 | 1 | 6.3 |
| Muçivërc | 16.5 | 14.5 | 2.0 | 0 | 0 | 14.1 | 2.4 |
| Novosellë | 3.8 | 2.4 | 1.4 | 0 | 0 | 2.7 | 1.1 |
| Petroc | 4.1 | 3.3 | 0.0 | 0.8 | 0 | 3.3 | 0.8 |
| Poliçkë | 14.8 | 14.8 | 0.0 | 0 | 0 | 2.5 | 12.3 |
| Qarrakoc | 4.7 | 4.3 | 0.4 | 0 | 0 | 4.7 | 0 |
| Rahovicë | 7.2 | 7.0 | 0.2 | 0 | 0 | 6.9 | 0.3 |
| Rogaçicë | 16.6 | 13.9 | 2.7 | 0 | 0 | 12 | 4.6 |
| Ruboc | 7.4 | 2.9 | 4.5 | 0 | 0 | 5.5 | 1.9 |
| Sedllar | 2.7 | 2.7 | 0.0 | 0 | 0 | 0 | 2.7 |
| Strelicë | 2.9 | 1.4 | 1.5 | 0 | 0 | 1.8 | 1.1 |
| Strezoc | 13.1 | 9.2 | 3.9 | 0 | 0 | 8.2 | 4.9 |
| Svircë | 3.2 | 0.5 | 2.7 | 0 | 0 | 2.7 | 0.5 |
| Shahiq | 1.5 | 1.5 | 0.0 | 0 | 0 | 0 | 1.5 |
| Shipashnicë e Epërme | 7.2 | 3.7 | 3.5 | 0 | 0 | 3.5 | 3.7 |
| Shipashnicë e Poshtme | 6.0 | 3.5 | 2.5 | 0 | 0 | 5 | 1.0 |
| Tërstenë | 12.1 | 8.9 | 3.2 | 0 | 0 | 0 | 12.1 |
| Topanicë | 16.3 | 14.0 | 2.3 | 0 | 0 | 14.8 | 1.5 |
| Tugjec | 15.9 | 8.0 | 7.9 | 0 | 0 | 14.3 | 1.6 |
| Vaganesh | 2.1 | 2.1 | 0.0 | 0 | 0 | 0 | 2.1 |
| Velegllavë e Epërme | 3.0 | 1.6 | 1.4 | 0 | 0 | 1.4 | 1.6 |
| Velegllavë e Poshtme | 10.5 | 10.5 | 0.0 | 0 | 0 | 0 | 10.5 |
| Vriqec | 7.0 | 5.1 | 1.9 | 0 | 0 | 0 | 7 |
| Zajçec | 9.9 | 3.7 | 6.2 | 0 | 0 | 6.2 | 3.7 |
| Zhujë | 1.6 | 1.6 | 0.0 | 0 | 0 | 1.4 | 0.2 |
| **Total** | **589.4** | **477.4** | **111.2** | **0.8** | **0.0** | **318.9** | **270.5** |

### 1.9.2.Infrastruktura për këmbësorë dhe biçikleta

Infrastruktura për këmbësorë në qytetin e Kamenicës, është relativisht e mirë. Trotuaret

shtrihen përgjatë rrugës kryesore në të dy anët e rrugës dhe janë të ndara fizikisht nga pjesa e rrugës në të cilën lëvizin automjetet dhe mundësojnë lëvizje të lirë dhe të sigurt.

Zona më e frekuentuar e qendrës së qytetit ofron hapësirë të mjaftueshme duke mundësuar lëvizje të lirë për këmbësorë dhe për çiklistë – në mungesë të hapësirave të veçanta për biçikleta.

Ndërsa fshatrat e komunës kanë mungesë të infrastrukturës për këmbësorë dhe çiklistë. Në disa akse rrugore lëvizja e këmbësorëve dhe çiklisteve konsiderohet mjaft e rrezikshme, sidomos në afërsi të shkollave.

Sa i përket infrastrukturës për biçikleta, edhe pse qytetarët e Kamenicës kanë terren mjaft të përshtatshëm për këtë lloj të transportit përfshi fshatrat Berivojcë, Koretin dhe Topanicë, kjo formë e transportit nuk shumë e përdorur në komunë. Komuna, përkundër planifikimeve të mëhershme për ndërtim të shtigjeve për çiklistë, nuk kanë arritur të krijojnë infrastrukturë të tillë ne shumicën e vendbanimeve, por ne dy vitet e fundit ka investuar ne shtigje te çiklizmit sidomos ne qytet , Berivojce, Ruboc dhe Busavate.

Sipas Shoqatës së Çiklistëve në Kamenicë, në komunë ekzistojnë rreth 1,000 çiklistë aktiv. Sipas shoqatës, parakusht për masivizim të këtij lloji të transportit është krijimi I kushteve për lëvizje të sigurt.

Gjendja ekzistuese e trotuareve në komunën e Kamenicës është dhënë si në vijim:

| **Vendbanimi** | **Sipërfaqet e trotuareve m2** | **Sipërfaqet e shtigjeve të biçikletave m2** |
|---|---|---|
| Kamenicë | 12091 | 2120 |
| Koretin | 2378.30 | |
| Berivojcë | 1920 | 450 |
| Hodonoc | 2817,3 | |
| Rogacicë | 1753 | |
| Hogosht | 1753 | |
| Busavatë | 950 | 2380 |
| Topanicë | 3150 | |
| Shipashnicë e poshtme | 375 | |
| Kopërnicë | 1432 | |

### 1.9.3. Linjat transportuese nderkomunale, urbane dhe rurale

Transporti publik ne komunën e Kamenicës ka qenë i organizuar përmes ndërmarrjes publike "Kosovatrans", deri në privatizimin e saj. Sot transporti publik për linjat brenda dhe jashtë komunës së Kamenicës ofrohet nga kompanitë private.

Momentalisht linjat brenda territorit të komunës janë:

- Kamenicë - Karaqevë,
- Kamenicë – Strezoc – Krilevë

Ndërsa jashtë komunës janë:

- Kamenicë – Gjilan - Prishtinë,
- Hogosht - Gjilan – Prishtinë,
- Shipashnicë - Gjilan,
- Karaqevë - Gjilan.

### 1.9.4. Hapësirat ekzistuese për parkim

Gjendja aktuale e parkingjeve në qytetin Kamenicës është relativisht e kënaqshme. Lokacionet ekzistuese të parkingjeve janë të shpërndara kryesisht në afërsi të institucioneve komunale, objekteve arsimore, shëndetësore dhe atyre tregtare, duke u mundësuar qytetarëve kryerjen e shërbimeve dhe aktiviteteve ditore në mënyrë mjaft efikase.

Organizimi i parkingjeve është i organizuar kryesisht në formë drejtkëndore (në kënd 90°), por edhe forma e kombinuar drejtkëndore + gjatësore është organizuar në dy vend-parkingje, ndërsa parkingjet për shërbimet TAXI janë të formës gjatësore.

| **Parkingjet publike** |
|---|

| Lokacioni | Forma e parkimi | Sipërfaqja m² |
|---|---|---|
| Te Viva Fresh | Në kënd 90° | 3,415 |
| Qendra e vjetër tregtare | Në kënd 90° | 335 |
| Te Kryqi i Kuq | Në kënd 90° | 432 |
| Te Higjiena | Në kënd 90° | 718 |
| Te ish hoteli Mineral | Në kënd 90° + gjatësore | 370 |
| Te Policia | Në kënd 90° | 945 |
| Te NLB-ja | Në kënd 90° | 1,116 |
| Te Çerdhja e fëmijëve | Në kënd 90° | 515 |
| Te pompa e karburanteve | Në kënd 90° | 190 |
| Te BPB-ja | Në kënd 90° | 190 |
| Te qarkorja | Në kënd 90° | 632 |
| Te Drejtoria e Urbanizmit | Në kënd 90° | 207 |
| Te qendra tregtare (përballë parkut) | Në kënd 90° | 1,343 |
| Te ura | Gjatësore | 815 |




Harta 12 Harta e parkingjeve ne qytetin e Kamenicës

### 1.9.5.Vlerësimi i gjendjes: Transporti

Komuna e Kamenicës ka lidhje të mira rrugore me komunën e Gjilanit, Novobërdën, Artanën, dhe komunën e Bujanovcit dhe Medvegjës. Komuna ka një rrjet rrugor prej 590 km gjatësi, duke përfshi rrugë nacionale, rajonale dhe lokale. Veturat janë lloji më i përdorur i transportit në komunë. Afërsisht 50% e rrjetit rrugor është i rregulluar, dhe një pjese e madhe e rrjetit janë të kategorizuara. Mirëpo, pavarësisht kategorizimit, rrugët lokale në praktikë ende nuk dallohen sipas funksionit dhe nuk kanë dizajn adekuat i cili do të mbështeste zhvillimet

hapësinore dhe urbane në komunë. Kjo është reflektuar në ndërtimin e një rrjeti të rrugëve me profile joadekuate të cilat pamundësojnë qarkullimin e kënaqshëm dhe lidhjen e duhur të vendbanimeve, apo zonave të ndryshme brenda tyre.

Gjendja e hapësirave për parkim në qytet është kënaqshme, dhe pa ndonjë problem të theksuar. Parkimi nuk është problem i theksuar për shkak të intensitetit të ulët të zhvillimit.

Infrastruktura për këmbësorë dhe biçikleta në qytet është relativisht e mirë, mirëpo nevojitet lidhje më e mirë në mes të zonës urbane dhe vendbanimeve rurale.

| Analiza SWOT - Transporti | |
|---|---|
| **Përparësitë** | **Dobësitë** |
| Shtrirje e mirë e rrjetit rrugor në gjithë territorin e komunës, qasje e mirë në vendbanime;<br>Lidhjet e mira përmes rrugëve magjistrale dhe rajonale;<br>Plani i mobilitetit 2016 – 2020; | Moszbatimi i prioriteteve nga plani i mobilitetit 2016 – 2020;<br>Mungesë e transportit urban – autobusi i qytetit;<br>Mos-kategorizimi i rrugëve;<br>Infrastruktura e pakompletuar për transport të pa motorizuar (këmbësor, biçikleta) – sidomos në fshatra, trotuaret |
| **Mundësitë** | **Rreziqet** |
| Fondet nga niveli qendror Ministria e Infrastrukturës;<br>Fondet nga organizatat donatore;<br>Shfrytëzimi i skemave të ndryshme financiare për funksionalizimin e transportit urban – PPP. | Rritja e numrit të automjeteve në komunë – qytet; |

**Sfidat:**

- Organizimi i transportit urban dhe lidhja me fshatrat afër zonës urbane;
- Investimet në infrastrukturë sipas dokumenteve të miratuara - Kategorizimi i rrugëve lokale dhe investimet konform rrjetit të kategorizimit – dizajn përkatës të rrugës;
- Përparësia e këmbësorëve dhe biçikletave në rrugë;

**Nevojat zhvillimore:**

- Rishikimi i planit te mobilitetit dhe prioriteteve;
- Rregullimi i sistemit për menaxhim të parkimit në komunë;

### 1.10. Infrastruktura dhe shërbimet sociale e publike

#### 1.10.1. Institucionet shëndetësore

Brenda territorit të komunës kryhet vetëm shërbimet në nivelin parësor, i cili përfshinë Qendrën kryesore të mjekësisë familjare (QKMF), qendrat e mjekësisë familjare (QMF) dhe ambulancat e mjekësisë familjare (AMF). Shërbimet specialistike specifike (listo cilat), kryhen vetëm në QKMF e cila gjendet në qytet, përderisa ato përgjithshme kryhen në AMF-të të cilat

janë funksionale. QMF- janë gjithsejt 3 (Kamenicë, Hogosht dhe Rrogoqicë) ku kryhen shërbimet për këto vendbanime dhe ato përreth. Shërbimet kryhen nga ora 7-15, përderisa vetëm QKMF posedon kujdestari. Nga gjithsej 21 objekte të shëndetit parësorë në komunën e Kamenicës 12 prej tyre nuk janë funksionale, që i bie që më shumë se 50% e të gjitha objekteve. Arsyet e mos funksionimit të tyre janë mungesa e stafit shëndetësorë dhe mungesa popullsisë në fshatrat kufitare. Në mungesë të shërbimeve specilistike në AMF, vizitat te mjeku kryesisht kryhen vetëm në QKMF gjë e cila paraqet ngarkesa të mëdha në këtë qendër.

| Lloji i kujdesit parësor | Vendbanimi | Sip $m^2$ | Funksionale (gjendja fizike e objektit) |
|---|---|---|---|
| AMF | Boscë | 97 | X |
| QMF | Rogoqicë | 419 | x |
| AMF | Muqiverc | 204 | |
| AMF | Shipashnic epërme | 108 | x |
| QMF | Hogosht e reja | 445 | x |
| | Hogosht e vjetra | 171 | |
| AMF | Kopernicë | 73 | |
| AMF | Kolloleq | 121 | |
| AMF | Karaqevë e poshtme | 125 | x |
| AMF | Hodonoc | 62 | |
| AMF | Topanicë | 89 | x |
| AMF | Koretin | 154 | x |
| AMF | Busavatë | 71 | |
| AMF | Strezoc | 149 | jashte funksioni |
| AMF | Krilevë | 69 | jashtë funksioni |
| AMF | Hajnoc | 77 | jashtë funksioni |
| AMF | Tugjec | 122 | jashtë funksioni |
| AMF | Poliqkë | 67 | jashtë funksioni |
| AMF | Lisockë | 99 | jashtë funksioni |
| AMF | Desivojcë | 134 | jashtë funksioni |
| QKMF | Kamenicë Objekti kryesor | 813 | E mirë |
| | Kamenicë Stomatologjia | 535 | E mirë |
| | Kamenicë Gjinekologjia | 568 | E mirë |
| | Kamenicë ish-Laboratori | 328 | jashtë funksioni |
| | Kamenicë ish Rentgeni | 185 | jashtë funksioni |
| QMF | Kamenicë Qendër te Kisha | 115 | E mirë |

Tabela 17 Institucionet shëndetësore në komunën e Kamenicës

Shërbimet shëndetësore të cilat ofrohen nga sektori privat janë kryesisht ordinanca stomatologjike.




Harta 13 Objektet shëndetësore

### 1.10.2. Institucionet arsimore

Arsimi në komunën e Kamenicës është i organizuar në 3 nivele: parashkollor (çerdhe) dhe para fillor, fillor/i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë. Të gjitha institucionet arsimore janë publike dhe mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe dhe serbe.

- Çerdhe 2
- Shkolla fillore 20, 17 në gjuhen shqipe dhe 3 serbe
- Shkolla të mesme 5, 3 në gjuhen shqipe dhe 2 serbe.

Komuniteti rom ndjekë mësimet në shkollat serbe. Në komunë e Kamenicës nuk ka ndonjë institucion arsimor privat.

| Institucioni/Emri | Nxënës | Klasa | Personel | Sip m² | Mesatarja e nxënësve ne : | Jo-Funksionale (Gjendja fizike e objektit) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| IP „Filizat" Kamenicë | 73 | 4 | 7 | 580 | 7.94 | Funksionale |
| IP„Sunce" Hajnovc | 82 | 5 | 5 | 250 | 16.4 | Funksionale |
| SHFMU“Avni Rrustemi“ Karaqevë e Epërme | 84 | 9 | 16 | 960 | 9.3 | Funksionale |
| SHFMU “Metush Krasniqi” Rogaçicë | 209 | 16 | 28 | 2012 | 13.1 | Funksionale |
| SHFMU “17 Shkurti” | 113 | 9 | 21 | 1641 | 12.6 | Funksionale |

| **Institucioni/Emri** | **Nxënës** | **Klasa** | **Personel** | **Sip m²** | **Mesatarja e nxënësve ne :** | **Jo-Funksionale (Gjendja fizike e objektit)** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Muqiverc | | | | | | |
| SHFMU “Rexhep Mala” Topanicë | 218 | 17 | 15 | 1277 | 12.8 | Funksionale |
| SHFMU “Sadri Misini” Shipashnicë e Epërme | 183 | 18 | 26 | 1785 | 10.2 | Funksionale |
| SHFMU “Dëshmorët e Kombit” Kamenicë | 461 | 26 | 49 | 3975 | 17.7 | Funksionale |
| SHFMU “Fan Noli” Kamenicë | 400 | 23 | 38 | 2667 | 17.4 | Funksionale |
| SHFMU “Xhavit Ahmeti” Hodonoc | 137 | 10 | 21 | 1365 | 13.7 | Funksionale |
| SHFMU “Abdullah Krashnica-Presheva” Koretin | 269 | 18 | 26 | 1711 | 14.9 | Funksionale |
| SHFMU “Skënderbeu” Hogosht | 179 | 17 | 31 | 3729 | 10.5 | Funksionale |
| SHFMU„”Kadri Zeka" Desivojcë | 44 | / | / | 258 | / | Jo-funksionale |
| SHFMU„Nuhi Berisha" Tuxhec | 20 | / | / | 261 | / | Jo-funksionale |
| SHFMU „Asllan Thaqi" Karaqevë e Poshtme | 102 | 10 | 14 | 1070 | 10.2 | Funksionale |
| SHFMU „Hasan Prishtina" Busavatë | 104 | 4 | 6 | 1042 | 26 | Funksionale |
| SHFMU „Idriz Seferi" Strezoc | 58 | / | / | 1937 | / | Jo-funksionale |
| SHFMU „7 Shtatori" Krilevë | 34 | / | / | 316 | / | Jo-funksionale |
| SHFMU „Xhelal Sopi" Petroc | 106 | 10 | 6 | 840 | 10.6 | Funksionale |
| Gjimnazi„ Ismail Qemali" Kamenicë | 414 | 13 | 28 | 1719 | 31.8 | Funksionale |
| SHMLP„Andrea Durrsaku" Kamenicë | 275 | 15 | 30 | 1750 | 18.3 | Funksionale |
| SHFMU„Desanka Maksimoviq" Kamenicë | 367 | 12 | 46 | 960 | 14.1 | Funksionale |
| SHFMU „Bratstvo" Strezoc | 42 | 8 | 15 | 250 | 5.25 | Funksionale |
| SHFMU „9 Maji Kolloleq | 17 | 8 | 7 | 450 | 2.12 | Funksionale |
| Gjimnazi„ Kamenicë Gimnazija" | 99 | 8 | 12 | 640 | 12.37 | Funksionale |

| Institucioni/Emri | Nxënës | Klasa | Personel | Sip $m^2$ | Mesatarja e nxënësve ne : | Jo-Funksionale (Gjendja fizike e objektit) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| SHMLP„Tehniçka" Kamenicë | 79 | 6 | 23 | 480 | 13.2 | Funksionale |
| SHMLM „Sejdi Kryeziu" Rogacicë | 385 | 13 | 35 | 1160 | 29.6 | Funksionale |

Tabela 18 Institucionet arsimore në komunë ne Kamenicës




Harta 14 Objektet Arsimore

Raporti mësimdhënës nxënës, në komunën e Kamenicës është si vijon: Edukatorë/fëmijë në nivelin parashkollor/çerdhe është: 1 edukator /15.4 fëmijë. Në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët, raporti mësimdhënës-nxënës në komunë e Kanicës është 1 mësimdhënës/ 8.2 nxënës, qe në të njëjtën Kohë paraqet raportin më të ulët mësimdhënës/nxënës në Kosovë[5]. Bazuar në raportin e vlerësimit të sistemit arsimor në komunën e Kamenicës i bërë për qëllim të riorganizimit të shkollave, thuhet se 40% e shkollave nuk kanë mjedis të përshtatshëm higjienik, 8 shkolla nuk kanë as tualete, 50% e shkollave nuk kanë kabinete të informatikës, 24 nga 29 shkolla janë pa salla sportive të mbyllura dhe 10 shkolla nuk kanë hapësira për rekreacion.

5 54395_shkolla_te teperta.pdf (institutigap.org)

Në Komunën e Kamenicës, 51% e shkollave kanë më pak se 70 nxënës: gjashtë shkolla kanë më pak se pesë nxënës, gjashtë shkolla më pak se 20 nxënës, dhe tri shkolla kanë më pak se 70 nxënës.[6] Kjo ka bërë që komuna e Kamenicës ta ri-mendojë sistemin e objekteve shkollore në Kamenicë, dhe të hartojë një strategji për grumbullimin e nxënësve në shkolla dhe shfrytëzimin e hapësirave shkollore për qëllime tjera të cilat do të i sillnin përfitime socio-ekonomike komunës së Kamenicës.

### 1.10.3. Institucionet kulturore

Në komunën e Kamenicës janë 3 objekte të cilat janë të dedikuara si objekte kulturore, ku në shtëpinë e kulturës është i vendosur edhe arkivi historik i komunës.

- Qendra e Kulturës
- Teatri i Qytetit "Aleksandër Moisiu"
- Shtëpia e Kulturës "Selver dhe Emin Kryeziu" Roganë
- Arkivi historik komunal

Në anën tjetër bibliotekat janë pjesë e objekteve shkollore të shpërndara në gjithë territorin e komunës:

[6] 54395_shkolla_te teperta.pdf (institutigap.org)

- Biblioteka "Drita"
- Biblioteka në Roganë
- Biblioteka në Karaqevë të Ulët
- Biblioteka në Tugjec
- Biblioteka në Hogosht
- Biblioteka në Strezoc




Harta 15 Objektet Sportive

Bibliotekat të cilat gjenden në Kamenicë kanë një fond të konsiderueshëm të librave. Aktivitete teatrale organizohen në teatrin e qytetin me program i cili mbështetët nga DKRS. Në qendrën kulturore po ashtu ka mbahen organizime të cilat kryesisht përkrahen nga drejtoria e arsimit dhe kulturës në komunë. Në Kamenicë nuk ka ndonjë ndërtesë të veçantë të muzeut.

#### 1.10.4. Institucionet sportive dhe rekreative

Sporti dhe aktivitetet sportive në komunën e Kamenicës mbështetën rregullisht nga DKRS, dhe paraqet një ndër të sektorët më me interes në komunë. Janë gjithsejte 8 hapësira sportive, 7 prej të cilave janë stadiume futbolli. Kjo në të njëjtën kohë paraqet në disbalanc në mes të disiplinave tjera sportive ndaj futbollit. Është vetëm një palestër sportive e mbuluar, ku mund të mbahen aktivitete tjera. Komuna e Kamenicës ka një pishinë të hapur publike dhe disa private.

Përpos objekteve e hapësirat të cilat menaxhohen nga DKRS, komuna e Kamenicës posedon edhe hapësirat sportive të cilat gjenden në kuadër të shkollave të cilat menaxhohen nga DKA. Pavarësisht kësaj vlerësohet se komuna e Kamenicës nuk ka rrjet funksional të hapësirave dhe objekteve sportive dhe do të duhej që të identifikoj

fushat/disiplinat në të cilat do të investojë për 8 vitet e ardhshme.

| Hapësira sportive | Numri I klubeve | Sip m² | Funksionale (gjendja fizike e hapësirës) |
|---|---|---|---|
| Palestra e Sporteve Kamenice | 6 | 3,150 | Nën mesatare |
| Stadiumi 'Agush Isufi' Kamenice | 6 | 11,000 | E mirë |
| Stadiumi Koretin | 1 | 10,000 | Jo e mirë |
| Stadiumi Hogosht | 0 | 10,000 | Jashtë përdorimit |
| Stadiumi Karaqevë | 0 | 10,000 | Jo e mirë |
| Fushë Sportive Novosellë | 0 | -- | Jashtë përdorimit |
| Stadium Futbolli Shipashnicë e Epërme | 1 | 10,000 | Jashtë përdorimit |
| Stadium Futbolli Muqiverc | 0 | 10,000 | Jashtë përdorimit |

Tabela 19 Objektet sportive

#### 1.10.5. Hapësira të Hapura Publike

Komuna e Kamenicës veçohet si një ndër Komunat e pakta në Kosovë e cila karakterizohet me sipërfaqe kualitative të hapura publike. Në këtë kategori përfshihen: parqet, hapësirat gjelbëruese, hapësirat për parkim automjetesh, trotuaret, varrezat, Varrezat e Dëshmorëve , Lapidaret dhe hapësirat për-rreth objekteve fetare. Për dallim prej shumicës së komunave të Kosovës në Kamenicë, në veçanti ne qendër të qytetit është ruajtur morfologjia e qytetit me karakter të gjelbër e kualitet të mirë të gjelbërimit, shtigjeve për këmbësorë, shtigjeve te çiklizmit dhe sheshit. Investimi në sheshin e qytetit ka pasuruar dhe ka përmirësuar dukshëm jetën publike e sociale në qytet .

| HP sipas tipologjisë | Sipërfaqja ne m2 | Nr. i banoreve | Sip e HP ne m2 / ban. |
|---|---|---|---|
| Parqe | 15004 | 8918 | 1.70 |
| Hapësira të gjelbra dhe shëtitore | 57971 | 8918 | 6.50 |
| Sheshe | 1410 | 8918 | 0.20 |
| Terrene sportive | 26024 | 8918 | 2.92 |
| Lapidare dhe memorialë | 5988 | 8918 | 0.67 |
| Gjithsejtë ne m2 | 106397 | 8918 | 11.93 |

Tabela 20 Hapura Publike sipas tipologjisë

| HP sipas tipologjisë | Sipërfaqja ne m² | Nr. i banoreve | Sip e HP / ban. |
|---|---|---|---|
| Parkingje | 11493 | 8919 | 1.28 |
| Tregje te gjelbra | 2871 | 8919 | 0.32 |
| Trotuare | 15702 | 8919 | 1.76 |
| Gjithsejtë ne m² | 30,066.00 | 8919 | 3.37 |

Tabela 21 Sipërfaqet e ndërtuara dhe te tjera

Nga tabelat me lartë, është evidente se standardi i planifikuar prej 6 deri ne 9m2/ban. për hapësira gjelbëruese ne komunën e Kamenicës arrihet. Sipërfaqja aktuale e HHP për rekreacion aktiv dhe pasiv është 11,93m2/ban, ndërsa vetëm për hapësira gjelbëruese,

8.20m2/ban (tab. 2). Oferta aktuale ne aspektin e qasjes, me fokus ne largësinë (distance – kohe) dhe ne aspektin e rrezes se mbulimit me HHP është mjaft mirë e mbuluar.

### 1.10.6. Institucionet e Mirëqenies Sociale dhe Komunitetit

Në bazë të ligjit për shërbime sociale dhe të familjes ofrohen shërbime sociale për të gjitha kategoritë sociale që kanë nevojë për mbrojtje institucionale në komunë e Kamenicës. Po ashtu, në bazë të Ligjit të Skemës së Asistencës Sociale familjet në nevojë ekonomike përkrahën me mjete financiare të rregullta mujore .

Përveç kësaj, nga subvencionet e komunës mbështeten persona dhe familje me nevoja emergjente të natyrës socio-ekonomike, shëndetësore apo të kushteve të banimit. Shërbimet e mirëqenies sociale dhe të komuniteti janë të vendosura në objektet si vijon.

| Institucionet e mirëqenies sociale dhe komunitetit | Sipërfaqja parcelës (ha) | Sipërfaqja ndërtuar (ha) | Sipërfaqja ($m^2$) | Sipërfaqja (ha) | Gjendja fizike e objektit |
|---|---|---|---|---|---|
| Qendra për punë sociale | 0.062 | 0.02 | 800 | / | e mirë |
| Zyra Komunale e Punësimit | 0.088 | 0.035 | 350 | 0.02 | e mirë |
| Objekti i Handikos | 0.21 | 0.035 | 350 | 0.15 | jo e mirë |
| Shtëpia e Komunitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara Mendore | 1.21 | 0.035 | 350 | 0.15 | e mirë |
| Kryqi i kuq i Kosovës | 0.08 | 0.013 | 130 | 0.05 | e mirë |

Tabela 22 Institucionet e mirëqenies sociale dhe komunitetit

Në vitin 2023, janë më shumë se 409 familje të cilat marrin asistencë sociale nga komuna, përderisa komuna ofron edhe Shtëpinë me Bazë në Komunitet, e cila menaxhohet nga DHSMS ku aktualisht strehohen 10-20 persona të cilët kanë ngecje në zhvillim dhe nevojë për kujdes profesional.




Harta 16 Harta e institucioneve të mirëqenies dhe komunitetit

### 1.10.7. Institucionet fetare

Bashkësitë fetarë në komunën e Kamenicës janë: islame, ortodokse e katolike. Janë gjithsejte 32 xhami të shpërndara në gjithë territorin e komunës. Shumica prej tyre janë në gjendje të mirë marrë parasysh që janë rinovuar/restauruar disa herë.

| Emërtimi | Lagjja/Fshati | Viti i ndërtimit | Gjendja fizike e objektit |
|---|---|---|---|
| Xhamia "Haxhi Gani Sermaxhaj" | Kamenicë | 1981 | E mire<br>Minareja 2000<br>Kjo xhami ka përfunduar tërësisht më 1996<br>2016 - meremetim |
| Xhamia e Pazarit | Kamenicë | 2006 | E mire<br>Ka filluar në prill 2006, Ka përfunduar në nëntor 2006 |
| Xhamia e Topanicës – 1 | Fshati Topanicë | 1700 | E mire<br>1970 rindërtim<br>2005 meremetim i plotë |
| Xhamia e Topanicës – 2 | Fshati Topanicë | 2011 | E mire<br>2010 – Ka filluar |
| Xhamia e Rogoqicës | Fshati Rogoqicë | 1839 | E mire<br>1979 rindërtim<br>2005 meremetim<br>2015 meremetim i brendshëm dhe ndrrimi i dritareve |

| Emërtimi | Lagjja/Fshati | Viti i ndërtimi t | Gjendja fizike e objektit |
|---|---|---|---|
| Xhamia e Karaqevës së Ulët | Fshati Karaqevë e Ulët | 1880 | E mire<br>1958 rindërtim<br>1990 rindërtim<br>2005 meremetim<br>2018 ndërtimi i gasullhanes, morgut, dhe blerja e furgonit për shërbime mortore<br>2019 ndrrimi i dyerve dhe dritareve të xhamisë, fasadimi i brendshëm |
| Xhamia e Karaqevës së Epërme | Fshati Karaqevë e Epërme | 1883/85 | E mire<br>1964 minarja<br>Rindërtim 1996<br>2016 – meremetim<br>2019 restaurim i brendshëm |
| Xhamia e Muqivërcit | Fshati Muqivërcë | 1935 | E mire<br>1997 Rindërtim<br>2000 minarja<br>2016 – meremetim<br>2018 – ndërtimi i gasullhanes dhe blerja e furgonit për shërbime mortore<br>2019 restaurim i brendshëm |
| Xhamia e Shipashnicës së Epërme | Fshati Shipashnicë e Epërme | 1900 | E mire<br>1966 rindërtim<br>2019 restaurim i brendshëm<br>2020 rindërtim |
| Xhamia e Shipashnicës së Poshtme | Fsh. Shipashnicë e Poshtme | 2002 | E mire<br>2006 – minarja |
| Xhamia e Hogoshtit | Fshati Hogosht | 1885 (1750)? | E mire<br>1967/8 rindërtim<br>2016 – meremetim<br>2020 ndërrimi i kupolave dhe fasadimi i minares |
| Xhamia e Kopernicës | Fshati Kopernicë | 1938 | E mire<br>1963 minarja<br>2000 dhe 2005 meremetim |
| Xhamia e Desivojcës | Fshati Desivojcë | 1816 | Mesatare<br>1970 minarja<br>2008 - ka filluar xhamia e re<br>2011 – ka përfunduar<br>2021 fasadimi i minares dhe ndërtimi i abdeshanes ( shadervanit) |
| Xhamia e Petritit | Fshati Petrit | 2002 | E mire<br>Podrumi ka filluar më 1990 ku janë falur deri në vitin 2002., kurse xhamia komplet ka përfunduar në vitin 2002 |
| Xhamia e Koretinit - 1 (Xhamia e vjetër) | Fshati Koretin | 1880 | E mire<br>1967 rindërtim<br>2012 – Meremetim i tërësishëm, në vend të kulmit kanë ndërtuar kupolat |

| Emërtimi | Lagjja/Fshati | Viti i ndërtimit | Gjendja fizike e objektit |
|---|---|---|---|
| Xhamia e Koretinit - 2 (Xhamia e re) | Fshati Koretin | 2013 | E mire<br>Ka filluar 2011 |
| Xhamia e Poliçkës | Fshati Poliçkë | 1908 (1905) | Mesatare<br>2005/06 meremetim |
| Xhamia e Hodonocit - 1 | Fshati Hodonoc | 1686(1538) sakt | E mire<br>1978 rindërtim<br>2003-meremetim<br>2013 meremetim i brendshëm dhe ndërrimi i dritareve dhe ndërtimi i aneksit |
| Xhamia e Hodonocit - 2 | Fshati Hodonoc | 2014 | E mire<br>v. 2011 ka filluar ndërtimi |
| Xhamia e Dajkocit | Fshati Dajkoc | 1935 (1919) | E mire<br>Xhamia e re ka filluar 2011<br>2012 – Ka përfunduar |
| Xhamia e Krilevës | Fshati Krilevë | 1846(1885)? | Mesatare<br>(1266 hixhrij) |
| Xhamia e Busavatës | Fshati Busavatë | 1938 (1890)? | Mesatare<br>1977 rindërtim, me minare<br>2016 - meremetim |
| Xhamia e Berivojcës | Fshati Berivojcë | 1926 | Mesatare<br>v. 1934 - Është shkatërruar<br>v. 2008 – ka filluar rindërtimi, por është ndaluar nga banorët serbë për arsye politike<br>v. 2013 - Ka filluar ndërtimi i ri në një lokacion tjetër<br>v. 2014 - aktive, mungon minarja, nuk janë finalizuar punimet<br>v. 2017 – finalizohet dhe ndërtohet minarja. |
| Xhamia e Novosellës | Fshati Novosellë | 2017 | E mire<br>2014 - fillimi i punimeve<br>2017 – finalizimi, vetëfinancim |
| Xhamia e Strezovcit | Fshati Strezovc | 2015 | Mesatare |
| Xhamia e Tugjecit | Fshati Tugjec | 1890(1906)? | Mesatare<br>1995 minarja |

Tabela 23 : Lista e objekteve fetare/xhamive - funksionale

| | Emërtimi | Lagjja/Fshati | Viti i ndërtimit | Gjendja fizike e objektit |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Xhamia e Kranidellit | Fshati Kranidell | 1928 | Mesatare<br>Pa minare |
| 2. | Xhamia e Sfircës | Fshati Sfircë | 1890 | Jo e mirë<br>Pasive (pa minare) |
| 3. | Xhamia e Zajqecit | Fshati Zajqec | 1790 (1279 h.) | Mesatare<br>2008 – Rindërtim<br>Aktive vetëm Bajrameve |
| 4. | Xhamia e | Fshati Meshinë | 1866 | Jo e mirë |

| | Emërtimi | Lagjja/Fshati | Viti i ndërtimit | Gjendja fizike e objektit |
|---|---|---|---|---|
| | Meshinës | | (1886) (1915) | Pasive |
| 5. | Xhamia e Vriqecit | Fshati Vriqevc | 1826 | Mesatare<br>Pasive (pa minare)<br>2021 meremetim nga MKRS |
| 6. | Xhamia e Zhujës | Fshati Zhujë | 1816 | Mesatare<br>1946 Rindërtim<br>1996 rindërtim |

Tabela 24 Lista e objekteve fetare/xhamive – funksionale (jo-funksionale)

#### 1.10.8. Ndërtesat e administratës dhe sigurisë

Shërbimet komunale në komunën e Kamenicës ofrohen në 3 objekte në ndara në zonën urbane. Listo drejtoritë se si janë të vendosura në secilën ndërtesë, shto nëse mungon në tabelën poshtë.

Gjykata komunale është vendosur në ndërtesë të veçantë. Shërbimet postare në komunë e Kamenicës kryhet në ndërtesën e postës në qytet, si dhe në fshatin Hogosht. Janë 2 ndërtesa të policisë , një në zonën urbane dhe një në Muqivrc dhe dy stacione të zjarrfikësve, në të njëjtat vendbanime.

| | Institucionet Administrative | Sipërfaqja e parcelës (ha) | Sipërfaqja e ndërtuar (ha) | Sipërfaqja e lire (ha) | Sipërfaqja ($m^2$) |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Kuvendi Komunal | 0.72 | 0.10 | 0.62 | 3000 |
| 2. | Stacioni Policor | 0.26 | 0.037 | 0.223 | 1110 |
| 3. | Zyra e gjendjes civile Kamenicë | 0.08 | 0.034 | 0.046 | 200 |
| 4. | Zjarrfikës | 0.33 | 0.023 | 0.307 | 230 |
| 5. | Zjarrfikës Muqiverc | 0.20 | 0.02 | 0.18 | 200 |
| 6. | Stacioni Policor Muqiverc | 0.15 | 0.02 | 0.13 | 680 |
| 7. | Zyre vendi Muqiverc | 0.06 | 0.012 | 0.048 | 120 |
| 8. | Zyre vendi Hogosht | 0.038 | 0.015 | 0.023 | 150 |
| 9. | Gjykata komunale Kamenicë | 0.224 | 0.048 | 0.176 | 1760 |
| 10. | Zyra e postës | 0.275 | 0.087 | 0.188 | 1880 |

Tabela 25 Inventari i institucioneve administrative regjistri sipas vendbanimeve, 2018




Harta 17 Institucionet publike dhe sociale

| Numri i banorëve viti 2031 | Kërkesat NTPH për banor m² | Sipërfaqja aktuale parcelës m² | Kërkesat hapësinore m² | Sipërfaqja e nevojshme m² |
|---|---|---|---|---|
| 40151 | 0.6 | 18,380.00 | 24,094.20 | (5,714.20) |

Tabela 26 Vlerësimi i nevojave hapësinore për administratë bazuar në kërkesën e NTPH prej 0.60m2/banorë

### 1.10.9. Varrezat Publike

Në përgjithësi, secili vendbanim në Komunë i ka të ndara sipërfaqet e veta që i shfrytëzon për varreza. Numri i lokacioneve të varrezave në komunës është 55, ndërsa sipërfaqja totale e tyre është rreth 38 ha. Përveç funksionit primar, sipërfaqet e varrezave nuk posedojnë ndonjë përmbajtje tjetër plotësuese si hapësira te kultit të cilat janë në funksion të varrezave, përveç qe ne disa lokacione ekzistojnë edhe objektet ndihmese si: hapësira për deponimi, etj. Afërsisht secili vendbanim në komunë e Kamenicës ka të caktuara vendet e varrezave. Numri i lokacioneve te varrezave është gjithsej 55, dhe vetëm 3 vendbanime nuk kane lokacion të caktuar të varrezave.

| | Lokacioni # | Sipërfaqja e parcelës (ha) | Sipërfaqja e ndërtuar (ha) | Sipërfaqja e lire (ha) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Berivojcë | 0.38 | 0.08 | 0.30 |
| 1 | Bllatë | 0.37 | 0.07 | 0.30 |
| 2 | Huboc | 0.53 | 0.11 | 0.42 |
| 3 | Bratilloc | 0.16 | 0.03 | 0.13 |
| 4 | Busovatë | 1.05 | 0.11 | 0.95 |

| | Lokacioni # | Sipërfaqja e parcelës (ha) | Sipërfaqja e ndërtuar (ha) | Sipërfaqja e lire (ha) |
|---|---|---|---|---|
| 5 | Dajkoc | 0.18 | 0.04 | 0.14 |
| 6 | Dazhnicë | 0.54 | 0.11 | 0.43 |
| 7 | Desivojcë | 1.06 | 0.21 | 0.85 |
| 8 | Feriqevë | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| 9 | Gmicë | 0.76 | 0.08 | 0.68 |
| 10 | Gogolloc | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| 11 | Gragjenik | 1.14 | 0.23 | 0.91 |
| 12 | Grizimë | 0.26 | 0.05 | 0.21 |
| 13 | Gjyrishec | 1.33 | 0.27 | 1.06 |
| 14 | Hajnoc | 0.70 | 0.14 | 0.56 |
| 15 | Hodonoc | 2.87 | 0.57 | 2.30 |
| 16 | Hogosht | 1.10 | 0.33 | 0.77 |
| 17 | Kamenicë U | 1.34 | 0.94 | 0.40 |
| 18 | Karaçevë e Epërme | 0.34 | 0.07 | 0.27 |
| 19 | Karaçevë e Poshtme | 0.09 | 0.02 | 0.07 |
| 20 | Kolloleq | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| 21 | Kopernicë | 0.22 | 0.07 | 0.15 |
| 22 | Koretin | 1.97 | 0.39 | 1.58 |
| 23 | Kostadincë | 0.09 | 0.02 | 0.07 |
| 24 | Kranidell | 0.99 | 0.20 | 0.79 |
| 25 | Kremenatë I | 1.02 | 0.10 | 0.92 |
| 26 | Kremenatë II | 0.09 | 0.02 | 0.07 |
| 27 | Krilevë | 0.44 | 0.13 | 0.31 |
| 28 | Lajçiqi | 1.13 | 0.23 | 0.90 |
| 29 | Leshtar | 0.18 | 0.04 | 0.14 |
| 30 | Lisockë | 1.15 | 0.23 | 0.92 |
| 31 | Marocë | 0.47 | 0.09 | 0.38 |
| 32 | Meshinë | 0.72 | 0.14 | 0.58 |
| 33 | Moçar | 0.20 | 0.04 | 0.16 |
| 34 | Muçivërc | 1.03 | 0.21 | 0.82 |
| 35 | Novosellë | 0.76 | 0.15 | 0.61 |
| 36 | Petroc | 0.45 | 0.09 | 0.36 |
| 37 | Poliçkë | 0.94 | 0.19 | 0.75 |
| 38 | Qarrakoc | 0.12 | 0.02 | 0.10 |
| 39 | Rahovicë | 0.60 | 0.06 | 0.54 |
| 40 | Rogaçicë | 1.11 | 0.33 | 0.78 |
| 41 | Ruboc | 0.05 | 0.01 | 0.04 |
| 42 | Sedllar | 1.47 | 0.29 | 1.18 |
| 43 | Strelicë | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| 44 | Strezoc | 0.81 | 0.16 | 0.65 |
| 45 | Svircë | 0.56 | 0.11 | 0.45 |
| 46 | Shahiq | 0.12 | 0.02 | 0.10 |

| | Lokacioni # | Sipërfaqja e parcelës (ha) | Sipërfaqja e ndërtuar (ha) | Sipërfaqja e lire (ha) |
|---|---|---|---|---|
| 47 | Shipashnicë e Epërme | 1.42 | 0.43 | 0.99 |
| 48 | Shipashnicë e Poshtme | 1.04 | 0.21 | 0.83 |
| 49 | Tërstenë | 0.44 | 0.09 | 0.35 |
| 50 | Topanicë | 0.21 | 0.04 | 0.17 |
| 51 | Tugjec | 1.28 | 0.26 | 1.02 |
| 52 | Vaganesh | 0.31 | 0.06 | 0.25 |
| 53 | Velegllavë e Epërme | 0.46 | 0.09 | 0.37 |
| 54 | Velegllavë e Poshtme | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| 55 | Vriqec | 0.46 | 0.09 | 0.37 |
| 56 | Zajçec | 0.88 | 0.18 | 0.70 |
| 57 | Zhujë | 0.35 | 0.07 | 0.28 |
| | **Gjithsej** | **37.74** | **8.30** | **29.44** |

Tabela 27 Sipërfaqet ekzistuese te varrezave




Harta 18 Harta e varrezave dhe objekteve fetare

### 1.10.10. Vlerësimi i gjendjes

| Përparësitë | Mangësitë |
|---|---|
| Infrastrukturë e mjaftueshme shkollore | Infrastrukturë shkollore jo kualitative |
| Infrastrukturë e mjaftueshme shkollore për të gjitha nivelet | Mungesa e kabineteve profesionale |
| Infrastrukturë e mire e institucioneve | Mungesa e sallave të kulturës fizike në gjitha shkollat |

| | |
|---|---|
| kulturore<br>Hapësirat për sport (stadiumi i qytetit, palestra sportive , sallat e edukatës fizike në disa shkolla fillore dhe te mesme.<br>Tradita për sport<br>Hapësirat për zhvillimin e sportit nëpër fshatra, fushat e futbollit<br>Në shumicën e fshatrave ka poligone sportive.<br>Përcjellja e aktiviteteve nga qytetaret është në nivelin e dëshiruar. | Mungesa e shkallëve emergjente<br>Mungesa e infrastrukturës shëndetësore nëpër shkolla<br>Mirëmbajtja jo e kënaqshme e infrastrukturës publike e sociale në përgjithësi<br>Mospërkrahja e nivelit qendror, mbështetja medieve<br>Mungesa e stafit edukativ<br>Mungesa e buxhetit për mjetet e konkretizimit<br>Infrastrukturë sportive jo kualitative |
| **Mundësitë** | **Kërcënimet** |
| Riorganizim dhe adaptim i objekteve ekzistuese shkollore<br>Përmirësimi i qasjes së personave me nevojë të veçanta<br>Ndërtimi i sallave sportive nëpër shkolla<br>Hapja e paraleleve parashkollore në shkollat fillore<br>Ndërtimi i çerdheve të reja edhe në zonat rurale<br>Përmirësimi i infrastrukturës sportive, mirëmbajtja e objekteve ekzistuese nëpër fshatra<br>Planifikimi dhe përgatitja e projekteve për mbështetjen e iniciativave kulturore në zonat rurale<br>Krijimi i data bazës elektronike me te gjitha informacionet kulturore në komunën tonë<br>Ndërtimi dhe aktivizimi i qendrave rinore ne zonat rurale<br>Ndërtimi i hapësirave për moto kros dhe motobike, ndërtimi i hapësirave për shigjetari në zonat malore | De popullimi i zonave rurale<br>Ikja e popullsisë së re nga komuna<br>Mbështetje e ulët nga niveli qendror dhe donatorët<br>Ikja e kuadrove sportive, kulturore, shkencore jashtë vendit.<br>Mungesa e ekspozimin ndaj përvojave në gara ndërkombëtare. |

**Sfidat:**

**Infrastruktura publike dhe sociale**

Shëndetësia dhe përkujdesja sociale - sfidat

- Mirëmbajtja e standardit të shërbimeve në objektet shëndetësore;
- Buxheti i pamjaftueshëm për të përmbushur kërkesat për asistencë sociale;
- Ofrimi i politikave lokale për programe të banimit social të integruar.
- Zbutja e varfërisë dhe papunësisë.

**Institucionet arsimore – sfidat**

- Shkalla e ulët e përfshirjes së fëmijëve ne edukimin parashkollor;
- Buxheti i kufizuar për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës shkollore.
- Mungesa e institucioneve parashkollore në zonat rurale
- Ndërlidhje jo e volitshme e Arsimit për Aftësimin Profesional me kërkesat e tregut të punës;
- Mungesa e kushteve për kryerjen e punës praktike nëpër shkolla (punëtoritë, laboratorët, rrjeti i teknologjisë informative);

**Administrata publike - sfidat**

- Sigurimi i hapësirave / kushteve për punë për funksionimin e bashkësive lokale;

**Objektet kulturore – sfidat**

- Mungesa e aktiviteteve dhe programeve kulturore
- Ndërlidhja e potencialeve të komunës me aktivitet kulturore p.sh. festival ne natyre, eko turizëm

### 1.11. Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri

#### Mjedisi

Komuna e Kamenicës si një nga komunat me dendësi të ulët të popullsisë dhe zhvillim jo të lartë industrial nuk karakterizohet me ndotje te madhe të mjedisit e cila e karakterizon atë. Gjithsesi, ndotja më e theksuar paraqitet në ujëra ngase një përqindje e madhe e ujërave të zeza si nga amvisëritë po ashtu edhe nga industritë e vogla dergjen direkt në lumenj. Faktorët të cilët kryesisht ndikojnë në ndotjen e mjedisit janë si vijojnë:

- Mbeturinat inerte te cilat hedhen përgjatë rrugëve
- Gurëthyesit
- Ndezja e mbetjeve në deponi të egra
- Trafiku rrugor, sidomos në zonën urbane në veçanti pasi që zona urbane nuk ka ndonjë rrugë unazore
- Shkarkimi i ujërave të zeza në lumenj
- Ngrohja individuale me karburante

#### Ajri

Edhe pse nuk monitorohet e nuk dihet se cilët përbërës dhe sa janë prezent në të, ai është i ndotur në zonën urbane. Ajri në zonën urbane gjatë muajve të dimrin ne veçanti është mjaft i ndotur, ku burimet kryesore të ndotjes janë transporti rrugorë dhe djegiet të cilat shfrytëzohen për ngrohje.

**Uji**

Pasi që shumica dërmuese e vendbanimeve në komunën e Kamenicës nuk janë të lidhura në sistemin e kanalizimit, kjo ndikon dukshëm në ndotjen e ujërave, pasi që i gjithë rrjeti i kanalizimit dergjet i pa trajtuar në lumin Krivarekë. Për më tepër asnjë vendbanim tjetër përpos zonës urbane nuk i ka të ndara sistemin e kullimit të ujërave atmosferik dhe kjo rrite sasinë e ujërave të ndotur dhe të pa trajtuar.

**Toka**

Në këtë komunë toka është e ndotur nga prania e deponive ilegale të mbeturinave ku 72 % e popullatës janë përfshirë në shërbimin e menaxhimit të mbeturinave. Mirëpo është duke u punuar në implementimin e projektit për eliminimin e deponive ilegale dhe transferimin e mbeturinave në deponinë regjionale.

Numri, madhësia dhe lokacioni i deponive ilegale është dhënë në tabelën e mëposhtme.

| Madhësia | Sasia | Lokacioni |
|---|---|---|
| Të mëdha | 3 | Berivojcë, Muqiverc dhe Rogaqicë |
| Të mesme | 4 | Busavatë, Berivojcë, Topanicë, dhe Dajkoc |
| Të vogla | 1 | Hodonoc |

Degradimi i tokës shkaktohet edhe nga prerja e pyjeve dhe funksionimi i gurëthyesve si dhe shfrytëzimi i inerteve në lumenj. Në ndotjen e tokës ndikon edhe mos trajtimi i ujërave të zeza të cilat derdhen në lumenj dhe ndikojnë në ndotjen e tokës dhe ujërave nëntokësore.

Mbrojtja e mjedisit ndërlidhet, me sektorin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, zhvillimit të turizmit, bujqësisë dhe ka efekt pozitiv në to. Mbeturinat e ngurta të akumuluara në deponitë ilegale janë po ashtu një ndër faktorët të cilën ndikojnë në ndotjen e mjedisit në komunë. Këto janë kryesisht deponi ilegale të mbeturinave shtëpiake, dhe në disa raste mbetjeve të ndërtimit, të cilat kryesisht gjenden në afërsi të rrugëve. Ndikimet negative të këtyre deponive janë të shumta, ku përveç kontaminimit të drejtpërdrejtë të tokës dhe ajrit, ndikimi i tyre mund të bartet në rrjedhat e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë nëpërmjet reshjeve.

### 1.11.1.Sipërfaqet me rrezikshmëri

**Tërmetet**

Komuna e Kamenicës si edhe pjesa ma e madhe e Kosovës paraqet një rajon me aktivitet sizmik të lartë Ajo ndodhet në zonën sizmogjene Gjilan-Kamenicë me magnitude

maksimale 6.1 shkalla Rihter.




Harta 19 Zonat e rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësive tjera

### Vërshimet

Komuna e Kamenicës është e pasur me burime ujore. Në bazë te të dhënave të Bazës së Hidroekonomisë së Kosovës në territorin e Kamenicës janë të rrezikuara rreth 1100 Ha tokë nga vërshimet e lumenjve. Faktorët që ndikojnë në rritjen e shkallës së rrezikshmërisë nga vërshimet janë: Çrregullimi natyror i shtratit të lumit ( marrja ilegale e inerteve); Ngushtimi i shtratit të lumit nga uzurpimet dhe ndërtimet përreth; Hedhja e mbeturinave të ngurta në shtretërit e lumenjve; Vegjetacioni jo adekuat pranë brigjeve të lumenjve etj.; Shkatërrimi i objekteve hidroteknike dhe moskujdesi i vazhdueshëm (argjinaturat) etj.; dhe Erozioni.

Nga një shkallë e lartë e rrezikshmërisë erozive janë të përfshirë 25050 ha ose 48% e sipërfaqes së komunës që i takojnë shkalles me erozion te fortë dhe shumë të fortë. Shkalla e rrezikshmërisë është në rritje si pasojë e faktorëve natyror dhe faktorit njeri. Nga shkalla më e lartë e rrezikshmërisë që e ka kategoria e erozionit shumë të fortë janë të përfshirë 11550ha tokë.




Harta 20 Erozionet

### Rrëshqitjet e dheut

Rrëshqitjet e dheut janë evidente në zonën urbane në lagjen Qamëria. Konfiguracioni i tokës në këtë pjesë të qytetit si dhe përbërja e tokës ,të reshurat e larta, janë faktorët të cilët kanë ndikuar që kjo pjesë e tokës është ngopur nga lagështia atëherë është paraqitur rrëshqitja e kësaj sipërfaqe në të kaluarën. Rrëshqitja e tokës ka prodhuar situatë emergjente ngase disa shtëpi të banuara rrezikohen nga masa e dheut i cili lehtë mundë të shihet se gradualisht ka qarje, rrëshqitje te terrenit ku ka ndikuar në strukturën e ndërtimit dhe dëmtimin e tyre.



*Pamje të dëmeve të shkaktuara nga rrëshqitjet e dheut*

Gjendja e mjedisit në komunën e Kamenicës nuk është e mirë. Degradimi mjedisor është rezultat i shumë faktorëve të cilët janë me ndikim serioz në përbërësit kryesor të mjedisit: ajri, uji dhe toka. Sa i përket ajrit, vlerësohet prezentë ndotja, sidomos ne zone urbane dhe varësisht nga sezona dhe klimës.

Komuna e Kamenicës është një ndër komunat me resurse mjaftueshme ujore në Kosovë, shkarkimi i pakontrolluar i ujërave të ndotur si dhe shkarkimet e ujërave nga kolektorët e industrive përgjatë rrjedhës së tyre janë ndër shkaktarët kryesorë të ndotjes. Ndotja ujit dhe e tokës në rastin konsiderohet të jetë më e madhe se ajo e ajrit. Toka në komunën e Kamenicës është e ndotur nga deponitë ilegale të mbeturinave urbane.

Shfrytëzimi pa kriter i tokës bujqësore, veçanërisht gjatë ndërtimit të infrastrukturës apo eksploatimit të materialeve inerte, në shumë raste toka ka pësuar degradim të pa riparueshëm. Humbja e tokës bujqësore manifestohet në forma të ndryshme.

| **Analiza SWOT: Mjedisi** | |
|---|---|
| PËRPARËSITË | MANGËSITË |
| Komunë me imazh të gjelbër<br>Zonë urbane me rrjet të mirë te transportit të pamotorrizuar | Rrjedhja e kanalizimit në ujëra të hapura<br>Mungesa e trajtimit të ujërave të zeza<br>Ndotja nga ujërat industrial në fshatin Krilevë |
| MUNDËSITË | RREZIQET |
| Bashkëpunimi me komunat fqinje në ndërtimin e fabrikës së trajtimit te ujërave të zeza<br>Projekte për ngrohje qendrore në zonën urbane<br>Projekte për shtrirjen e rrjetit të çiklizmit në mes të zonës urbane dhe fshatrave përreth | Ndryshimet klimatike – zvogëlimi i sasisë së ujërave në komunë nga thatësirat dhe reshjet e dobëta atmosferike<br>Rrezikimi i skemave të ujitjes nga urbanizimi i egër i fshatrave |

| **Analiza SWOT: Sipërfaqet me rrezikshmëri** | |
|---|---|
| PËRPARËSITË | MANGËSITË |
| Mjedis relativisht i pastër dhe bukuri natyrore | Erozion i theksuar nga prerja e pakontrolluar e pyjeve<br>Mungesa e trajtimit të ujërave të zeza<br>Mungesa e sistemeve të ndara të ujërave te atmosferik |
| MUNDËSITË | RREZIQET |

| | |
|---|---|
| Pastrimi dhe rregullimi i shtretërve të rrjedhave ujore me qëllim të zvogëlimit të rrezikuar nga vërshimet (Krivareka, Hogoshtit, Desivojcë, Karraçevë dhe Prroi i Rubocit)<br><br>Pyllëzimi i sipërfaqeve me erozion të shprehur<br><br>Ndërtimi i kaskadave, argjinaturave dhe mbjellja e fidanëve pyjore përgjatë brigjeve të lumenjve<br><br>Ndarja e sistemit të ujërave atmosferik ne fshatrat me dendësi më të madhe banimi. | Ndryshimet klimatike – zvogëlimi i sasisë së ujërave në komunë nga thatësira dhe reshjet e dobëta atmosferike<br><br>Tërmetet |

**Sipërfaqet me rrezikshmëri - sfidat**

- Zvogëlimi i ndotjes së mjedisit në veçanti i ujërave.
- Parandalimi i rreziqeve dhe menaxhimi i fatkeqësive natyrore.

**Masat e nevojshme të parandalimit dhe mbrojtjes së mjedisit – rekomandimet e VSM**

Raporti i ndikimit të Vlerësimit Strategjik në Mjedis për ajrin dhe klimën ka identifikuar efektet negative nga zhvillimi dhe rekomandon masat zbutëse si në vijim:

| Ndikimi i efekteve mjedisore | Masat zbutëse |
|---|---|
| Rritje e emetimit të gazrave serrë nga transporti i shtuar gjatë ndërtimit të: Zgjerimit dhe lidhjes me autostradë të rrugës Kamenice - Crep, Rogane - Domaroc,vazhdimi i ndërtimit të qarkores nga Qendra (Kamenica)–Qameria, ndërtimi i stacionit të autobusëve ne Kamenicë, ndërtimi i digave për akumulim (hidrosistemi Kikë & Kremenatë), ndërtimi i Impiantin Komunal dhe kolektorëve për trajtim të Ujërave të zeza në lokacion tek Dheu i Bardh, asfaltimi i rrugëve kryesore ne Malësinë e Kamenicës, ndërtimi i stadiumit të atletikës në Novosellë, ndërtimi i parqeve industrial/ bizneseve, restaurimi i objekteve të shkollave të braktisura të Malësisë dhe adaptimi për zhvillim të turizmit restaurimi i | Të përdoren masa mbrojtëse aty ku ka mundësi, të shmanget qarkullimi I mjeteve transportuese në të njejtën kohë(sidomos në kohë të pikut) të evitohet kalimi I tyre në afërsi të zonave rezidenciale apo qendrës së qytetit sipas mundësive, të maksimalizohet efiçienca e transportit. |

| | |
|---|---|
| objekteve të TK, ndërtimi i infrastrukturës sociale, teknike dhe publike në qendrat sekondare, ndërtimi i ujësjellesit në Karaqeve të epërme dhe Petroc (Petrit), ndërtimi i rrjetit të ri të kanalizimit në zonat ku ai mungo, ndërtimi i kanalit të ujitjes në Muqivërc. | |
| Rritje e emetimit të grimcave dhe pluhurit gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit të: pikave grumbulluese për NVM dhe parqeve të biznesit, ndërtimit të rrugëve dhe infrastrukturës përcjellëse për sektorin e turizmit, ndërtimit të pendës akumuluese, ndërtimit të fabrikës për trajtim të ujërave të zeza, ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve, ndërtimet në shesh dhe rrugën unazore, ndërtimi i çerdheve, ndërtimi I parkingjeve, ndërtimi I Qendrës Rinore, ndërtimi i kompleksit memorial | Të përdoren masa mbrojtëse aty ku ka mundësi, të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i parametrave të kualitetit të ajrit, të shmangen aktivitetet që gjenerojnë ndotje jashtë vlerave të lejuara, aktivitetet ekzistuese t'i përmbahen rregulloreve për kualitetin e ajrit duke përdorur masa ose teknologji për parandalim të ndotjes ose trajtim eventual të ajrit dhe gazrave që emitohen. Për secilin projekt të zhvillimit turistik dhe infrastrukturor, të bëhet VNM sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. |
| Rritje e emetimeve të gazrave dhe grimcave ndotëse në ajër si pasojë e aktiviteteve të shtuara ekonomike (turistike , bujqësore dhe biznesore). | Të përdoren masa mbrojtëse aty ku ka mundësi, të bëhet monitorimi I vazhdueshëm I parametrave të kualitetit të ajrit, të shmangen aktivitetet që gjenerojnë ndotje jashtë vlerave të lejuara, aktivitetet ekzistuese t'I përmbahen rregulloreve për kualitetin e ajrit duke përdorur masa ose teknologji për parandalim të ndotjes ose trajtim eventual të ajrit dhe gazrave që emitohen. |

Për ujin VSM ka identifikuar efektet negative nga zhvillimi dhe rekomandon masat zbutëse si në vijim:

| Ndikimi i efekteve mjedisore | Masat zbutëse |
|---|---|
| Gjenerimi i ujërave industriale me ndotës më serioz apo toksik nga proceset teknologjike, agro-bujqësia dhe sektori if ri i turizmit. | Kontrollimi i kualitetit të ujit dhe ndotësve të shkarkuar në ujë. Nëse ka materie tejet toksike, të krijohet një impiant i posaçëm për trajtimin e tyre. |
| Ndërtimi i pendave akumuluese do të shkaktojë probleme mjedisore në biodiversitet, ne kualitet të ajrit, tokës dhe ujit. Mund të paraqiten probleme gjatë fazës | Ndërtimit të pendave akumulese (hidrosistemi Kikë & Kremenatë) duhet t'I paraprijë një studim I fizibilitetit në para se të fillon hartimi I projektit. Studimi I fizibilitetit |

| | |
|---|---|
| së operimit kur ekosistemet lokale mbesin pa ujë dhe zhduken ose dëmtohen. Ndotja e ajrit, ujit dhe tokës do të jenë të dukshme gjatë fazës ndërtimore të pendës. | duhet të del me rekomandime për apo kundër këtij ndërtimi. Në qoftë se penda ndërtohet përkundrejt rekomandimeve, të sigurohet minimum biologjik i ujit për mbijetesën e ekosistemeve dhe të merren masa kontrolluese dhe trajtuese për ajrin dhe ujin gjatë fazës ndërtimore (trajtimi i ujit të ndotur, menaxhimi I mbeturinave, dhe sipas rekomandimeve të cekura sipër në këtë tabelë). Masa të tilla të merren gjatë ndërtimit të secilit element afër trupave ujore. |

Ndërsa për tokën ka identifikuar efektet negative nga zhvillimi dhe rekomandon masat zbutëse si në vijim:

| Ndikimi i efekteve mjedisore | Masat zbutëse |
|---|---|
| Humbje e resurseve potenciale si pasojë e konvertimit të sipërfaqeve natyrore në artificiale nga projektet në fushën e turizmit, pendat dhe hapësira grumbulluese për mbeturina të ngurta | Të analizohet terreni apo zona paraprakisht për të përcaktuar praninë e resurseve, të preservohen tokat e pasura me resurse dhe të promovohet rikultivimi apo rigjenerimi aty ku është e mundur. Për secilin projekt të zhvillimit turistik dhe infrastrukturor apo teknologjik, të bëhet VNM sipas kërkesave të |
| Ndotje nga lirimi i vajit apo ujit të dalur nga veprimtaritë agroindustriale- teknologjike dhe transporti motorik apo makineritë tjera. | Kontrollimi i pajisjeve dhe hapësirave ku shkarkohen materiet, të jenë hapësira të padepërtueshme, të sigurohet kualiteti I makinerive në përdorim. |
| Erozioni dhe rrëshqitja e dheut si dhe rrëshqitja pasojë e aktiviteteve ndërtimore | Pyllëzimi I zonave erozive, shndërrimi I cungishteve në pyje të larta, përforcimi i zonave që paraqesin rrezik, shmangie e ndërtimit në ato zona. |

## 1.12. Trashëgimia kulturore, arkitekturale dhe arkeologjike




Harta 21 Shpërndarja hapësinore e aseteve të trashëgimisë kulturore

Emri i qytetit Kamenica përmendet në librin e borxhlinjve të Mikel Llukarit në vitet ’30-të të shek. XV me emrin Chameniza. Pastaj, përmendet në defterin turk të Vilajetit Vëllk të vitit 1455. Gjatë luftës së dytë botërore ishte pjesë e zonës Bullgare, ndërsa në nëntor të vitit 1944, ripushtohet nga Jugosllavia komuniste. Në vitin 1959 Kamenica fiton statusin Komunë, si njësi e barabartë me komunat tjera në vend. Si e tillë, Kamenica ka asete të caktuara të trashëgimisë kulturore, arkitektural dhe arkeologjike.

Sipas ligjit Nr. 02/L-88, Trashëgimia Kulturore e përhershme dhe e përkohshme nga MKRS kategorizohet si: Trashëgimi arkitekturale (Monument/ansambli); arkeologjike (monument/ansambël dhe lokalitet arkeologjik/rezervat); trashëgimi të luajtshme; dhe trashëgimi shpirtërore. Tabela në vijim paraqet numrin e objekteve të trashëgimisë kulturore sipas kategorive, të cilat janë nën mbrojtje të MKRS-së.

| **Trashëgimia kulturore, sipas kategorive, lista e mbrojtjes MKRS 2023** | |
|---|---|
| Trashëgimia arkitekturale | 18 |
| Trashëgimia arkeologjike | 21 |
| Objektet e luajtshme | 5 |
| Gjithsej | 44 |

Sipas listës së Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme nga MKRS, viti 2023, në Kamenicë ekzistojnë gjithsej 44 asete të trashëgimisë kulturore (shih tabelën në vijim). Trashëgimia arkeologjike prinë me 21 asete, pasuar nga ajo arkitekturale me 18 sosh, dhe objekte të luajtshme 5.

### 1.12.1. Trashëgimia arkitekturale

Sipas listës së MKRS për Mbrojtje të Përkohshme, ne Kamenicë ekzistojnë 18 monumente të trashëgimisë arkitekturale. Gjendja e tyre është e përshkruar në tabelën e mëposhtme. Shenjëzimi mungon për të gjitha monumentet.

| Kategoria: Trashëgimia Arkitekturore | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **A. Nënkategoria: Monument/ansambël** | | | | | | | |
| | Emërtimi | Periudha | Lokacioni | Statusi i mbroj. në MKRS | Nr. unik në databazë | Lokacioni google maps | Gjendja fizike (jo e mirë; nën mesatare; mesatare; mbi mesatare; e mirë) |
| 1. | Shtëpia e Demush Ferizit | Shek. XIX | Zhujë | | 791 | https://goo.gl/maps/6iCPQXeh5FsqySXo6 | Jo e mirë; pjesërisht e rrënuar |
| 2. | Xhamia në Zhujë | 1816 | Zhujë | | 2692 | https://goo.gl/maps/7QYK8DRD9qjDiuo47 | Mesatare |
| 3. | Shtëpia Banimi në Leshtarë (Jusuf Ademi) | Shek. XIX | Kamenicë | | 800 | https://goo.gl/maps/ZB4dEuU6mP2smkta9 | Jo e mirë |
| 4. | Mulliri i Jashar Hysës | 1839 - 1850 | Leshtarë | | 4252 | https://goo.gl/maps/xpZBXP7Asnk7ffeX9 | Jo e mirë; pjesërisht i rrënuar |
| 5. | Shtëpia e Rahim Sadikut (Shtëpia ku u strehua Mulla Idrizi) | Shek. XIX | Gjyrishec | | 812 | https://goo.gl/maps/g2ëYgm963kaRJLz46 | Jo e mirë; plotësisht e rrënuar |
| 6. | Shtëpia e Abdyl Cakollit | Shek. XIX | Krilevë | | 828 | https://goo.gl/maps/BqQjLBDm1MQ1AXË97 | E mirë; restauruar |
| 7. | Xhamia në Krilevë | 1846 | Krilevë | | 311 | https://goo.gl/maps/riqoT3CGn5g8Krz2A | Mesatare |
| 8. | Teqja e Sheh Zenel Abedinit | Shek. XVIII | Toponicë | | 2690 | https://goo.gl/maps/9J1jMhgqZ4jeK6Ë8A | E mirë; Intervenim emergjent, Adaptim/2012 |
| 9. | Shtëpia muze e Kadri Zekës | Shek. XIX | Poliçkë | | 841 | https://goo.gl/maps/n3zveiVB3CTECS4a9 | E mirë; e rindërtuar |
| 10. | Shtëpia e Hamdi Arif Rashitit | Shek. XX | Velegllavë | | 849 | https://goo.gl/maps/FEDRVBsËZc7euesr7 | Jo e mirë; pjesërisht e rrënuar |
| 11. | Mulli binjak në Hogosht | Shek. XX | Hogosht | | 839 | https://goo.gl/maps/oZ4htnX9A3qN6NËJ8 | E mirë; restaurim në vitin 2018 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 12. | Pendat në Hogosht | 1950 | Hogosht | | 90 | https://goo.gl/maps/u6zpZbLQx55XËm3dA | Mesatare |
| 13. | Xhamia në Busavatë | 1938 | Busavatë | | 294 | https://goo.gl/maps/4HJXyFvf8ËPb99x37 | Mbi mesatare |
| 14. | Xhamia në Kranidell | 1928 | Kranidell | | 269 | https://goo.gl/maps/eDqJjrMsz9i27ëFMA | Mesatare |
| 15. | Xhamia në Meshinë | 1886 | Meshinë | | 245 | https://goo.gl/maps/gRmaDmRëdTJBepmF6 | Nën mesatare |
| 16. | Xhamia në Vryqec | 1826 | Vryqec | | 246 | https://goo.gl/maps/J2xARXSbHcS9SfGA8 | Mesatare; Intervenim emergjent, Adaptim/2012 |
| 17. | Xhamia në Tygjec | 1890 | Tygjec | | 270 | https://goo.gl/maps/2RsH6fËEcXNk3g3H7 | Mbi mesatare |
| 18. | Shtëpia e Rexhep Berishës | | Svircë | | 4253 | https://goo.gl/maps/pLzemN9hGJHxtBKM6 | E mirë; e rindërtuar |

#### 1.12.2. Trashëgimia arkeologjike

Sipas listës për Mbrojtje të Përkohshme të MKRS, në Kamenicë ekzistojnë 4 monumente dhe 17 lokalitet arkeologjike.

| **Kategoria: Trashegimia arkeologjike** | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **A. Nënkategoria: Monument/ansambel** | | | | | | |
| | **Emërtimi** | **Periudha** | **Lokacioni** | **Statusi i mbroj. në MKRS** | **Nr unik në databazë** | **Lokacioni** | **Gjendja** |
| 1. | Kisha e Dëftimit të Shën Mërisë | Mesjetë | Vaganesh | - | 854 | https://goo.gl/maps/udaN1eCXMrGrHfEC8 | E mirë |
| 2. | Manastiri ‘Qeli’ (Burg) | Mesjetë | Hajnoc | | 856 | https://goo.gl/maps/p37hmbfËEN16LT6KA | E mirë |
| 3. | Manastiri i Moçarit | Mesjetë | Moçarë | | 780 | https://goo.gl/maps/43tZcvgMRhës8tCK6 | Pjesërisht e rrënuar |
| 4. | Kisha e Shën Gjonit | Mesjetë | Berivojcë | | 895 | https://goo.gl/maps/CzMdH5ëXLogttx4f6 | E mirë |
| | **B. Nënkategoria: Lokalitet arkeologjik/rezervat** | | | | | | |
| 1. | Kalaja e Kamenicës (Dardanë) | Parahistori, Antikitet i Vonë | | | 1198 | https://goo.gl/maps/YeB8HEdVorGf1nZLA | Mesatare; Muri i parë dhe i tretë rrethues të restauruar |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2. | Gërmadhat e varrit te antikës së vonë ne Hogosht | Antikitet i Vonë | Hogosht | | 3030 | | |
| 3. | Lokaliteti arkeologjik 'Ordine' | Romake | Karaçevë e Epërme | | 2887 | | |
| 4. | Themelet e kishës në Karaçevë të Epërme Antikiteti i Vonë | Mesjetë | Karaçevë e Epërme | | 3709 | | |
| 5. | Lokaliteti arkeologjik-Bregu i Gjytetit-Gjyrishec | Antikë | Gjyrishec | | 3623 | | |
| 6. | Kalaja e antikitetit të vonë në Topanicë | Antikitet i Vonë | Topanicë | | 1197 | | |
| 7. | Kalaja e antikitetit të vonë në Kranidell | Antikitet i Vonë | Kranidell | | 1199 | | |
| 8. | Kodërvarret Ilire në Zajqec | Parahistori | Zajqec | | 3731 | | |
| 9. | Vendbanimi Kërshi I Madh / Livadhet | Antikë e vonë | Busavatë-Rubovcë | | 4493 | | |
| 10. | Kulina-Kalaja e Strezocit | Antikë e vonë | Hajnoc | | 4494 | | |
| 11. | Lokaliteti Bara e Bixhës Romake | Antikitet i vonë | Hogosht | | 4495 | | |
| 12. | Gërmadhat e Kishës | Mesjetë | Lisockë | | 4496 | | |
| 13. | Vendbanimi Katune | Antikë e vonë-Mesjetë | Karaçevë e Ulët | | 4497 | | |
| 14. | Vendbanimi Brege | Romake | Koretin | | 4498 | | |
| 15. | Arat e Kooperativës | Neolit | Strezoc | | 4499 | | |
| 16. | Vendbanimi Suishtë | Neolit | Topanicë | | 4500 | | |
| 17. | Gërmadhat e Kishës së vjetër | Mesjetë | Reqicë | | 3482 | | |
| 18. | Vendbanimi shume-shtresor i Topanicës | -- | -- | -- | -- | -- | -- |

| **Kategoria: Objektet e luajtshme** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Emërtimi** | **Periudha** | **Lokacioni** | **Statusi i mbroj. në MKRS** | **Nr. unik në databazë** |
| 1. | Stelë | Shek. IV p.Kr. | Gjetje rasti (MK) | | |
| 2. | Dorezë kocke | Antikitet i Vonë, shek. IV-VI | Ka-12 B-1-06, nr. inv.20 (IAK) Kalaja | | |
| 3. | Thikë hekuri | Antikitet i Vonë, shek. IV-VI | Gjetje rasti (IAK) | | |
| 4. | Vegël mjekësore | Antikitet i Vonë, shek. IV-VI | Ka. 12. B-1-6 (IAK) Kalaja | | |
| 5. | Tavani i shtëpisë së Ilmi Murselit | Shek. XX | | | 4441 |

### 1.12.3. Trashëgimia shpirtërore

Trashëgimia shpirtërore përfshin format e shprehjes kulturore të traditave ose të zakoneve popullore, të gjuhës, festave, riteve, valles, muzikës, këngës dhe shprehjes artistike.

## 1.13. Trashëgimia natyrore – monumentet natyrore

Bazuar në të gjitha informatat të cilat janë marrë nga kjo fushë me theks të veçantë nga Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës, dhe duke analizuar gjendjes ekzistuese parashikohet që zonat me vlera të veçanta natyrore (Planica, Kika, Velegllava, Tugjeci) të shpallën të mbrojtura, të ruhen, mbrohen dhe konservohen dhe zhvillohen më tutje. Parashikohet që trungjet e vjetra dhe monumente gjeomorfologjike të shpallën të mbrojtura, të ruhen sensibilizohen, mbrohen dhe konservohen.

Komuna e Kamenicës është mjaft e pasur edhe me peizazhe. Për ta mbrojtur, intervenimet e njeriut në pikat skenike – pika atraktive duhet të minimizohen, sidomos në zonat e dedikuara për zhvillimin e turizmit.

- Kika parashikohet që të zhvillohet dhe fuqizohet me elemente të pushimoreve dhe staza për skijim dimëror dhe veror dhe për shëtitje si dhe qendrën mjekësore për rehabilitim.
- Pllanica parashikohet që të zhvillohet dhe fuqizohet me elemente të pushimoreve dhe staza për shëtitje.
- Tugjeci parashikohet që të zhvillohet dhe fuqizohet me elemente të pushimoreve dhe staza për skijim dimëror dhe veror dhe për shëtitje si dhe qendrën mjekësore për rehabilitim.
- Lumi i Desivojcës, Hogoshtit, Kremenatës edhe në këto zona janë planifikuar rrethim i zonës dhe është planifikuar që të mos ketë ndërtime të tjera.
- Peizazhet bujqësore parashikohet që këto zona të mbrohen dhe zhvillohen me rrugë që i shërbejnë, po ashtu janë paraparë shtigje për ecje, llojllojshmëria e produkteve bujqësore është një parakusht i rëndësishëm për mirëmbajtjen e strukturave të vogla të këtyre peizazhit.
- Livadhet dhe kullosat është paraparë që të mbjelljen e llojeve të shumta të bimëve barishtore.
- Vargmalet është paraparë që të mbrohen nga prerja e pakontrolluar e pyjeve dhe zjarret duke penguar erozionin i cili është fenomen i cili paraqitet në zonat e zhveshura.
- Në fshatin Kopernicë është një aset i paraparë për propozim për mbrojtje nga ana e Komunës, i quajtur "Vaskat e Blinit". Është një lokacion me disa shkëmbinjtë në shtrat të lumit, të cilët erozioni i ka gërryer dhe kanë marrë formën e vaskave natyrale.

| Trashëgimia Natyrore | Numri i aseteve | Sipërfaqja (ha) |
|---|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| Monument i natyrës | 3 | 1.48 |
| Pejzash i mbrojtur | 1 | 0.30 |
| **Gjithsej** | **4** | **1.78** |

| Vendbanimet, Monumentet e natyrës | I mbrojtur | Sipërfaqja (ha) |
|---|---|---|
| Guri vjetër, Busovat | x | 1.00 |
| Lisi i vetëm, Gjyrishec | x | 0.10 |
| Pusi i Rimit, Hogosht | x | 0.38 |
| | **Gjithsej** | **1.48** |

| Vendbanimet, Pejzash i mbrojtur | I mbrojtur | Sipërfaqja (ha) |
|---|---|---|
| Ujëvara Qurrel ne Hogosht | x | 0.30 |

| Vendbanimet, Pejzash i propozuar për mbrojtje | I mbrojtur | Sipërfaqja (ha) |
|---|---|---|
| Vaskat e Blinit në Kopernicë | | 0.250 |

#### 1.13.1. Biodiversiteti

Ekziston një florë dhe faunë shumë e begatë, si p.sh. ajo karakterizohet me nr. të madh të bimëve si të atyre të larta drunore gjetherënëse si: ahu, bungu, qarri, blini, akacia, shkoza, frashër etj. Po ashtu po thuaj se të gjitha pemët frutore të grupit farorë, grupit bërthamor, arrorë si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra, mjedra etj. Gjithashtu është mjaft e pasur me bimë barishtore të lloj-llojshme, të gjitha llojet e drithërave ( gruri, tërshëra, elbi, misri etj.); Nga shtazët e egra takojmë: derri, dhelpra, ujku, lepuri etj. Prej shpezëve të egra: pula e egër, fëllënza, skifteri, huti etj. Sa i përket faunës së ujit, lumenjtë janë të pasur me peshq si që janë trofta, ngjala etj. Po ashtu ka edhe zvarranik si gjarpërinj, bolla etj. Bimë foragjere (jonxha, tërfili i kuq, telishi etj.). Sa i përket faunës, po ashtu është e pasur si me kafshë të egra si dhe kafshë të tjera, çka është një potencial i mirë për gjueti.

### 1.14. Ndikimi hapësinor dhe mundësitë e zhvillimit nga asetet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore

Rëndësia e vlerave të mbrojtura të natyrës dhe të trashëgimisë kulturore ndikon pozitivisht në zhvillimin lokal, dhe si të tilla duhet të prezervohen. Asetet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e turizmit dhe veprimtarive ekonomike të ndërlidhura me të, duke kontribuar në krijimin e vendeve të punës dhe të hyrave për popullsinë lokale. Gërshetimi i aseteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore është njëra ndër karakteristikat më të rëndësishme të komunës së Kamenicë, dhe roli I tyre në zhvillimin ekonomik dhe social të komunës është i pamohueshëm.

Për të promovuar zhvillimin ekonomik lokal përmes trashëgimisë kulturore dhe natyrore, masat si në vijim duhet të ndermirën:

- Mbrojtja e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore përmes procesit të planifikimit hapësinor – zbatimi i rekomandimeve nga planet hapësinore
- Regjenerimi urban të hapësirave përreth ndërtesave të trashëgimisë kulturore dhe revitalizimi i ndërtesave duke promovouar mbrojtjen dhe zhvillimin e këtyre hapësirave
- Krijimi i hapësirave të mirëfillta publike
- Identifikimi i përgjithshëm i aseteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe prioritizimi i masave për veprim
- Promovimi i trashëgimisë shpirtërore
- Edukim i të rinjve rreth rëndësisë së trashëgimisë kulturore dhe natyrore
- Ngritja e vetëdijes në fushën e trashëgimisë kulturore dhe natyrore
- Ngritja e vetëdijes së pronarëve të ndërtesave të trashëgimisë kulturore dhe përfitimet e mundshme ekonomike nga mbrojtja e tyre

### 1.15. Vlerësimi i gjendjes

Komuna e Kamenicës ka trashëgimi të pasur kulturore dhe natyrore. Sipas listës së MKRS, ne Kamenicë ekzistojnë 18 objekte të trashëgimisë arkitekturor-monument/ansambël; 4 nga trashëgimia arkeologjike – monument/ansambël; 17 lokalitete arkeologjike/rezervat; dhe 5 objekte të luajtshme. Në përgjithësi gjendja fizike e objekteve ndryshon nga gjendja jo e mirë deri në mesatare. Trashëgimia natyrore është një tjetër aset i komunës, duke përfshi 4 asete me sipërfaqe prej 1.78 ha. Të gjitha asetet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore vuajnë nga zhvillimet e pakontrolluara. Kushtet për zonën mbrojtëse të aseteve të trashëgimisë kulturore, do të definohen gjatë hartimit të HZK-së bazuar në **Ligjin Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore.**

| **Analiza SWOT - Trashëgimia kulturore, natyrore** | |
|---|---|
| Përparësitë | Dobësitë |
| Numër i madh i objekteve kulturore;<br>Llojllojshmëria e objekteve të trashëgimisë kulturore;<br>Monumentet e mbrojtura te natyrës; | Gjendja jo e mirë e objekteve;<br>Mungesa e investimeve ne objektet e trashëgimisë kulturore;<br>Mungesa e definimit te zonës se mbrojtur;<br>Mos hulumtimi i mëtutjeshëm i zonave arkeologjike;<br>Mungesa e kontrollit të zhvillimit përreth objekteve të trashëgimisë kulturore;<br>Mungesa e ruajtjes se trashëgimisë se luajtshme; |
| Mundësitë | Rreziqet |
| Shfrytëzimi i objekteve te trashëgimisë kulturore për zhvillim te turizmit dhe | Zhdukja e trashëgimisë;<br>Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë |

| | |
|---|---|
| ngjarje kulturore;<br>Shfrytëzimi i bimëve mjekuese, bimëve te imta malore; | tjera: Vërshimet; Kanalet e hapura ne qytet; Erozioni; Djegia e pyjeve;<br>Mos harmonizimi i ligjit te trashëgimisë me ligjin e ndërtimit; |

**Sfidat:**

- Mbrojtja dhe shfrytëzimi i adaptueshëm për asetet e TK në funksion të zhvillimit ekonomik;
- Menaxhimi i zhvillimeve brenda perimetrit të zonës mbrojtëse të monumenteve TK;

**Nevojat për të ardhmen:**

Trashëgimia kulturore

- Hartimi i planeve të konservimit dhe menaxhimit;
- Përcaktimi i kufirit dhe perimetrit tek lokalitetet arkeologjike dhe vazhdimi i hulumtimeve;
- Vetëdijesimi i qytetarëve;

Trashëgimia natyrore

- Hartimi i politikave në nivel lokal për mbrojtjen e TN;
- Krijimi i bazës së të dhënave për menaxhim më të lehtë të TN (florës, faunës, etj.);

## 1.16. Vendbanimet

### 1.16.1. Vendbanimet sipas karakterit

Komuna e Kamenicës përbëhet nga 58 vendbanime në total, përfshi Kamenicën si qendër administrative dhe 57 vendbanime tjera me karakter rural. Qyteti i Kamenicës ka sipërfaqe prej 7km² me një dendësi të banimit prej 1,045 banorë/km.

Vendbanimet për nga karakteri mund te klasifikohen në vendbanime kompakte, të shpërndara dhe të shtrirë.

**Vendbanimet kompakte:** Këto vendbanime karakterizohet me zhvillim kompakt përgjatë territorit të tyre, dhe lokalizohen në zonat e ulëta fushore.. Vendbanime të këtij tipi janë: Kamenica, Berivojcë, Hodonoc, Koretin, Kopërnicë, Muçivercë, Petroc, Rogaqicë, Ruboc, Shipashnica e epërme, Shipashnica e poshtme, Topanica, Dajkoci, Kolloleqë, Vriqec. Te këto vendbanime kohët e fundit vërehet një formë e re e ndërtimit, sidomos përgjatë rrugëve të asfaltuar të fshatit me karakter rendor të objekteve.

**Vendbanimet e shpërndara:** Vendbanimet e tipit të shpërndarë janë të pranishëm kryesisht në viset kodrinore-malore. Karakteristikë themelore e këtyre vendbanimeve është ndarja e tyre në lagje të banimit në tërë territorin e fshatit me dendësi relativisht të ulët. Vendbanime të këtij tipi janë: Rahovica, Leshtari, Busavata, Tërstena, Desivojca, Dazhnica, Feriqevë, Velegllava e epërme dhe e poshtme, Sedlari, Poliçka, Lajqiqi, Lisocka, Gmica, Tuxheci, Svirca, Kremenat I dhe II, Meshina, Moqar, Novosellë, Grizima,

Graxheniki, Gogolloci, Gjyrishec Bratilloci, Shahiqi, Bllata, Kostadinca, Kranidell, Maroca, Qarakoc, Vaganesh, Zajqecë , Zhujë.

Disa prej vendbanimeve karakterizohen me numër shumë të ulët të banorëve, pothuajse të depopulluar, si: Kremenata I, Velegllava, Gragjenik, Gogolloci, Sedllar, Bratilloc, Kremenata, Shahiqi, Bllata, Rahovica, Zhuja, Zajqeci, Kostadinca, Firiqeja, Maroca, Velegllava, Dazhnica, Gmica, dhe Huboc.

**Vendbanimet e shtrira:** Vendbanimet e këtij tipi në formë të zgjatur i takojnë tipit të dendur dhe pak të dendur që shtrihen kryesisht përgjatë luginave dhe rrugëve lokale në zonat e ulëta, si: Busavata, Hajnoc, Hogosht, Huboc, Karaqeva e poshtme, Karaqeva e epërme, Krilevë, Novosell, Poliqkë, Qarakoc, Stralic, Strezoc.

Këto vendbanime karakterizohen me parcela më të vogla ndërtimore (oborret), ndërsa anën e tyre të ngushtë, në të shumtën e rasteve, e kanë të orientuar duke ndërtuar objektet buzë rrugës. Karakteristikë e këtyre vendbanimeve është se kanë tendenca të zgjerimit dhe bashkëngjitjes duke krijuar kështu korridore ndërtimore përgjatë rrugës. Një proces i tillë ka marrë hov sidomos kohëve të fundit, përkundër faktit se një trend i tillë në aspektin urbanistik dhe hapësinor është i pavolitshëm, ngase ato i përcjellin një mori problemesh e konfliktesh si dhe paraqesin pengesë në zhvillimin normal të komunikacionit.




Harta 22 Vendbanimet

### 1.16.2. Vendbanimet sipas funksionit

Në grupin e vendbanimeve rurale primare të komunës hyjnë ato vendbanime në cilat zhvillohen ato funksione të cilat shërbejnë për përmbushjen e nevojave të përditshme të popullsisë së atij vendbanimi. Këto vendbanime paraqesin tërësinë e objekteve banuese dhe ekonomike të prodhuesve bujqësorë. Shumica e këtyre vendbanimeve janë të vendosura në viset kodrinore-malore, të cilat janë fshatra tipike bujqësore. Pjesa më e madhe e vendbanimeve bëjnë pjesë në këtë grup, përveç Kamenicës, Hogoshtit dhe Mucivercit. Këto vendbanime bëjnë pjesë në grupin e vendbanimeve me qendër rurale. Në këto vendbanime janë zhvilluar funksionet shoqërore, si bashkësitë lokale dhe zyra e vendit, shkolla fillore, ambulanca, shitoret me shumicë e pakicë për furnizimin e popullsisë, ndonjë veprimtari zejtare, etj.

### 1.16.3. Vendbanimet sipas madhësisë (numrit të banorëve)

Kamenica klasifikohet si vendbanim shumë i vogël urban me 7,331[7] banorë, ndërsa të gjitha vendbanimet tjera klasifikohen si rurale. Nga totali i vendbanimeve, 59% e tyre klasifikohen si vendbanime shumë të vogla rurale me më pak se 200 banorë, 15.5% si vendbanime të mesme të mëdha rurale, 14% si vendbanime të vogla rurale dhe të tjerat si vendbanime të mesme dhe të mëdha rurale.

| Klasifikimi i vendbanimeve sipas normave | Përshkrimi | Vendbanimet | % në raport me vendbanimet në tërësi |
|---|---|---|---|
| 5.000-10.000 banorë | Vendbanim shumë i vogël urban | Kamenicë | 1.5% |
| 2.500 - 5.000 banorë | Vendbanim rural i madh | Koretin, dhe Rogaçice (2 vendbanime) | 3% |
| 1.000-2.500 banorë | Vendbanim i mesëm i madh rural | Berivojcë, Hodonoc, Hogosht, Karaqeve e Eperme, Kopernicë, Muçiverc, Petroc, Shipashnice e Eperme, dhe Topanicë (9 vendbanime) | 15.5% |
| 500-1.000 banorë | Vendbanim i mesëm i vogël rural | Busavatë, Karaqeve e Poshtme, Krileve, dhe Shipashnice e Poshtme (4 vendbanime) | 7% |
| 200-500 banorë | Vendbanim i vogël rural | Dajkoc, Grizime, Hajnoc, Leshtar, Novosell, Poliçkë, Rubovc, dhe Strezoc (8 vendbanime) | 14% |
| <200 banore | Vendbanim shumë i vogël rural (34 vendbanime) | Bosce; Bratilloc, Dazhnice, Desivojce, Feriqeve, Gmice, Gogolloc, Graxhenik, Gjyrishec, Kolloleq, Kostadince, Kranidell, Kremenata I, Kremeata II, Lajcic, Lisocke, Maroce, Meshine, Moqar, Qarakoc, Rahovicë, Sedllar, Strelic, Svircë, Shahiq, Terstenë, Tugjec, Vaganesh, Velegllave e Eperme, Velegllave e Poshtme, Vriqec, Zajçec, dhe Zhuje | 59% |

[7] Numri i banorëve është marrë nga regjistrimi i ASK 2011 meqenëse nuk ka të dhëna të përditësuara për numër të banorëve për vendbanim në komunë.

| Emri i vendbanimit | Sipërfaqja e zhvilluar/ndërtuar brenda kufirit ndërtimor (ha) | Sipërfaqja e lirë për shfrytëzim për banim të përhershëm (ha) | Sipërfaqja e kufirit ndërtimor sipas PZHK (ha) | Regjistrimi i vitit 2011 (ASK) | Regjistrimi i vitit 2011, ekonomive familjare (ASK) | Vlerësimi i popullsisë 2019 (ASK) | Vlerësimi i ekonomive familjare 2019 (ASK) | Parashikimi rritjes së popullsisë 2021 (sipas trendit të rritjes 0.93%) | Parashikimi rritjes së ekonomive familjare 2021 (sipas trendit të rritjes 0.93%) | Parashikimi i rritjes së popullsisë 2021 - 2031 (sipas trendit të rritjes 0.93%) - TOTALI | Parashikimi i rritjes së ekonomive familjare 2021 - 2031 (sipas trendit të rritjes 0.93%) - TOTALI | Parashikimi i rritjes së popullsisë 2021 - 2031 (sipas trendit të rritjes 0.93%) - rritja neto | Parashikimi i rritjes së ekonomive familjare 2021 - 2031 (sipas trendit të rritjes 0.93%) - rritja neto | Sipërfaqja e nevojshme për të akomoduar kërkesën për banim të përhershëm 2021 – 2031 sipas rritjes së numrit të popullsisë - ha | 30% kërkesa për njësi te reja te banimit nga migrimi I brendshëm dhe diaspora - ha |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Berivojcë | 57 | 60.5 | 117.5 | 1553 | 300 | 1570 | 314 | 1600 | 320 | 1749 | 350 | 150 | 30 | 1.8 | 0.539 |
| Bllatë | 1.4 | 4.2 | 5.6 | 35 | 6 | 35 | 7 | 36 | 7 | 39 | 8 | 3 | 1 | 0.0 | 0.012 |
| Boscë | 10.5 | 1.9 | 12.4 | 86 | 29 | 87 | 17 | 89 | 18 | 97 | 19 | 8 | 2 | 0.1 | 0.030 |
| Bratilloc | 0.6 | 1.1 | 1.7 | 29 | 4 | 29 | 6 | 30 | 6 | 33 | 7 | 3 | 1 | 0.0 | 0.010 |
| Busovatë | 21.4 | 15 | 36.4 | 804 | 120 | 813 | 163 | 828 | 166 | 906 | 181 | 78 | 16 | 0.9 | 0.279 |
| Dajkoc | 11.2 | 6.9 | 18.1 | 378 | 70 | 382 | 76 | 389 | 78 | 426 | 85 | 36 | 7 | 0.4 | 0.131 |
| Dazhnicë | 1.3 | 1 | 2.3 | 80 | 13 | 81 | 16 | 82 | 16 | 90 | 18 | 8 | 2 | 0.1 | 0.028 |
| Desivojcë | 3.9 | 5.1 | 9 | 177 | 32 | 179 | 36 | 182 | 36 | 199 | 40 | 17 | 3 | 0.2 | 0.061 |
| Feriqevë | 1.2 | 1.2 | 2.4 | 61 | 11 | 62 | 12 | 63 | 13 | 69 | 14 | 6 | 1 | 0.1 | 0.021 |
| Gmicë | 1.3 | 1.6 | 2.9 | 85 | 16 | 86 | 17 | 88 | 18 | 96 | 19 | 8 | 2 | 0.1 | 0.029 |
| Gogolloc | 2.1 | 1.4 | 3.5 | 10 | 4 | 10 | 2 | 10 | 2 | 11 | 2 | 1 | 0 | 0.0 | 0.003 |
| Gragjenik | 2.3 | 0.7 | 3 | 2 | 1 | 2 | 0 | 2 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0.0 | 0.001 |
| Grizimë | 20 | 84 | 104 | 461 | 85 | 466 | 93 | 475 | 95 | 519 | 104 | 44 | 9 | 0.5 | 0.160 |
| Gjyrishec | 1.5 | 0.8 | 2.3 | 58 | 8 | 59 | 12 | 60 | 12 | 65 | 13 | 6 | 1 | 0.1 | 0.020 |
| Hajnoc | 14.2 | 6.5 | 20.7 | 460 | 98 | 465 | 93 | 474 | 95 | 518 | 104 | 44 | 9 | 0.5 | 0.160 |
| Karaçevë e Epërme | 41 | 17.6 | 58.6 | 1413 | 235 | 1429 | 286 | 1455 | 291 | 1592 | 318 | 136 | 27 | 1.6 | 0.490 |
| Karaçevë e Poshtme | 23.2 | 19.7 | 42.9 | 940 | 160 | 950 | 190 | 968 | 194 | 1059 | 212 | 91 | 18 | 1.1 | 0.326 |
| Kolloleq | 12.5 | 5.3 | 17.8 | 181 | 62 | 183 | 37 | 186 | 37 | 204 | 41 | 17 | 3 | 0.2 | 0.063 |
| Kopernicë | 32.7 | 21.2 | 53.9 | 1183 | 200 | 1196 | 239 | 1219 | 244 | 1333 | 267 | 114 | 23 | 1.4 | 0.411 |
| Kostadincë | 3.5 | 3 | 6.5 | 48 | 13 | 49 | 10 | 49 | 10 | 54 | 11 | 5 | 1 | 0.1 | 0.017 |
| Kranidell | 2.9 | 2.1 | 5 | 131 | 24 | 132 | 26 | 135 | 27 | 148 | 30 | 13 | 3 | 0.2 | 0.045 |
| Kremenatë I | 0.8 | 1.4 | 2.2 | 7 | 1 | 7 | 1 | 7 | 1 | 8 | 2 | 1 | 0 | 0.0 | 0.002 |
| Kremenatë II | 0.4 | 0.8 | 1.2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.0 | 0.000 |
| Krilevë | 16.8 | 15 | 31.8 | 586 | 96 | 593 | 119 | 604 | 121 | 660 | 132 | 56 | 11 | 0.7 | 0.203 |
| Lajçiqi | 1.8 | 3.1 | 4.9 | 160 | 27 | 162 | 32 | 165 | 33 | 180 | 36 | 15 | 3 | 0.2 | 0.056 |
| Leshtar | 14.3 | 23.2 | 37.5 | 446 | 85 | 451 | 90 | 459 | 92 | 502 | 100 | 43 | 9 | 0.5 | 0.155 |
| Lisockë | 2.9 | 3.7 | 6.6 | 98 | 18 | 99 | 20 | 101 | 20 | 110 | 22 | 9 | 2 | 0.1 | 0.034 |
| Marocë | 1.2 | 3.6 | 4.8 | 64 | 9 | 65 | 13 | 66 | 13 | 72 | 14 | 6 | 1 | 0.1 | 0.022 |
| Meshinë | 3.8 | 2.4 | 6.2 | 25 | 10 | 25 | 5 | 26 | 5 | 28 | 6 | 2 | 0 | 0.0 | 0.009 |
| Moçar | 8.3 | 6.9 | 15.2 | 113 | 31 | 114 | 23 | 116 | 23 | 127 | 25 | 11 | 2 | 0.1 | 0.039 |
| Novosellë | 8.2 | 4.5 | 12.7 | 311 | 57 | 314 | 63 | 320 | 64 | 350 | 70 | 30 | 6 | 0.4 | 0.108 |
| Petroc | 19.7 | 6 | 25.7 | 1257 | 200 | 1271 | 254 | 1295 | 259 | 1416 | 283 | 121 | 24 | 1.5 | 0.436 |

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Poliçkë | 6.7 | 3.3 | 10 | 217 | 39 | 219 | 44 | 224 | 45 | 244 | 49 | 21 | 4 | 0.3 | 0.075 |
| Qarrakoc | 4.3 | 5.4 | 9.7 | 60 | 9 | 61 | 12 | 62 | 12 | 68 | 14 | 6 | 1 | 0.1 | 0.021 |
| Rahovicë | 0.83 | 1.6 | 2.43 | 42 | 6 | 42 | 8 | 43 | 9 | 47 | 9 | 4 | 1 | 0.0 | 0.015 |
| Ruboc | 10 | 22.7 | 32.7 | 386 | 68 | 390 | 78 | 398 | 80 | 435 | 87 | 37 | 7 | 0.4 | 0.134 |
| Sedllar | 0.3 | 0.4 | 0.7 | 22 | 4 | 22 | 4 | 23 | 5 | 25 | 5 | 2 | 0 | 0.0 | 0.008 |
| Strelicë | 6.1 | 7.2 | 13.3 | 47 | 9 | 48 | 10 | 48 | 10 | 53 | 11 | 5 | 1 | 0.1 | 0.016 |
| Svircë | 1.6 | 0.3 | 1.9 | 59 | 12 | 60 | 12 | 61 | 12 | 66 | 13 | 6 | 1 | 0.1 | 0.020 |
| Shahiq | 0.7 | 1.6 | 2.3 | 34 | 6 | 34 | 7 | 35 | 7 | 38 | 8 | 3 | 1 | 0.0 | 0.012 |
| Shipashnicë e Epërme | 30.7 | 6.3 | 37 | 1261 | 242 | 1275 | 255 | 1299 | 260 | 1420 | 284 | 122 | 24 | 1.5 | 0.438 |
| Shipashnicë e Poshtme | 16.3 | 16.3 | 32.6 | 753 | 130 | 761 | 152 | 776 | 155 | 848 | 170 | 73 | 15 | 0.9 | 0.261 |
| Tërstenë | 3 | 4.9 | 7.9 | 100 | 16 | 101 | 20 | 103 | 21 | 113 | 23 | 10 | 2 | 0.1 | 0.035 |
| Topanicë | 46.7 | 20 | 66.7 | 2061 | 340 | 2084 | 417 | 2123 | 425 | 2322 | 464 | 199 | 40 | 2.4 | 0.715 |
| Tugjec | 3.1 | 2.6 | 5.7 | 130 | 21 | 131 | 26 | 134 | 27 | 146 | 29 | 13 | 3 | 0.2 | 0.045 |
| Vaganesh | 2.4 | 1.4 | 3.8 | 10 | 4 | 10 | 2 | 10 | 2 | 11 | 2 | 1 | 0 | 0.0 | 0.003 |
| Velegllavë e Epërme | 1.9 | 1.9 | 3.8 | 73 | 15 | 74 | 15 | 75 | 15 | 82 | 16 | 7 | 1 | 0.1 | 0.025 |
| Velegllavë e Poshtme | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.0 | 0.000 |
| Vriqec | 1.6 | 1.8 | 3.4 | 78 | 12 | 79 | 16 | 80 | 16 | 88 | 18 | 8 | 2 | 0.1 | 0.027 |
| Zajçec | 0.9 | 0.5 | 1.4 | 46 | 10 | 47 | 9 | 47 | 9 | 52 | 10 | 4 | 1 | 0.1 | 0.016 |
| Zhujë | 0.4 | 0.7 | 1.1 | 42 | 7 | 42 | 8 | 43 | 9 | 47 | 9 | 4 | 1 | 0.0 | 0.015 |
| Hodonoc | 59.3 | 60.2 | 119.5 | 2446 | 385 | 2473 | 495 | 2520 | 504 | 2755 | 551 | 236 | 47 | 2.4 | 0.707 |
| Hogosht | 43.9 | 38.8 | 82.7 | 1705 | 298 | 1724 | 345 | 1756 | 351 | 1921 | 384 | 164 | 33 | 1.6 | 0.493 |
| Koretin | 88.7 | 50.1 | 138.8 | 3476 | 597 | 3515 | 703 | 3581 | 716 | 3916 | 783 | 335 | 67 | 3.4 | 1.005 |
| Muçivërc | 38.8 | 31.1 | 69.9 | 1520 | 248 | 1537 | 307 | 1566 | 313 | 1712 | 342 | 147 | 29 | 1.5 | 0.440 |
| Rogaçicë | 62.7 | 58.5 | 121.2 | 2668 | 464 | 2698 | 540 | 2748 | 550 | 3005 | 601 | 257 | 51 | 2.6 | 0.772 |
| Strezoc | 6.2 | 5.8 | 12 | 276 | 52 | 279 | 56 | 284 | 57 | 311 | 62 | 27 | 5 | 0.3 | 0.080 |
| Kamenice | 147.4 | 190.3 | 337.7 | 7331 | 1400 | 7413 | 1483 | 7551 | 1510 | 8258 | 1623 | 707 | 113 | 3.7 | 1.110 |
| **Gjithsej** | **928.4** | **865.1** | **1793.5** | **36’085** | **6’419** | **36’487** | **7’298** | **37’170** | **7’434** | **40’648** | **8’101** | **3478.3** | **667.3** | **34.6** | **10.4** |

### 1.16.4. Vendbanimet sipas lartësisë mbidetare

Një pjesë e madhe e vendbanimeve në Kamenicë janë zhvilluar bazuar në karakteristikat gjeomorfologjike të terrenit. Bazuar në këtë karakteristikë, një pjesë e madhe e vendbanimeve janë zhvilluar në lartësi të mëdha mbi-detare Një pjesë e madhe e tyre shtrihen në zonën kodrinore – malore, ndërsa një pjesë me e vogël në zona kryesisht te rrafshëta. Zona kodrinore-malore zë pozitën verilindore dhe veriperëndimore të komunës është kryesisht e pazhvilluar, me karakteristika të depopullimit. Vendbanimet e zhvilluara në këtë zonë me lartësi mbidetare 700 – 1,000m janë: Velegllava e Poshtme, Kremenata II, Gragjeniku, Bllata, Bratilloci, Dazhnica, Feriqeva, Gjyrisheci, Gmica, Gogolloci, Huboci, Kolloleqi, Kostadinca, Kranidelli, Kremenata I, Leshtari, Lisocka, Maroca, Meshina, Novosella, Qarakoci, Rahovica, Ruboci, Sedllari, Svirca, Shahiqi, Stralica, Strezoci, Tërstena, Tugjeci, Vaganeshi, Velegllava e Epërme, Vriçeci, Zajqeci, Zhuja, Busavata, Desivojca, Hajnoci, Krileva, Lajçiqi, dhe Moçari.

Zona fushore shtrihet në juglindje dhe verilindje të qytetit të Kamenicës, që kufizohet në juglindje dhe verilindje me malet e Rodopit, e cila ka veçori tjera demografike dhe kushte më të volitshme për zhvillim. Në këtë zonë deri ne 700m lartësi mbidetare shtrihen vendbanimet: Berivojca, Dajkoc, Grizime, Karaçevë e Poshtme, Muçivërc, Petroc, Poliçkë, Shipashnicë e Epërme, Hodonoc, Kamenicë, Karaçevë e Epërme, Koretin, dhe Rogaçicë.

### 1.16.5. Trendi i zhvillimit të vendbanimeve

Raporti në mes të sipërfaqeve të ndërtuara dhe të pa ndërtuara:

Në periudhën kohore 1970 – 2010 komuna e Kamenicës ka patur zhvillim të vazhdueshëm duke i shtuar stokut të saj të ndërtimit afërsisht nga 1,100 – 1,400 ndërtesa për çdo dekadë. Në total, sipas regjistrimit të vitit 2011, në komunë ekzistojnë 5,727 ndërtesa me funksione te ndryshme. Duke i analizuar fotot ajrore te vitit 2018 për periudhën 2011 - 2018, kësaj sasie i shtohen edhe afërsisht 4,000 ndërtesa të banimit – kryesisht shtëpi individuale dhe dyshe. Aksi veri – jugor përgjatë rrugës magjistrale që përshkon vendbanimet duke filluar nga Girizime në veri te qytetit të Kamenicës deri tek Koretini në jug ka pësuar zhvillim më të theksuar. Afërsia me qytetin si qendër administrative, shërbimet dhe mundësitë ekonomike supozohet që janë arsyet kryesore të këtij trendi të zhvillimit.

Bazuar në këtë trend të vazhdueshëm të ndërtimit vendbanimet ndër vite kanë akumuluar hapësirë ndërtimi brenda kufijve të tyre ndërtimor. Bazuar në kufijtë aktual ndërtimor të gjitha vendbanimet kanë sipërfaqe ndërtimit prej 1791.3ha. Nga kjo sipërfaqe, 52% të sipërfaqësi (929.8ha) është e ndërtuar, ndërsa 48% (861.5ha) është e pa ndërtuar.




Harta 23 Trendi i ndërtimeve 1970 – pas vitit 2006



Harta 24 Kufijtë ndërtimor të vendbanimeve

### 1.16.6. Ndërtimet pa leje

Sipas regjistrit të ndërtimeve pa leje janë evidentuar mbi 2444 ndërtime pa leje në tërë territorin e komunës (shih Aneks X). Trajtimi i ndërtimeve pa leje vazhdon të trajtohet konform kërkesave të Ligjit për Ndërtime pa Leje. Prej tyre 123 janë aplikime, nga të cilat 52 legalizime janë përfunduar, 10 janë në listë të pritjes, 9 e kanë çështjen pronësore të pa definuar, 5 nuk kanë paguar taksën për legalizim, 14 nuk kanë dorëzuar incizimet e gjendjes faktike, 4 janë dorëzuar pas afatit, 3 aplikime nuk i trajton ligji dhe 23 janë në proces, refuzim janë 3 (sipas gjendjes së tetorit 2023).




Harta 25 Ndërtimet pa leje në komunë

### 1.16.7. Vendbanimet joformale

Në komunën e Kamenicës janë identifikuar 2 vendbanime joformale:

(1) VJF Kamenica 4 – ky vendbanim është i banuar nga komuniteti RAE dhe ka probleme mjedisore me dendësi të madhe, qasje joadekuate dhe mungesë infrastrukture;

(2) VJF Berivojcë - ky vendbanim është i banuar nga komuniteti Romë dhe ka probleme mjedisore;

### 1.16.8. Vlerësimi i gjendjes: Vendbanimet

Zhvillimi i vendbanimeve në zonën kodrinore – malore është duke stagnuar. Kjo tregon me numrin e zvogëluar të banorëve në këto vendbanime duke migruar në zonë urbane dhe jashtë komunës. Në anën tjetër, vendbanimet në zonën e rrafshët kanë zhvillim më të mirë, për shkak të pozitës së rrafshët dhe shërbimeve sociale dhe publike që ofrohen për qytetarë.

Pavarësisht zhvillimit të përgjithshëm në komunë që mund të konsiderohet si relativisht i ulët dhe me presion jo aq të lartë të zhvillimit, sipërfaqja e ndërtimit bazuar në kufijtë aktual të vendbanimeve është mjaft e lartë. Nga totali i 1791.3ha që përfshinë hapësirën për ndërtim brenda kufijve ndërtimor të të gjitha vendbanimeve, 48% është sipërfaqe e pa ndërtuar. Kjo tregon që mesatarisht çdo vendbanim ka hapësirë për ndërtim edhe një herë më shumë krahasuar me hapësirën aktuale të ndërtuar brenda kufijve të tyre ndërtimor.

Për të analizuar sipërfaqen e nevojshme për të akomoduar rritjen e popullsisë është aplikuar parashikimi i rritjes së popullsisë dhe ekonomive familjare 2021 – 2031 duke marrë për bazë trendin e rritjes 0.93% për vit. Sigurisht që rritja e popullsisë në komunën e Kamenicës është negative, mirëpo indeksi 0.93% është llogaritur që të mbulojë nevojën për njësi të reja të banimit për familje të reja (shiko edhe kapitullin 'Nevojat për banim'). Në këtë kontekst, komuna e Kamenicës, në të gjitha vendbanimet ka nevojë për 34.6 ha për të akomoduar zhvillimin e ardhshëm. Për më shumë, kërkesa e diasporës dhe migrimit të brendshëm për komunë është llogaritë 30%, duke e ngritë në total 45 ha të nevojshme për zhvillim të ardhshëm (shih tabelën më lartë për llogaritje të sakta për vendbanim).

| **Analiza SWOT - Vendbanimet** | |
|---|---|
| **Përparësitë** | **Dobësitë** |
| Presion i ulët i zhvillimit;<br>Zonë urbane kompakte;<br>Lidhje e mirë e vendbanimeve me qytetin e Kamenicës; | Shpopullim i vendbanimeve malore<br>Zhvillim i shpërndarë i vendbanimeve – sidomos përgjatë rrugëve;<br>Humbje e tokës bujqësore si pasojë e zhvillimeve të shpërqendruara; |
| **Mundësitë** | **Rreziqet** |
| Promovimi i zhvillimit kompakt i vendbanimeve rurale bazuar në presion të ulët zhvillimi | Trendi i migrimi të brendshëm fshat-qytet në rritje;<br>Presion për ofrim të shërbimeve publike si pasojë e migrimit të brendshëm – lëvizja e qytetarëve nga vendbanimet malore drejt zonës urbane |

**Sfidat:**

- De popullim i vendbanimeve kodrinore – malore;
- Promovimi i zhvillimit kompakt të vendbanimeve;
- Presion për ofrim të shërbimeve sociale/publike në qytetin e Kamenicës si pasojë e migrimeve të brendshme të popullsisë

**Nevojat për zhvillim**

Për një komunë me presion të ulët të zhvillimi, sipërfaqja e akomoduar për zhvillim nga planet e mëparshme është e ekzagjeruar (42% sipërfaqe e lirë për ndërtim nga 1791.3ha). Zhvillimi i mëtutjeshëm i vendbanimeve duhet të arrihet përmes ngritjes së dendësisë dhe kompaktësisë së vendbanimeve, gjithmonë duke u bazuar në rritje natyrore të popullsisë, kërkesave të tregut dhe nivelit të zhvillimit ekonomik në komunë. Në këtë kontekst rekomandohet zhvillimi në faza, duke u udhëhequr nga investimet publike të komunës.

### 1.17. Shfrytëzimi i tokës

Komuna e Kamenicës ka një sipërfaqe prej 41,611 ha. Nga kjo sipërfaqe, 47% shfrytëzohet si tokë e punueshme dhe kullosa, 48% janë pyje, 3.60% tokë për banim të përhershëm dhe pjesa e mbetur shfrytëzime të tjera.




Harta 26 Shfrytëzimi ekzistues i tokës

| Kodi Hilucs 1 | Klasa Hilucs 1 | Kodi Hilucs 2 | Klasa Hilucs 2 | Klasa Hilucs 3 | Sip Ha | % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | Banim | 5.1 | Banim i përhershëm | Banim i individual dhe kolektiv | 1480.0 | 3.55 |
| 1 | Prodhim parësor | 1.1 | Bujqësi | Toke e punueshme dhe Kullose | 19572.2 | 46.98 |
| 1 | Prodhim parësor | 1.2 | Pylltari | Pylltari | 20123.0 | 48.30 |
| 2 | Prodhim dytësor | 2.1 | Industri e lëndës së parë | Industri e lëndës së parë | 14.3 | 0.03 |
| 1 | Prodhim parësor | 1.3 | Miniere dhe gurore | Miniere dhe Gurore tjetër | 132.7 | 0.32 |
| 4 | Rrjetet e transportit logjistikës dhe infrastrukturës publike | 4.1 | Rrjete të transportit | Infrastrukture e transportit rrugor | 231 | 0.55 |
| 3 | Prodhim tretësor | 3.3 | Shërbim komunitetit | Shërbim arsimor | 18.6 | 0.04 |
| 3 | Prodhim tretësor | 3.3 | Shërbim komunitetit | Shërbim i Administratës | 1.7 | 0.00 |
| 3 | Prodhim tretësor | 3.3 | Shërbim komunitetit | Shërbim tjetër i komunitetit | 11.3 | 0.03 |
| 3 | Prodhim tretësor | 3.3 | Shërbim komunitetit | Shërbim shëndetësi | 3.3 | 0.01 |
| 3 | Prodhim tretësor | 3.3 | Shërbim komunitetit | Shërbim tjetër Varreza | 39.0 | 0.09 |
| 3 | Prodhim tretësor | 3.1 | Shërbimi tregtar | Shërbimi tregtar | 2.9 | 0.01 |
| 3 | Prodhim tretësor | 3.4 | Shërbim kulturor argëtues rekreativ | Hapësirë e hapur rekreative | 16.0 | 0.04 |
| 6 | Shfrytëzim tjetër | 6.3 | Tokë ujore | Tokë ujore | 14.8 | 0.04 |
| | | | **Total:** | | **41,661** | **100.00** |

### 1.17.1. Projeksionet e shfrytëzimit të tokës në raport me PZHK-në e fundit të komunës

PZHK-ja në fuqi, gjatë hartimit në vitin 2012 ka identifikuar kategoritë e shfrytëzimit si në tabelën më poshtë. Kategoritë e mëposhtme paraqesin sasinë e shfrytëzimit të tokës në hektarë për vitin 2012.

| | Kategoria | Ha |
|---|---|---|
| 1. | Fabrika | 0.3783 |
| 2. | Shtëpi | 68.6551 |
| 3. | Oborre | 155.9512 |
| 4. | Rrugë | 491.820 |
| 5. | Lumë | 416.800 |
| 6. | Përrua | 74.5763 |
| 7. | Jaz | 3.4454 |
| 8. | Kanal | 0.3005 |
| 9. | Mbrojtje lumi | 2.6750 |

| | Kategoria | Ha |
|---|---|---|
| 10. | Vend eksploatues rëre | 4.15963 |
| 11. | Kishë | 0.0627 |
| 12. | Fushe sportive | 0.3138 |
| 13. | Varreza | 44.2855 |
| 14. | Xhami | 0.0517 |
| 15. | Shkollë | 1050 |
| 16. | Greminë | 15.2407 |
| 17. | Treg | 2.500 |
| 18. | Gurishte | 23.25717 |
| 19. | Mulli uji | 0.0884 |
| 20. | Jo pjellore | 103.4894 |
| 21. | Të tjera | 20.2946 |
| 22. | Ara | 12284 |
| 23. | Kopsht | 20.3372 |
| 24. | Pemishte | 197 |
| 25. | Vreshtë | 1.0 |
| 26. | Kënetë | 1.4756 |

Krahasimi i projeksioneve të shfrytëzimit të tokës - banim për vitin 2023 me vitin 2012 është si në vijim. Kategoritë tjera nuk janë të krahasueshme për shkak të kategorive të ndryshme të shfrytëzimit të tokës të përdorur në PZHK-në aktuale të vitit 2013.

| Klasa Hilucs 3 | Sip Ha viti 2012 | Sip Ha viti 2023 |
|---|---|---|
| Banim i individual dhe kolektiv | 224.6 - shtëpi | 1480.0 |

## 1.18. Banimi

### 1.18.1. Fondi i banimit

Komuna e Kamenicës sipas regjistrimit të vitit 2011 ka 36,045 banorë të cilët jetojnë në 6,419 ekonomi familjare, prej të cilave 21.8% jetojnë në zonë urbane dhe 78.2% në zonë rurale.

| Kategoria sipas HILUCS | Sipërfaqja ne hektarë | Përqindja sipas zonës së ndërtuar (vetëm objektet) |
|---|---|---|
| Banim i përhershëm (ndërtesa banimi me një njësi) | 1,476.6 | 99.77 |
| Banim i përhershëm (ndërtesa banimi me shumë njësi) | 3.4 | 0.23 |
| **Totali** | **1,480.0** | **100%** |

Tabela 28 Sipërfaqja e tokës sipas kategorisë së shfrytëzimit të tokës - HILUCS

Në kontekst të shfrytëzimit të tokës, nga 41,661 ha te sipërfaqes totale të komunës banimi përfshinë hapësirë prej 1,480 ha apo 3.55% të territorit. Nga kjo sipërfaqe, 1,476 ha (99.77%) shfrytëzohen nga ndërtesa banimi me një njësi (shtëpi individuale, dyshe, dhe ne

varg) dhe 3.4 ha (0.23%) nga ndërtesa banimi me shumë njësi. Në krahasim me ekonomi familjare, numri i njësive të banimit në Kamenicë është më i madh.

Sipas ASK 2011, Kamenica ka një fond të banimit prej 8,625 njësi banimi, prej të cilave 20% gjenden në zonë urbane dhe 80% në zonë rurale. Numri i përgjithshëm i njësive të banimit në Kosovë është 412.884, prej të cilave 175.942 (43%) janë në zonën urbane, ndërsa 236.942 (57%) në zonë rurale. Bazuar në këtë të dhënë, Kamenica përbën 2.1% të numrit të përgjithshëm të njësive të banimit në Kosovë.

Në total, numri i njësive të banimit në vitin 2022 është 9,941. Nga viti 2012 deri me 2022, bazuar në analizën e ndërtesave të banimit në komunë përmes fotografisë ajrore, janë shtuar 1,316 njësi të reja banimi. Ndërsa ne pese vitet e fundit, komuna ka lëshuar leje ndërtimore për objekte shume banesore qe nxjerrin ne treg afërsisht 235 njësi banimi.

| **Vendbanimi** | **Numri i banorëve ASK 2011** | **Ekonomitë familjare ASK 2011** | **Njësitë e banimit ASK 2011** | **Njësitë e banimit 2012 – 2022 fotografi ajrore** |
|---|---|---|---|---|
| Komuna e Kamenicës | 36,045 (100%) | 6,419 (100%) | 8,625 (100%) | 1,316 (100%) |
| Zona urbane | 7,331 (20%) | 1,400 (21.8%) | 1,726 (20%) | 245 (18%) |
| Zona rurale | 28,714 (80%) | 5,019 (78.2%) | 6,899 (80%) | 1,116 (82%) |

Tabela 29 Numri i ekonomive familjare dhe njësive të banimit

Nga 5,723 ndërtesa banimi në komunë, 99.55% përbehen nga ndërtesa banimi me një njësi (shtëpi individuale, dyshe dhe në varg) që gjenden në zonë rurale, dhe vetëm 0.45% nga ndërtesa banimi me shumë njësi – pjesa më e madhe gjenden në zonë urbane.

| **Ndërtesat e banimit** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Vendbanimi** | **Numri** | **%** | **Tipologjia** | **Numri** | **%** |
| Komuna e Kamenicës | 5,723 | 100% | ndërtesa banimi me një njësi | 5,697 | 99.55% |
| | | | ndërtesa banimi me shumë njësi | 26 | 0.45% |
| Zona urbane | 963 | 16.8% | ndërtesa banimi me një njësi | 947 | 98% |
| | | | ndërtesa banimi me shumë njësi | 16 | 2% |
| Zona rurale | 4,760 | 79.7% | ndërtesa banimi me një njësi | 4,750 | 99.8% |
| | | | ndërtesa banimi me shumë njësi | 10 | 0.2% |

Tabela 30 Tipologjia e ndërtesave të banimit

### 1.18.2. Shfrytëzimi i njësive të banimit

Analiza e shfrytëzimit të njësive të banimit nga viti regjistrimit i vitit 2011 na tregon që 26% të njësive të banimit janë të pabanuara. Sipas të dhënave të regjistrimit zyrtar Kamenica qëndron afërsisht njëjtë në këtë aspekt krahasuar me numrin e njësive të pabanuara në nivel të vendit – 24% në tërë Kosovës. Mirëpo, supozohet që ky numër të jetë më i madh duke marr parasysh migrimet e brendshme dhe emigrimet e qytetarëve të Kamenicës. Ky

numër nuk mund të përcaktohet saktësisht për shkak të mungesës së të dhënave të freskëta nga ky sektor.

| Vendbanimi | Gjithsej njësi të banimit ASK 2011 | | | Të pabanuara | Gjithsej të pabanuara |
|---|---|---|---|---|---|
| Kosova | 412.884 | Zona urbane | 175.942 (43%) | 42.340 (42%) | 99.808 (24%) |
| | | Zona rurale | 236.942 (57%) | 57.468 (58%) | |
| Kamenicë | 8,625 | Zona urbane | 1,726 (20%) | 341 (4%) | 2,283 (26.5%) |
| | | Zona rurale | 6,899 (80%) | 1,942 (22.5%) | |

Tabela 31 Njësitë e pabanuara në Kosovë dhe Kamenicë

### 1.18.3. Kushtet e banimit

Komuna e Kamenicës ka fond të vjetër të ndërtesave të banimit. Sipas ASK 2011, 77% të ndërtesave të banimit janë ndërtuar para luftës së fundit në Kosovës, para vitit 1999. Rrjedhimisht, supozohet që pjesa më e madhe e ndërtesave të banimit, përjashto objektet shumë banesore dhe disa shtëpi me një njësi banimi të ndërtuara pas luftës, nuk kanë të aplikuara masa të energjisë eficiente – materiale termoizoluese. Nga 6,419 ekonomi familjare:

- 35% kanë qasje në sistem publik të furnizimit me ujë, 63% furnizohen nga burime të tjera, dhe 2% nuk ka qasje në ujësjellës.
- 47% të ekonomive familjare kanë qasje në sistem publik të shkarkimit të ujërave të zeza; 31% në sisteme private; 16% përmes kanaleve, gropave septike, lum; dhe 6% nuk janë të kyçur fare në asnjë sistem.
- 94% përdorin stufat/oxhakë për ngrohje, 4.3% posedojnë ngrohje qendrore brenda banesave apo ndërtesave në njësi të banimit, dhe 1.3% përdorin rrymë apo burime tjera të ngrohjes. Komuna e Kamenicës nuk ofron ngrohje qendrore te qytetit.

### 1.18.4. Trendet e ndërtimit dhe çmimet mesatare për njësi banimi

Sipas ASK trendi i rritjes natyrale te popullsisë në dhjetë vitet e fundit në Kosovë është 0.9 promilë ne vit. Mirëpo, siç është cekur më lartë në kaptinën e demografisë, pavarësisht trendit të rritjes natyrale të popullsisë, komuna e Kamenicës ka trend negativ – zvogëlim i popullsisë për 3%. Në anën tjetër, si pasojë e migrimit të brendshëm (fshat – qytet) dhe kërkesës së diasporës bën që kërkesa për njësi banimi në zonë urbane të rritet pavarësisht trendit negativ të rritjes së popullsisë. Rrjedhimisht, përcaktimi i kërkesës së saktë të nevojave për banim – njësive të reja të banimit është shumë sfidues.

Bazuar në të dhënat nga lejet e ndërtimit të lëshuara nga drejtoria për urbanizëm, trendi i ndërtimit të njësive të reja për banim në 5 vitet e fundit është 75 njësi banimi në vit për objektet shumë banesore dhe 15 njësi banimi për vit për shtëpi individuale. Viti 2020 është me 0 leje te ndërtimit për shkak të pandemisë COVID 19. Nga totali i përgjithshëm i njësive të reja të banimit (235) në objekte shumë banesore, viti 2018 - 2022, sipas trendit te përgjithshëm të shit-blerjeve të njësive të banimit në nivel te Kosovës supozohet qe

70% e tyre janë në pronësi të diasporës. Sipas trendëve të ndërtimit në 5 vitet e fundit, komunës së Kamenicës i shtohen mesatarisht 80 njësi banimi të reja për vit.

Një trend i ri i shfaqur vitet e fundit është rritja e kërkesave për ndërtim të shtëpive të pushimit në zonat malore, përmes investimeve vetanake por edhe përmes subvencionimit nga ana e MBPZHR-së për ndërtim të njësive akomoduese për turizëm rural, duke ditur që këto zona plotësojnë kriteret kyqe për subvencionet e tilla, siç janë; lartësia mbidetare dhe afërsia me kufirin me Serbinë. Fatkeqësisht shumica e kërkesave për pajisje me leje ndërtimore për këto objekte është refuzuar për arsye që parcelat në të cilat është kërkuar leje, nuk kane qenë të planifikuara për banim.

### 1.18.5. Banimi Social

Janë 2 ndërtesa të banimit social në pronësi të komunës me 55 njësi banimi. Ka edhe 4 shtëpi të banimit individual në lagjen Malësia në fshatin Grizime dhe 14 në lagjen e të kthyerve në Berivojcë. Kërkesat për strehim zakonisht shkojnë në organizatave humanitare dhe trajtohen përmes organizimeve formale e joformale, kështu që komuna nuk i posedon këto të dhëna. Në komunë ka pasur kërkesë vetëm për ndihmë në pagesë në qera.




Harta 27 Dendësia e popullsisë për km$^2$

### 1.18.6. Dendësia e banimit

Në kontekst të përcaktimit të sasisë së tokës për të akomoduar zhvillimin në 8 vitet e ardhshme, dendësia e banimit është element kyç. Dendësia neto e banimit në tërë

komunën e Kamenicës është 6.8 njësi banimi për hektarë. Në zonë urbane dendësia është 11.9, ndërsa në zonën rurale është 6.1 njësi banimi për hektarë. Vendbanimi Velegllavë e Epërme udhëheq me dendësi neto më të lartë duke marrë parasysh sipërfaqen me të vogël të banimit në komunë, 47 njësi banimi për hektarë. Më pas, kemi vendbanimin Kremenatë II me 14.7 njësi banimi për hektarë, pasuar nga Petroci me 11 njësi banimi. Të gjitha vendbanimet tjera kanë dendësi neto më të ulët, nga 1 deri në 10 njësi banimi për hektarë.




Harta 28 Ndërtimet me leje

### 1.19. Vlerësimi i gjendjes: Banimi

Pjesa me madhe e ekonomive familjare dhe njësive të banimit (80%) jetojnë/gjenden në zonë rurale duke i dhënë karakter rural komunës së Kamenicës. Fakti që 80% e njësive të banimit gjenden në zonë rurale dhe përbehen nga ndërtesa banimi me një njësi (shtëpi individuale, dyshe dhe në varg) dëshmon që komuna e Kamenicës ka karakter rural me intensitet relativisht të ulët të zhvillimit. Ndërtesat me shumë njësi banimi në Kamenicë janë të pakta, 0.45% nga totali i njësive të banimit, dhe shtrihen në zonë urbane.

Duke marr parasysh rritjen e numrit të njësive të banimit nga viti 2012 – 2022 dhe zvogëlimin e popullsisë në komunë për 27% (vlerësimi i popullsisë 2021 nga ASK – shih kapitullin e demografisë), supozohet që numri i njësive të pabanuara është edhe më i madh se 2,283. ASK njësitë e pabanuara I definon si banesa për shitje apo për qera. Planifikimi i njësive të ardhshme të banimit duhet të jetë në harmoni të plotë me rritjen

demografike, kërkesave të tregut dhe fondit ekzistues të njësive të pabanuara në komunë.

Krahasuar me normat e planifikimi për dendësinë e banimit, nga 58 vendbanime në Kamenicë, 7% apo 4 vendbanime hyjnë në kategorinë e sipërfaqes sub-urbane me dendësi 6 – 21 njësi banimi për hektarë, 59% apo 34 vendbanime hyjnë në kategorinë sipërfaqe rurale me intensitet të lartë me dendësi 5 – 10 njësi banimi, dhe 34% apo 20 vendbanime hyjnë në kategorinë sipërfaqe rurale me intensitet të ulët me dendësi 1 – 5 njësi banimi për hektarë.

| **Vendbanimet** | **Kategoritë e sipërfaqeve të dendësisë sipas normave të planifikimit** | **Dendësia e banimit sipas normave të planifikimit, njësi banimi në ha** |
|---|---|---|
| Kamenicë, Kremenatë II, Petroc, Velegllavë e Epërme | Sipërfaqe sub-urbane | 6 - 21 |
| Berivojcë, Bllatë, Boscë, Dajkoc, Grizimë, Hajnoc, Hodonoc, Hogosht, Karaçevë e Epërme, Karaçevë e Poshtme, Kolloleq, Kopernicë, Koretin, Kranidell, Kremenatë I, Lisockë, Marocë, Moçar, Muçivërc, Novosellë, Poliçkë, Rahovicë, Rogaçicë, Sedllar, Svircë, Shahiq, Shipashnicë e Epërme, Shipashnicë e Poshtme, Tërstenë, Topanicë, Vaganesh, Vriqec, Zajçec, Zhujë | Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë | 5 - 10 |
| Bratilloc, Busovatë, Dazhnicë, Desivojcë, Feriqevë, Gmicë, Gogolloc, Gragjenik, Gjyrishec, Kostadincë, Krilevë, Lajçiqi, Leshtar, Meshinë, Qarrakoc, Ruboc, Strelicë, Strezoc, Tugjec, Velegllavë e Poshtme | Sipërfaqe rurale me intensitet të ulët | 1 – 5 |

Tabela 32 Krahasimi i dendësisë së banimit me dendësinë nga normat e planifikimit

Në këtë kontekst mund të konkludohet që komuna e Kamenicës ka intenzitet relativisht të ulet zhvillimit, dhe që zona urbane nuk është nën presion të madh të zhvillimit në raport me zonën rurale në përgjithësi – krahasimi i dendësisë.

| **Analiza SWOT - Banimi** | |
|---|---|
| **Përparësitë** | **Dobësitë** |
| - Dendësi relativisht e ulët e banimit - 6.8 njësi banimi për hektarë<br>- Casje relativisht të mirë në shërbime publike | - Numër i madh i njësive të pabanuara (2,283)<br>- Fond relativisht i vjetër i ndërtesave - 77% të ndërtuara para vitit 1999;<br>- Inspektim i pamjaftueshëm i ndërtimeve; |

| | |
|---|---|
| | - Mungesë e politikave komunale për banim të përballueshëm; |
| **Mundësitë** | **Rreziqet** |
| - Shfrytëzimi i potencialit të sektorit privat për investim;<br>- Hartimi i politikave nga niveli qendror për banim të përballueshëm;<br>- | - Ndikimi i kërkesave të sipërmarrësve/diasporës në rritje të dendësisë për banim; |

**Sfidat:**

- Menaxhimi i duhur i kërkesave të sipërmarrësve/investitorëve për rritje të dendësisë për banim – rizhvillim, që ndikon negativisht në ofrim të shërbimeve përcjellëse publike, probleme në parkim dhe krijon pamje të shëmtuar të mjedisit të ndërtuar;
- Kontrolli i rregullt i zhvillimit – ndërtimi i objekteve të banimit brenda zonës së ndërtimit në vendbanime;
- Krijimi i politikave lokale për banim të përballueshëm – sidomos për familjet e reja;

**<u>Nevojat për banim</u>**

Bazuar në parashikimet për rritje të popullsisë (kaptina për demografi), deri në vitin 2030 parashikohet trend i afatshkurtër negativ të rritjes së popullsisë në komunën e Kamenicës. Përcaktimi i nevojave për banim bazohet në rritje të popullsisë, kërkesa të tregut lokal dhe të diasporës. Në njërën anë, bazuar në trend të pritshëm afatshkurtër negativ të rritjes demografike, ndërsa në anën tjetër rritja e kërkesave nga tregu për njësi të reja banimi, ato nga komuniteti lokal dhe sidomos të diasporës, komuna duhet të përcaktojë tokë të mjaftueshme të zonës së ndërtimit për banim. Ne këtë formë, konfirmohet qe akomodimi i interesave te diasporës, është shumë i rëndësishëm për zhvillim te komunës.

Në proces të përcaktimit të dendësisë së banimit brenda kufijve të përcaktuar me ketë PZHK, komuna duhet të përcaktojë zona të banimit më objekte shumë banesore që ofrojnë deri në 100 njësi të reja banimi në treg çdo vit. Një sasi e tillë e njësive të banimit do të t'i përgjigjej pozitivisht kërkesave të tregut lokal (krijimi i familjeve të reja, migrimi fshat-qytet) të diasporës.

Gjithashtu, kohëve te fundit është rritur numri i ndërtimeve te vilave malore ne zonën e malësisë se Kamenicës (kryesisht pa leje), duke patur parasysh se 3 viteve te ardhshme planifikohet te asfaltohen rruge malore, parashikohet qe do te shtohet numri i ndërtimeve te shtëpive te pushimit/vilave malore.

## 1.20. Vlerësimi i kapaciteteve administrative

Administrata e Komunës së Kamenicës është e ndërtuar dhe e organizuar në 11 Drejtori, 1 Zyre komunale për Komunitete, 6 sektorë që funksionojnë në kuadër të zyrës së Kryetarit (sektori i auditimit të brendshëm, sektori i burimeve njerëzore, sektori për integrim evropian, sektori për komunikim me publikun, sektori ligjor i Komunës dhe sektori prokurimit) dhe Zyra e Kryetarit. Në vitin 2023 numri i të punësuarve në administratën komunale ka qenë 241, ndërsa në sektorin e arsimit, shëndetësisë dhe njësisë së zjarrfikësve në përgjithësi ka qenë 721, 154 dhe 33, gjegjësisht. Numri i të punësuarve sipas drejtorive është si në vijim: Administrata e përgjithshme – 36; Kultura, Rinia dhe Sporti – 46; Buxhet dhe Financa – 25; Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale ka 10 të punësuar; Arsimi – 13; Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor – 12; Shërbimet Publike, Ambientit dhe Inspektoratit – 17; Zhvillimi ekonomik dhe diaspora – 5; Bujqësia – 22; Pronë, Kadastri Dhe Gjeodezia – 9; Mbrojtje dhe Shpëtim – 6. Zyra e Kryetarit me 6 sektorët i ka 28, derisa Zyra e Komuniteteve i ka 8 të punësuar. Nga numri i gjithmbarshëm i të punësuarve, 128 apo 68.44% kanë kualifikim me nivel të plotë terciar (fakultet). Me nivel të shkollës së lartë janë 7 të punësuar ose 4%. Me nivel sekondar (shkollë e mesme) janë gjithsej 53 të punësuar ose 28%.

### 1.20.1. Kapacitetet financiare

**Buxheti komunal** - Buxheti i komunës së Kamenicës ka shënuar ngritje në vazhdimësi nga viti 2019. Krahasuar me vitin 2019, buxheti për vitin 2023 ka shënuar ngritje për rreth 32% dhe arrin vlerën prej 12,381,899 Euro. Mirëpo edhe përkundër rritjes së vazhdueshme, buxheti i komunës vazhdon të jetë i limituar karshi përmbushjes së nevojave dhe kërkesave për ofrim sa më cilësor të shërbimeve ndaj qytetarëve. Për nga struktura e financimit, gjatë periudhës 2019-2023, rreth 85-92% e buxhetit komunal është realizuar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK), pjesa tjetër nga të Hyrat Vetanake të Komunës dhe burimet tjera të financimit.

Tabela 33 Struktura e Buxhetit sipas burimeve te Financimit, 2023




Transferet Qeveritare përbëhen nga:

a. Granti i Përgjithshëm Qeveritar;

b. Granti Specifik për Arsim; dhe

c. Granti Specifk për Shëndetësi.

Edhe përkundër luhatjeve të vogla ndër vite, granti i përgjithshëm mbetet si burim kryesor i të hyrave buxhetore, me pjesëmarrje prej rreth 44% në totalin e buxhetit vjetor.

**Të hyrat vetanake** të komunave janë përcaktues i rëndësishëm i kapacitetit financiar të komunës për të ofruar shërbime dhe për investime në infrastrukturë, prandaj është e rëndësishme që këto burime financimi të rriten, për të plotësuar të hyrat nga transferet ndërqeveritare mbi të cilat komunat nuk kanë kontroll të drejtpërdrejtë.

**Shpenzimet** – Pjesa dërmuese e buxhetit të komunës është e orientuar drejt shpenzimeve rrjedhëse (operative). Të dhënat e Buxhetit për vitin 2022, dëshmojnë se rreth 68% e buxhetit është shpenzuar në kategorinë "Rroga dhe Paga" ku pjesa më e madhe i është dedikuar të punësuarve në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë. Mallrat dhe Shërbimet me 15% përbëjnë kategorinë e dytë të shpenzimeve pasuar nga investimet kapitale me 12%, transferet dhe subvencionet me 3% dhe shpenzimet komunale me 2%.

| Kategoria ekonomike: | Buxheti i ekzekutuar/planifikuar- viti | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 |
| Rroga dhe paga | 7,114,526.00 | 7,114,526.00 | 7,300,000.00 | 7,542,413.00 | 7,566,476.00 |
| Mallra dhe shërbime | 956,558.00 | 1,132,520.00 | 1,354,350.00 | 1,619,200.00 | 1,943,000.00 |
| Shpenzime komunale | 184,000.00 | 188,250.00 | 195,000.00 | 211,800.00 | 238,000.00 |
| Subvencione dhe transfere | 200,000.00 | 200,000.00 | 211,000.00 | 343,000.00 | 447,000.00 |
| Shpenzime kapitale | 904,363.00 | 766,648.00 | 1,665,070.00 | 1,279,178.00 | 2,187,423.00 |
| Gjithsej | 9,359,447.00 | 9,401,944.00 | 10,725,420.00 | 10,995,591.00 | 12,381,899.00 |

Tabela 34 Pasqyra dhe trendët e planifikimit te buxhetit sipas kategorive ekonomike, 2019- 2023

| Kategoria ekonomike: | Projeksioni (EURO) | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 |
| Rroga dhe paga | 7,566,476.00 | 9,349,572.00 | 9,647,800.00 | 9,961,000.00 |
| Mallra dhe shërbime | 1,943,000.00 | 2,097,000.00 | 2,217,603.00 | 2,387,00.00 |
| Shpenzime komunale | 238,000.00 | 254,000.00 | 262,000.00 | 272,000.00 |
| Subvencione dhe transfere | 447,000.00 | 648,000.00 | 705,000.0 | 750,000.00 |
| Shpenzime kapitale | 2,187,423.00 | 2,197,973.00 | 2,433,206.69 | 2,632,554.00 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Gjithsej** | 12,381,899.00 | 14,546,545.00 | 15,265,609.69 | 13,615,554.00 |

Tabela 35 Projeksioni i buxhetit total të komunës sipas kategorisë së shpenzimeve[8]




[8] KAB Kamenicë, 2024-2026




Tabela 36 Struktura e shpenzimeve buxhetore, sipas klasifikimit ekonomik 2022

### 1.20.2. Korniza afatmesme buxhetore komunale (KAB)

Në përputhje me kërkesat ligjore, Komuna e Kamenicës ka hartuar KAB-in me të cilën është planifikuar buxheti dhe orientimi i shpenzimeve publike në tri vitet e ardhshme 2024-2026. Planifikimi i politikave në nivel komunal, është bazuar kryesisht në të dhënat e përgjithshme për rritjen buxhetore në nivel të Qeverisë qendrore, siç parashihet në KASH 2023-2026, si dhe bazuar në nevojat zhvillimore drejt sektorëve prioritarë të komunës.

Sipas këtyre vlerësimeve, pjesa më e madhe e shpenzimeve të komunës për vitin 2024 dhe tutje ndahet për sektorin e arsimit para-universitar dhe shëndetësisë primare që në total përbëjnë 63.19 % të buxhetit të planifikuar. Pjesa tjetër e resurseve është e ndarë për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim, Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Kulturë, Rini dhe Sport, etj. Pjesa e mbetur ndahet për shërbimet mbështetëse si dhe për shpronësime që janë në funksion të zhvillimit urban dhe të infrastrukturës së komunës.

Gjatë viteve të fundit është duke u bërë presion i vazhdueshëm nga Qeveria qendrore për ngritje të arkëtimit e të hyrave vetanake komunale. Për të adresuar nevojat gjithnjë në rritje, Komuna e Kamenicës ka bërë një planifikim ambicioz të nivelit e të hyrave vetanake të komunës. Të hyrat tatimore (Tatimi në pronë dhe tatimi në tokë) vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë në të hyrat e përgjithshme dhe pritet të rriten rreth 25.82% në periudhën afatmesme.

Për vitin 2024 planifikohet një rritje e planifikimit të Tatimit në Pronë në krahasim me vitin 2023. Planifikimi i Tatimit në Pronë për vitin 2024 në shumën prej 593,895.00 euro të planifikuara, ndërsa për vitin 2025 kemi të planifikuar shumën prej 609,040.00 dhe për vitin 2026 planifikimi I tatimit në prone duke llogaritur tatimi në tokë është 638,249.00€.




Tabela 37 Trendi i parashikimit të hyrave vetanake komunale[9]

Vlerësimi i arkëtimit të hyrave nga burimet vetanake, është bazuar në fushat kryesore te të hyrave si:

- Tatimi në pronë dhe tatimi në tokë;
- Certifikatat dhe dokumentet zyrtare;
- Taksat e pajisjeve motorike
- Lejet per ndërtesa
- Të hyrat nga gjobat në trafik
- Te hyrat nga qiraja
- Bashke-pagesat per arsim
- Taksat tjera komunale.

[9] KAB Kamenicë, 2024-2026

### 1.20.3. Investimet kapitale

Investimet kapitale kane pësuar ngritje 4 viteve te fundit, kryesisht shkojnë ne infrastrukture dhe ndërtim te objekteve publike. Në bazë të kufijve të dalë nga KAB-i për vitin 2024-2026 del se Komuna e Kamenicës ka një planifikim të buxhetit më të lartë krahasuar me vitin 2023 ka një rritje prej 3.23 % apo (70,550.00) €. Kjo rritje ka rezultuar të jetë si rezultat i ndarjes dhe rritjes së Grantit të Përgjithshëm. Pjesëmarrja e kategorisë për Investime kapitale në shpenzime të përgjithshme të buxhetit të komunës, gjatë vitit 2024 do të jetë 15.52% .

## 1.21. Vlerësimi i Kapaciteteve investive

Siç u përshkrua lart, sipas KAB 2024-2026, parashihet që buxheti vjetor i Komunës të jetë mesatarisht rreth 16,002,000 Euro në 2026. Struktura e parashikuar e shpenzimeve parasheh rritje të pjesëmarrjes së pagave dhe mëditjeve (për 30.02%) krahasuar me shpenzimet në vitin 2023, ndërkaq parashihet një rritje e lehtë e pjesëmarrjes së investimeve kapitale (3.23%), deri në vitin 2026. Pjesëmarrja e kategorisë për Investime kapitale në shpenzime të përgjithshme të buxhetit të komunës, gjatë vitit 2024 do të jetë 15.52% . Pjesëmarrja e kategorisë për subvencione në shpenzime të përgjithshme të buxhetit të komunës gjatë vitit 2024 do të jetë 4.39%, ndërsa krahasuar me vitin 2023 ka rritje prej 42.73%.

Bazuar në çfarë u tha më sipër, mund të konkludojmë se për nga aspekti i financimit nga buxheti komunal, Komuna e Kamenicës do të mbetet kryesisht në nivel të plotësimit të nevojave bazike, atë të mbulimit të pagave të sektorit publik (administratë, shëndetësi, arsim), subvencioneve dhe deri në një masë, mbulimit të nevojave sociale dhe infrastrukturës teknike. Varësia e theksuar nga grantet qendrore qeveritare, dëshmon për një pozitë të vështirë të qëndrueshmërisë financiare të Komunës. Ashtu siç u përshkrua më lartë, mbi 90% të burimeve të hyrave komunale vijnë nga niveli qendror. Komuna duhet të punojë edhe më tutje në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve për rritje të arkëtimit të hyrave vetanake të komunës, me theks të veçantë të Tatimit në Pronë.

Aktualisht, kapaciteti investues i Komunës së Kamenicës, mbetet i kufizuar në nivel të shpenzimeve kapitale të aprovuara me KAB 2024-2026, vlera e të cilave për tre vitet e ardhshme planifikohet të jetë rreth 7.300.000 EUR.

Për shkak të kufizimit të mundësive të financimit, mbetet kyç identifikimi dhe vlerësimi i potencialeve komunale në funksion të nxitjes së partneriteteve publiko-private, duke përfshirë edhe asetet komunale (prona, infrastrukturë, shërbime), si dhe mbështetjes me kornizë rregullative lokale dhe procedura administrative.

Komuna e Kamenicës ka të nënshkruara Memorandume të ndryshme për projekte të caktuara me Ministri të ndryshme. Por, sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2023– dhe parashikimit për 2024-2025 ka projekte të cilat paraqesin rrezik për devijim të planifikimit

të buxhetit komunal. Në obligimet e Komunës përmendet që Komuna duhet të i ndërmerr të gjitha masat që projekti të përfundoj në përputhje me ndarje buxhetore.

## 2. Korniza e zhvillimit hapësinor

### 2.1. Korniza e zhvillimit hapësinor

Korniza zhvillimit hapësinor paraqet ndryshimet të cilat duhet të realizohen për të siguruar zhvillimin e ardhshëm social, ekonomik dhe mjedisor.

**Vizioni:** Vizioni për zhvillimin e ardhshëm të komunës shprehë qëllimet afatgjata të synuara për tu arritur, të përcaktuara përmes procesit pjesëmarrës të palëve të interesit dhe analizave shumë-sektoriale, duke u nisur nga gjendja aktuale, sfidat e identifikuara, nevojat për zhvillim, si dhe potencialet lokale. Kjo pjese paraqet të ardhmen e dëshiruar për komunën në mënyrë që të sjellë zhvillim dhe përmirësim të mirëqenies së qytetarëve.

Duke u bazuar në informata nga situata ekzistuese, analiza e përparësive, mundësive, dobësive dhe rreziqeve (SWOT analiza), është përcaktuar edhe vizioni për të ardhmen e komunës.

Deklarata e vizionit shpreh zhvillimin e ardhshëm të komunës në formë të përmbledhur sikurse parathënia e një libri e cila përshkruhet me disa fjalë dhe kjo deklaratë është si në vijim:

**<u>Deklarata Vizionit:</u>**

**Kamenica, thesar natyre; vend i mirëqenies dhe i balancimit shoqëror, mjedisor dhe ekonomik.**

Kjo deklarate Vizioni udhëzon që Kamenica të zhvillohet ne mënyrë te balancuar; shfrytëzimi i thesarit natyror dhe zonave te banimit për zhvillimin e turizmit rural; zhvillimi i ekonomisë e bazuar ne minerale, prodhim dhe asaj familjare; vend atraktiv për investime kapitale dhe individuale, vendore dhe te huaja.

Kamenica parasheh zhvillime konkrete dhe të realizueshme siç janë:

- Komunë si ure lidhëse ne nivel rajonal, nacional dhe me gjere.
- Planifikim të ndërtimeve te qëndrueshme dhe infrastrukturë adekuate të hapësirave të përbashkëta (publike).
- Shfrytëzim racional të mjedisit dhe shfrytëzimi i tij për zhvillim me te qëndrueshëm ekonomik.
- Mbrojtje dhe ri funksionalizimi i vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore
- Krijimi i mundësive të mëdha për investitor të brendshëm dhe të jashtëm gjate gjithë vitit.

- Vend i përshtatshëm për zhvillim të bujqësisë me fokus ne blegtori, pylltari, perimtari ... (etj.)
- Qendër e zhvillimit te turizmit rural, malor dhe fushor; e turizmit te mirëqenies (uellness) dhe rekreacionit.
- Vende ku përkrahet edukimi, puna dhe sipërmarrja ne shërbimet kualitetit jetësor te gjitha grupeve shoqërore pa dallime moshe a etnie

## 2.2. Qëllimet dhe objektivat zhvillimore

### 2.2.1. Infrastruktura publike

**Arsimi, shëndetësia, mirëqenia, administrata publike**

Infrastruktura publike, përfshi arsimin, shëndetësinë dhe mirëqenien, dhe administratën publike duhet të përmirësohen si shërbime bazuar në qëllimet dhe objektivat si në vijim:

**Arsimi**

Komuna e Kamenicës është në proces të rishikimit të strategjisë së objekteve shkollore për shkak të numrit të vogël të nxënëseve – 51% e shkollave kanë më pak së 70 nxënës, gjë që ndikon në kualitet të mësimit. Për më shumë një pjesë e shkollave nuk kanë kabinete të veçanta për mësim, infrastrukturë për sport, kushte të përshtatshme higjienike dhe një pjesë e madhe fëmijëve të moshave (0 – 6 vjeç) nuk kanë qasje në shërbime të arsimit parashkollor dhe para fillor. Bazuar në gjendjen ekzistuese, komuna do të trajtoj sfidat e identifikuara përmes qëllimeve dhe objektivave si në vijim:

**Qëllimi 1: Arsim cilësor**

**O1.1.** Ri-organizimi i rrjetit të ndërtesave të arsimit dhe funksionalizimi i objekteve pasive ne pika për ndërmarrësi apo/dhe komunitet, në tërë territorin e komunës;

**O1.2.** Rritja e numrit të ndërtesave për çerdhe – nga 2 në 4, dhe arsim para fillor nga 20 në 20 brenda 8 viteve të ardhshme;

**O1.3.** Rritja e numrit të fëmijëve të regjistruar në çerdhe (0 – 5 vjeç) për 30% (70%) dhe arsim para fillor (5 – 6 vjeç) për 100% në 8 vitet e ardhshme;

**Shëndetësia dhe mirëqenia sociale**

Sektori i shëndetësisë në komunë për nga infrastruktura – objektet është në nivel të kënaqshëm. 50% të objekteve nuk janë funksionale për shkak të mungesës së stafit shëndetësor dhe mungesës së popullsisë – sidomos në zonat malore. Komuna vazhdon të ofrojë mbështetje për personat dhe familjet në nevojë përmes institucioneve përkatëse. Mirëpo çështjet e banimit social për familjet në nevojë ende nuk janë në nivelin e duhur. Trajtimi i çështjeve të sipërpërmendura do të bëhet përmes qëllimeve dhe objektivave në vijim.

**Qëllimi 2: Sigurimi i shërbimeve cilësore shëndetësore dhe ngritja e nivelit të mirëqenies sociale**

**O2.1** Riorganizimi i objekteve shëndetësore sipas shpërndarjes hapësinore dhe dendësisë së popullsisë – duke u fokusuar në objektet ekzistuese;

**O2.2** Krijimi i deri 50 njësive të reja për banim social deri në vitin 2028;

**O2.3** Qendra për te moshuar

**Administrata publike**

Administrata e komunës është e shpërndarë në disa objekte, dhe si e tillë nuk mundëson shërbim efektiv për qytetarë. Qëllimet dhe objektivat në vijim synojnë që të trajtojnë këtë çështje.

**Qëllimi 3: Rrjet efektiv i infrastrukturës së administratës publike**

**O3.1** Koncentrimi i shërbimeve të administratës komunale në një hapësirë të caktuar, që ndikon në përmirësim të shërbimeve për qytetarë;

**O3.2** Sigurimi i hapësirave për funksionim të bashkësive lokale / zyrave të vendit;

**O3.3** Ofrimi i shërbimeve komunale në formë digjitale për 50% deri në vitin 2027.

#### 2.2.2. Infrastruktura sociale (kultura, sporti, hapësirat publike, varrezat)

Komuna e Kamenicës posedon një rrjet jo shumë të kënaqshëm të infrastrukturës sociale – përveç hapësirave publike të cilat ekzistojnë në qytet mirëpo kanë nevojë në ngritje të kualitetit fizik të tyre. Infrastruktura sociale në komuna ka nevojë për shtrirje të balancuar hapësinore për të ofruar shërbime të nevojshme për të gjithë qytetarët. Kjo do të arrihet përmes qëllimeve dhe objektivave si në vijim:

**Qëllimi 4: Përmirësimi i infrastrukturës sociale – objekteve dhe hapësirave, dhe ngritja e kualitetit fizik të tyre**

**O4.1** Rritja e numrit të objekteve të reja të kulturës dhe artit në komunë për 1 deri në vitin 2031;

**O4.2** Rritja e infrastrukturës për sport dhe rekreacion në gjithë territorin e komunës për 3 deri në vitin 2031;

**O4.3** Rritja e infrastrukturës për sport nëpër shkolla për 3 deri në vitin 2031;

**O4.4** Rritja e numrit të hapësirave publike në zonën urbane dhe qendrat sekondare-qendrat bazike të komunës për 5 deri në vitin 2031;

**O4.5** Sigurimi i hapësirës për zgjerim të varrezave në qytet deri në vitin 2031

**O4.6** Shtimi i aktiviteteve kulturore dhe artistike dhe ngritja e cilësisë së atyre ekzistuese – minimum 2 ngjarje kulturore/artistike apo sportive në muaj.

### 2.2.3. Trashëgimia kulturore dhe natyrore, mjedisi dhe fatkeqësitë natyrore

Komuna e Kamenicës identifikohet me pasuri të mjaftueshme të trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Mirëpo, këto pasuri janë në gjendje jo të mirë dhe rrjedhimisht kanë nevojë për mbrojtje nga zhvillimet e pakontrolluara. Komuna synon të trajtoj këto çështje përmes qëllimeve dhe objektivave në vijim:

**Qëllimi 5: Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore në funksion të zhvillimit ekonomik lokal**

**O5.1** Konservimi dhe promovimi i shfrytëzimit të adaptueshëm të aseteve të trashëgimisë kulturore përmes hartimit të politikave – planeve të konservimit dhe menaxhimit për objektet/zonat ekzistuese;

**O5.2** Kontrolli i zhvillimeve - ndërtimeve brenda perimetrit të objekteve të trashëgimisë kulturore;

**Qëllimi 6: Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë natyrore në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik**

**O6.1** Mbrojtja e trashëgimisë natyrore përmes hartimit të politikave komunale;

**O6.2** Krijimi i bazës së të dhënave për menaxhim të trashëgimisë natyrore;

**O6.3** Promovimi dhe ngritja e vetëdijes në mbrojtjen e trashëgimisë natyrore në funksion të zhvillimit të turizmit;

**Qëllimi 7: Zvogëlimi i ndotjes dhe ngritja e qëndrueshmërisë së infrastrukturës së komunës nga fatkeqësitë natyrore dhe tjera**

**O7.1** Promovimi i mjedisit të pastër si dhe ngritja e vetëdijes për rëndësinë e mjedisit përmes hartimit të politikave të komunës – PLVM;

**O7.2** Krijimi i infrastrukturës për menaxhim dhe adaptim ndaj rreziqeve dhe fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera;

### 2.2.4. Ekonomia

Komuna e Kamenicës ka potencial për zhvillim ekonomik duke i shfrytëzuar në mënyrë të qëndrueshme burimet natyrore – mjedisin, pasuritë nëntokësore dhe industrinë e përpunimit. Për më shumë, Kamenica ka pozitë të mirë atraktive gjeografike, gjë që e favorizon si lokacion të përshtatshëm për zhvillim e bashkëpunim ndërkufitar dhe ndër-komunal. Duke marr parasysh këto potenciale komuna zotohet që përmes politikave të mirëfillta të ndikojë në zvogëlim të papunësisë dhe rritje të kualitetit të jetës për qytetarët e sajë.

### Ndërmarrjet

Kamenica ka ndërmarrësi të zhvilluar deri në një masë – marrë parasysh potencialet për zhvillim të këtij sektori. Qëllimet dhe objektivat në vijim do të krijojnë kushte më të përshtatshme për zhvillim të mëtutjeshëm të ndermarrësisë.

**Qëllimi 8: Përmirësimi i kushteve për zhvillim të ndërmarrësisë**

**O8.1** Përmirësimi i infrastrukturës për zonat ekonomike të veçanta: zona industriale Berivojcë, Topanicë dhe Bllatë;

**O8.2** Përkrahja e bizneseve të reja përmes mbështetjes financiare – lehtësira, subvencione, dhe grante;

**O8.3** Ngritja e kapaciteteve profesionale me fokus te veçantë tek te rinjtë;

**O8.4** Shtimi i kapaciteteve për ambalazhim dhe prodhim të ujit të pijes .

### Bujqësia

Komuna e Kamenicës ka karakter rural dhe potencial të madh për zhvillim të bujqësisë dhe blegtorisë – 90% e territorit të komunës është tokë e punueshme, kullosa, dhe pyje. Bujqësia si sektor kyç i zhvillimit në komunë ka nevojë për mbështetje më të fuqishme. Qëllimet dhe objektivat në vijim synojnë që ofrojnë këtë mbështetje ne 8 vitet e ardhshme.

**Qëllimi 9: Krijimi i kushteve për zhvillim të qëndrueshëm të bujqësisë**

**O9.1** Menaxhimi dhe konsolidimi i tokave bujqësore – krijimi i parcelave të përshtatshme për shfrytëzim;

**O9.2** Përmirësimi i infrastrukturës për toka bujqësore – qasje dhe sistem të ujitjes;

**O9.3** Përmirësimi i infrastrukturës për grumbullimin, ruajtjes dhe përpunimin e prodhimeve bujqësore;

**O9.4** Shtimi i sipërfaqeve drunore dhe bimëve 1 vjeçare mjaltëdhënëse.

### 2.2.5. Vendbanimet dhe Banimi

Komuna e Kamenicës përbëhet prej vendbanimeve me funksion dhe karakter të ndryshëm – 58 vendbanime në total. Komuna përmban vendbanime të tipit të shpërndarë dhe të shtrirë. Për nga funksioni dallojmë vendbanime rurale primare – fshatra tipike bujqësore, dhe vendbanime që ofrojnë funksione shoqërore si bashkësitë lokale dhe zyra e vendit, shkolla fillore, ambulanca, shitoret me shumicë e pakicë për furnizimin e popullsisë, ndonjë veprimtari zejtare etj. (Hogosht, Muqiverc dhe Rogoçicë). Qëllimet dhe objektivat e komunës lidhur me zhvillimin e ardhshëm të vendbanimeve janë si në vijim.

**Qëllimi 10: Zhvillim kompakt dhe i balancuar i vendbanimeve**

**O10.1** Qendrat sekondare-qendrat bazike si vendbanime dytësore deri në vitin 2031 do të dallohen sipas funksionit dhe karakteri i zhvillimit – shërbimet publike dhe sociale;

**O10.2** Në 8 vitet e ardhshme, të gjitha zhvillimet në vendbanime do të ndodhin brenda kufijve ndërtimor dhe zhvillimi do të bëhet në faza – të udhëhequra nga investimet publike të komunës;

**Banimi**

Nga totali i 8'625 njësive të banimit në komunë, 20% gjenden në qytetit e Kamenicës, dhe 80% në zonën rurale – fakt ky që e konfirmon karakterin rural të komunës. Për më shumë, shtëpitë njëshe, dyshe dhe në varg dominojnë si tipologji të objekteve të banimit duke konfirmuar që komuna ka intensitet dhe presion relativisht të ulët për zhvillim. Në anën tjetër, duke marr parasysh rritjen e numrit të njësive të banimit nga viti 2012 – 2022 dhe zvogëlimin e popullsisë në komunë për 27%, supozohet që numri i njësive të pabanuara arrinë deri në 26% nga totali i njësive të banimit. Komuna duhet balancojë kërkesat për krijim të njësive të reja të banimit në raport me rritjen natyrore të popullsisë dhe kërkesat e tregut, dhe të përmirësojë kushtet e banimit

**Qëllimi 11: Përmirësimi i kushteve për banim.**

**O11.1** Çdo objekt i ri i banimit – sidomos objektet shumë-banesore aplikojnë masat për efiçiencë të energjisë (fasadë, dyer dhe dritare) sipas kërkesave ligjore;

**O11.2** Çdo vit, 5% nga totali i njësive të reja të banimit janë më çmim të përballueshëm;

### 2.2.6. Infrastruktura dhe shërbimet e transportit

Transporti rrugor zhvillohet përmes rrjetit të rrugëve prej 600km. 50% të rrugëve janë të ndërtuara dhe një pjesë e madhe e tyre është e kategorizuar. Mirëpo, pavarësisht kategorizimit, rrugët lokale në praktikë ende nuk dallohen sipas funksionit dhe nuk kanë dizajn adekuat i cili do të mbështeste zhvillimet hapësinore dhe urbane në komunë. Infrastruktura për këmbësorë, dhe biçikleta në qytet është relativisht e mirë, për dallim nga fshatrat. Parkimi nuk është problem i theksuar për shkak të intensitetit të ulët të zhvillimit. Nuk ka transport publik urban, mirëpo vetëm linja ndërurbane që ofrojnë lidhje me qytetet tjera. Komuna synon që të përmirësojë gjendjen e sektorit të transportit përmes qëllimeve dhe objektivave si në vijim.

**Qëllimi 12: Zhvillimi i transportit/mobilitetit të qëndrueshëm në komunë**

**O12.1** Kategorizimi dhe dizajnimi i rrugëve sipas kategorive përkatëse deri në vitin 2026 – duke i kushtuar rëndësi të veçantë këmbësorëve dhe biçikletave;

**O12.2** Përmirësimi i infrastrukturës për parkim – shenjëzimi i parkimit publik deri në vitin 2026;

**O12.3** Krijimi i rrjetit për këmbësorë dhe biçikleta që e lidhë qytetin me pikat atraktive në komunë deri në vitin 2028 – shenjëzimi dhe investimet fillestare;

**O12.4** Zgjerimi i infrastrukturës rrugore dhe forcimi i ndërlidhjes nga qendrat sekondare-qendrat bazike në drejtim të autostradës nacionale.

### 2.2.7. Infrastruktura teknike

**Ujësjellës, kanalizim dhe rrjeti atmosferik**

Komuna ka kapacitet të duhur për të përmbushur nevojat aktuale për ujë të pijshëm. Rrjeti i ujësjellësit është i shtrirë në 72% të vendbanimeve, ndërsa 28% të vendbanimeve nuk kanë qasje në ujë të pijshëm. Ndërsa, sa i përket kanalizimit vetëm 25% e vendbanimeve kanë qasje në rrjet të kanalizimit, derisa ujërat e zeza nuk trajtohen dhe shkarkohen në lumenj. Komuna synon që të përmirësojë infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit përmes qëllimeve dhe objektivave në vijim.

**Qëllimi 13: Përmirësimi i infrastrukturës për ujë, kanalizim dhe rrjet atmosferik**

**O13.1** Përfundimi i rrjetit të ujësjellësit për 90% të ekonomive familjare deri në vitin 2031;

**O13.2** Lidhja e 90% të ekonomive familjare në rrjet të kanalizimit deri në vitin 2031;

**O13.3** Krijimi dhe funksionalizimi i infrastrukturës për akumulim të ujit – digat për akumulim (Kikë dhe Kremenatë);

**O13.4** Krijimi i infrastrukturës për trajtim të ujërave të zeza – impianti për trajtim të ujërave të zeza në Ranillug si dhe kolektorët nga qendrat sekondare-qendrat bazike (skaj lumit) në drejtim të Ranillugut (Dheu i Bardhë);

**O13.5** Krijimi i rrjetit të kanalizimit atmosferik tek 10% e ekonomive familjare në komunë

**Energjia elektrike**

Rrjeti i energjisë elektrike në komunë është mjaft i vjetërsuar. Shumica e ekonomive familjare kanë qasje në rrjet përmes kabllove mbitokësore, që shfaqin rrezik permanent për qytetarët. Duke marr parasysh krizën globale të energjisë dhe rritjen e çmimeve duhet të shqyrtohen mundësitë e shfrytëzimit të burimeve alternative të energjisë, prodhuar nga uji, dielli dhe erërat. Komuna synon që të adresojë këto çështje përmes qëllimeve dhe objektivave në vijim.

**Qëllimi 14: Modernizimi i rrjetit të energjisë elektrike**

**O14.1** Shtrirja nëntokësore e rrjetit elektrik, 50% të zonës urbane deri në vitin 2031;

**O14.2** Rritja e eficiencës energjetike në objektet publike për 80% dhe për 50% te ekonomive familjare deri me 2031.

**Mbeturinat**

Pjesa dërmuese e ekonomive familjare në Kamenicë, 72% kanë qasje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave. Mirëpo, aktivitetet për ndarje të mbeturinave në burim dhe

riciklim si parakusht për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që shkojnë në deponi, ende mungojnë. Qëllimet dhe objektivat në vijim synojnë që të adresojnë këtë çështje.

**Qëllimi 15:** Zvogëlimi i sasisë së mbeturinave që shkojnë në deponi

**O15.1** Mbulimi i 90 % të ekonomive familjare me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave deri në vitin 2031.

**O15.2** Ndarja e mbeturinave në burim për 30% të ekonomive familjare

**O15.3** Zvogëlimi i sasisë së mbeturinave për 20% që shkojnë në deponi deri në vitin 2031 - aplikimi i 3R ( reduktim, ripërdorim, reciklim).

**O15.4** Trajtimi i mbeturinave inerte

### 2.3. Koncepti i zhvillimit hapësinor

Hartimi i koncepti i zhvillimit hapësinor është zhvilluar duke marrë parasysh sfidat dhe kërkesat për të ardhmen, si dhe qëllimet dhe objektivat e përcaktuara nga EKP, EKK, si dhe palët e përfshira në hartimin e PZHK-së.

Koncepti i përgjithshëm i zhvillimit hapësinor të komunës së Kamenicës bazohet në asetet e saja, si pozita gjeografike, resurset natyrore, dhe mundësitë reale të zhvillimit ekonomik, turistik, përfshi edhe infrastrukturën. Planifikimi i zhvillimit bazuar në këto asete, mundëson zbatimin e vizionit përmes qëllimeve dhe objektivave të planit duke promovuar zhvillim të balancuar hapësinorë të komunës.

Komuna e Kamenicës ka tokë të mjaftueshme bujqësore kualitative, dhe bujqësia konsiderohet si veprimtari tradicionale e popullatës. Në këtë kontekst, bujqësia paraqet potencial të rëndësishëm zhvillimor për komunën. Zhvillimi i bujqësisë intensive, në veçanti pemëtarisë, perimtarisë, bimëve mjekuese dhe blegtorisë, do të jenë nxitëse të themelimit të kapaciteteve të ndryshme përpunuese. Ky zhvillim mbështetet në avancimin e strukturës agrare, aseteve fizike dhe pajisjeve teknike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, zhvillimin e bizneseve dhe edukimin e prodhuesve bujqësorë për prodhimin organik.

Fushë tjetër e zhvillimit është turizmi si sektor prioritar – turizëm rural dhe malor, turizëm të mirëqenies dhe rekreacionit. Zhvillimi i turizimit nënkupton mbrojtje dhe ruajtjen e mjedisit dhe aseteve të shumta të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të komunës. Theks të veçantë do t’i kushtohet zhvillimit të paketës së përgjithshme turistike, duke e mbështetë me ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe aktiviteteve përcjellëse, të cilat do të tërheqin vizitorë gjatë tërë vitit.

Në kontekst të zhvillimit të turizmit dhe shërbimeve tjera (përpunim të drurit) Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) konsiderohet t'i japin shtytje sektorit të punësimit në komunë. Shërbimet në turizëm si hoteleri, tregti, transport, veprimtaritë e zanateve dhe sektori i përpunimit të drurit janë gjeneratorët e vendeve të reja të punës.

Për veprimtaritë prodhuese do të sigurohet hapësira e nevojshme për zhvillim në kuadër të zonave ekzistuese dhe zonave të reja të planifikuara për këtë qëllim.

Zhvillimi i shërbimeve si sektor terciar në fushën e ekonomisë duhet të intensifikohet dhe të diversifikohet në përputhje me funksionet e qendrat sekondare-qendrat bazike në rrjetin e vendbanimeve. Për më shumë, ngritja e cilësisë së shërbimeve publike - arsim, shëndetësi, kulturë etj., do të ndikon në zvogëlimin e migrimit të popullatës nga zonat rurale. Kjo do të mundësojë shpërndarje më të balancuar të popullsisë në territorin e komunës dhe do të përmirësoj lidhjet funksionale ndërmjet qytetit dhe fshatrave.

Zhvillimi i infrastrukturës së re teknike dhe përmirësimi i asaj ekzistuese është i një rëndësie të veçantë për zhvillimin e ardhshëm hapësinor të komunës. Kjo nënkupton zgjerimin dhe përmirësimin e rrjetit rrugor dhe shërbimeve të transportit; zgjerimin dhe përmirësimin e sistemeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe për kullimin e ujërave atmosferikë; ndërtimi i infrastrukturës për ruajtje të ujit – digës së ujit në komunën e Kamenicës; dhe rehabilitimin dhe zgjerimin e sistemeve të ujitjes.

Bazuar në karakterin rural të komunës, qytetit i Kamenicës do të ofrojë hapësira të mirëfillta publike. Intensiteti relativisht i ulët i zhvillimit në sektor të banimit duhet të konsiderohet si përparësi në krijim të hapësirave të reja publike për të rritur kualitetin e jetës së qytetarëve të Kamenicës.

### 2.3.1. Zhvillimet sipas sektorëve

- **Infrastruktura publike dhe sociale**

Element kyq i përmirësimit të cilësisë jetës së qytetarëve është edhe zhvillimi i sistemit të infrastrukturës publike duke siguruar ngritje të nivelit të shërbimeve publike dhe sociale.

Institucionet arsimore – theksohet nevoja për përmirësime në kapacitete dhe cilësi.

Në nivelin parafillor, planifikohen edhe 2 institucione të reja edhe atë në: Koretin dhe Rogoçicë. Zhvillimi i mëtejmë i rrjetit të institucioneve parafillore në vendbanimet tjera do të bëhet sipas nevojave të identifikuara, duke priorietizuar shfrytëzimin e objekteve ekzistuese shkollore te pa shfrytëzuara.

Në nivel të shkollimit fillor nuk parashihet ndërtimi i objekteve të reja shkollore por vetëm renovime te objekteve ekzistuese sipas nevojës qe paraqitet.

Institucionet shëndetësore dhe të përkujdesjes sociale – rritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore do të jetë prioritet. Shtrirja e shërbimeve shëndetësore do të bëhet përmes rrjetit aktual të institucioneve shëndetësore. Me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së së shërbimeve cilësore, institucionet shëndetësore do të përkrahen përmes sigurimit të pajisjeve dhe materialeve të nevojshme shëndetësore. Të gjitha qendrat shëndetësore do të pajisen me pajisje mjekësore varësisht nga nevoja dhe shërbimet që duhet të kryejnë.

Në të gjitha QMF-të dhe AMF-të në zonat rurale do të sigurohet numër i mjaftueshëm i mjekëve dhe personelit tjetër shëndetësor në mënyrë që të ofrohen shërbimet të rregullta shëndetësore.

Institucionet e kulturës dhe sportit - zhvillimi i kulturës do të bëhet përmes rrjetit ekzistues të ndërtesave të kulturës, si dhe ndërtesave shkollore si dhe përmes ndërtimit te objekteve dhe hapësirave te reja sportive. Qeverisja komunale duhet të bashkëpunoj me shoqërinë civile dhe qytetarët dhe të vazhdojnë dhe zgjerojnë më tej mbështetjen për zhvillimin e aktiviteteve dhe ngjarjeve kulturore. Objektet sportive në qytet Kamenicë si dhe rrjeti i përhapur i institucioneve shkollore, ofrojnë një strukturë të mirë për zgjerimin e mëtejmë të rrjetit të hapësirave të sportit. Me qëllim të përmirësimit të kushteve për shfrytëzimin e këtyre ndërtesave, është e nevojshme të rregullohet qasja dhe hapësirat përreth tyre. Ndërkaq stadiumi i qytetit ka nevojë për përmirësim të kushteve edhe brenda tij. Për hapësira sportive në zonat rurale, do të shfrytëzohen kapacitetet ekzistuese dhe ato të planifikuara në kuadër të shkollave, si dhe përmes ndërtimit të objekteve dhe hapësirave të reja sportive, në Hogosht, Novosellë, etj.

Hapësirat Publike - duhet të nxitet përdorimi i shumëfishtë i parqeve dhe hapësirave të hapura publike midis një shumëllojshmërie të grupeve të shfrytëzimit dhe aktivitetet e përdoruesve. Qeverisja komunale duhet të menaxhojë me kualitetin e hapësirat publike në mënyrë që të sigurojë që ato të jenë tërheqëse dhe të sigurta për të gjithë shfrytëzuesit. Sigurimi i hapësirave të hapura dhe zonave të parkut që janë funksionale dhe efektive në plotësimin e nevojat të banorëve dhe vizitorëve. Zonat e reja, lagjet e qendrës urbane që planifikohen të zhvillohen duhet të kenë hapësira të mjaftueshme për hapësira publike në mënyrë që të ju sigurohet qasja në hapësirë publike të gjithë banorëve. Çdo banor duhet të ketë qasje në hapësira publike në largësi jo më shumë së 500 metra apo 15 minuta ecje në këmbë. Hapësira e ndërtuar duhet të respektojë udhëzimet nga U.A. për Normat teknike të planifikimit hapësinor, MMPH nr.08/2017(shtojcë, kapitulli IV). Hapësirat e gjelbra në pronësi të shkollave duhet të krijohet mundësia e bashkëpunimit dhe të rregullojë hapësirat që mund të shfrytëzohen nga komuniteti jashtë orarit shkollor dhe gjatë pushimeve sezonale. Kryesisht mund të bëhen kënde të vogla lojërash apo hapësira sportive, me orar të caktuar në shërbim të komunitetit.

- **Ekonomia**

Komuna e Kamenicës duhet të shfrytëzoj përparësitë e saja krahasuese dhe potencialin zhvillimor duke revitalizuar sektorë konkurrentë dhe zhvillimi i një infrastrukture ekonomike efikase. Domosdoshmërisht, kjo të ndërlidhet me politika lokale proaktive për tërheqjen e banorëve dhe investitorëve, promovimin e shfrytëzimit të qëndrueshëm të mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarit.

Bujqësia – është njëra ndër sektorët më të rëndësishëm në Kosovë, bujqësia luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë vendore si dhe mund të ndikojë në zbutjen e

papunësisë, në sigurinë ushqimore duke përmirësuar mirëqenien qytetare dhe në uljen e importit të atyre produkteve agro - ushqimore të cilat mund të prodhohen në parcelat tona të pashfrytëzuara plotësisht. Veprimet ne këtë sektor duhet të ngrisin rendimentet në të gjitha llojet e produkteve bujqësore, siç janë pemëtaria, perimtaria, lavërtaria dhe mbarështimi i gjedhëve, të cilat janë bazë për zhvillimin e agroindustrisë. Më tutje, të stimulohet diversifikimi i produkteve dhe eliminimi i karakterit stinor të prodhimtarisë. Me intensifikimin e prodhimit bujqësor është e nevojshme sigurimi i ujitjes të vazhdueshme të tokave, në këtë mënyrë rrjeti ekzistues i kanaleve të ujitjes duhet të rindërtohet dhe zgjerohet me aplikimin e sisteme të avancuara të ujitjes.

Duhet te inkurajohet grupimi i parcelave bujqësore, aplikimi i masave agroteknike, ujitja, ngritja e kapaciteteve të magazinimit dhe përpunimit të produkteve; ngritja e fermave të reja dhe kapaciteteve të vogla përpunuese të qumështit dhe mishit. Të stimulohen rritja e madhësisë së njësive bujqësore si arat, kopshtet dhe fermat, si dhe prodhimet bujqësore lokale do te kenë në shfrytëzim pikat grumbulluese ne lokacionet Hogosht, Shipashnicë, Myçiverc, Rogaçicë, Topanicë, Koretin, Kamenicë, Strezoc, etj, potencialisht te organizuara ne forma te strukturave kooperative. Nga intervenimet e lehta, duhet te promovohen trajnime specifike për zhvillim profesional te bujqësisë duke synuar ngritjen e produktivitetit si dhe për trajtimin e duhur me substanca agro-kimike me qëllim të mbrojtjes së tokës bujqësore.

Blegtoria – veprimet që ndërmerren duhet të promovojnë lëvizjet drejt komercializimit, që nënkupton kalimi nga sistemi i ekonomive të vogla "fermeri" në atë të mesëm (ferma komerciale). Ekonomitë e vogla "fermeri" do të vazhdojnë të ekzistojnë kryesisht nëpër fshatra të larta. Fermat komerciale (25 - 50 lopë qumështore, 30 - 60 ha) do të zhvillohen në ultësirat më pjellore. Zhvillimi i kësaj situate do të nxitet nga zhvillimi i industrisë së qumështit dhe mishit si dhe industrisë së përpunimit të ushqimit të kafshëve.

Pylltaria – masat e parapara kanë të bëjnë me shfrytëzim të planifikuar, të qëndrueshëm të pyjeve si: pyllëzimi i zonave erozive, përmirësimi i gjendjes aktuale të pyjeve, pastrimi i pyjeve dhe shfrytëzimi i hashklave drusore (biomases) për energji termike (ngrohje qendrore), shndërrimi i cungishtave në pyje të larta, etj.

Zhvillimi i industrisë dhe NVM-ve – masat që ndërmerren duhet të krijojnë kushte për zhvillim të prodhimtarisë nga resurset ujore, sektorit të ndërtimtarisë, industria e përpunimit të drurit dhe agrobiznesit. Burime ujore me potencial shfrytëzimi ne lokacionet si; Hogoshti, Gjyrisheci, Poliqka, Vriqeci, Tugjeci, Zajqeci, Gmica, Grizime dhe Tërstena. Zhvillimi i NVM-ve nënkupton edhe rritjen e bashkëpunimit komunë-biznese për ndërtimin e partneriteteve publiko-private dhe masat si përkrahja e NVM-ve të reja përmes garantëve, subvencioneve dhe lehtësirave tjera; mbështetjen e procesit të edukimit adekuat të fuqisë punëtore, në veçanti në fushat strategjike për komunën si turizmi dhe bujqësia. Gjithashtu, edhe të fuqizohet komunikimi i vazhdueshëm me bizneset për identifikimin e nevojave të tyre për profile të caktuara të punëtorëve dhe të fasilitojë organizimin e punës praktike për nxënësit e shkollave profesionale në

ndërmarrje të ndryshme. Qeverisja komunale duhet te siguroj investitorët potencial për lehtësimin e qasjes në lokacion, dhënia e pëlqimit për plotësimin e kushteve mjedisore, dhënia e lejes së punës, caktimi i tatimeve dhe ngarkesave, dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e tokës bujqësore, caktimi i qirasë për objektet komunale, përmirësimi i infrastrukturës e të ngjashme. Paralelisht, përkrahja duhet të intensifikohet për rrjetet përkrahës për zhvillimin e bizneseve si Zyra Rajonale për Zhvillim të Bizneseve, OEK - rajonale dhe Shoqata e Biznesit, etj, apo shoqatat tjera profesionale, si ajo e zejtarëve, blegtorëve, ekonomistëve, juristëve etj.

Turizmi – resurset spektakolare natyrore qe posedon komuna janë përcaktuese që turizmi të jetë një segment i rëndësishëm i zhvillimit. Ne këtë kontekst, llojllojshmëria e aseteve turistike është në harmoni me interesin e vizitorëve vendorë dhe të huaj për zhvillim të aktiviteteve të: turizmit malor, atij dimëror dhe veror, pastaj turizmit rekreativ-sportiv, turizmit kulturor, etj.

Zhvillimi i turizmit rekreativ dominon në pjesën veriore të komunës. Në vazhdimësi, aktiviteti turistik duhet të stimuloj zhvillimin e aktiviteteve ekonomike tjera siç janë bujqësia, NMV-të, infrastruktura publike dhe sociale, etj. Si lokacione me potencial për zhvillim te turizmit spikaten Kika (Poliqkë) Pllanica (krenidell), Lugu i verdhe (Busavate dhe Ruboc), Feriqeja, Tugjeci, etj.

- **Vendbanimet**

Qyteti i Kamenicës duhet të vazhdojë te jetë qendër kryesore komunale për banim dhe aktivitete komerciale dhe sociale. Infrastruktura me e rëndësishme edukative, kulturore, sportive dhe shëndetësore do te përqendrohet ne qytetin e Kamenicës. Përderisa vendbanimet tjera përreth duhet te krijojnë lidhje te qëndrueshme me qytetin dhe furnizim reciprok te infrastrukturës sociale. Kjo ndërlidhje ndërmjet qytetit të Kamenicës dhe vendbanimeve tjera, duhet te trajtohet me kujdes qe te mos krijohen gryka te ngushta të transportit. Më tutje, klasifikimi i vendbanimeve sipas normave të planifikimit në të ardhmen është projektuar si më poshtë:

| Klasifikimi | Klasifikimi sipas KHRP | Vendbanimet | Nr. |
|---|---|---|---|
| Vendbanim shumë i vogël urban (5,000-10,000 banorë) | Qendër e rendit të lartë | Kamenicë | 1 |
| Vendbanime te mëdha rurale (2,500-5,000 banorë) | Qendër e rendit të mesëm | Koretin, Rogaçiçë | 2 |
| Vendbanim i mesëm i madh rural (1,000-2,500 | Qendër e rendit të ultë | Berivojcë, Hodonoc, Hogosht, Karaqeve e Eperme, Kopernicë, Muçiverc, Petroc, Shipashnice e Eperme, Topanicë | 9 |

| Klasifikimi | Klasifikimi sipas KHRP | Vendbanimet | Nr. |
|---|---|---|---|
| banorë) | | | |
| Vendbanim i mesëm i vogël rural (500-1,000 banorë) | Qendër bazike | Busavatë, Karaqeve e Poshtme, Krileve, Shipashnice e Poshtme | 4 |
| Vendbanim i vogël rural (200-500 banorë) | Qendër bazike | Bllatë, Bosce, Bratilloc, Dajkoc, Dazhnicë Desivojcë, Firiqejë, Gmicë, Gogolloc, Graxhenik, Grizime, Gjyrishec, Hajnoc, Kolloleq, Kostandincë, Kranidell, Kremenatë I, Kremenatë II, Lajçiq, Leshtar, Lisockë, Marocë, Meshinë, Moçar, Novosellë, Poliçkë, Qarakoc, Rahovicë, Ruboc, Sedllar, Strelicë, Strezoc, Svircë, Shahiq, Terstenë, Tugjec, Vaganesh, Velegllavë e Epërme, Velegllavë e Poshtme, Vriqec, Zajçec, Zhujë | 42 |

Akomodimi i zhvillimeve të ardhshme – vendbanimet duhet te dendësohen duke shfrytëzuar tokat në mënyrë sa më racionale. Zhvillimi policentrik i skenarit të përzgjedhur fokusohet fillimisht në konsolidimin e infrastrukturës ekzistuese, ri-zhvillimit të hapësirave ekzistuese te ndërtuara si dhe plotësim te hapësirës se pa ndërtuar.

Sipas organizimit aktual të vendbanimeve dhe shtrirjen e tyre të gjerë, kufijtë e zonës së ndërtimit do të përmbledhin ndërtimet ekzistuese përmes së cilës qasje do të krijohet hapësirë e ndërtimit të mjaftueshëm përtej kornizës së planifikimit. Përmes kësaj qasje, tek të gjitha vendbanimet do të këtë kryesisht plotësim dhe densifikim, përderisa rritja potenciale e hapësirës së ndërtimit do të jetë rezultat direkt i gjendjes ekzistuese te zhvillimit linear apo të copëzuar, dhe me këtë qellim të kompaktësohen vendbanimet.

Nuk do te lejohet zgjerimi apo ndryshimi i mëtejmë të vendbanimeve jashtë kufijve te ndërtimit të përcaktuar me këtë plan.

**Shfrytëzimi i tokës** – plani e ka për obligim sigurimin e tokës së nevojshme ndërtimore për qëllime banimi, sociale, publike, biznese dhe industri. Ne këtë fryme, plani promovon shfrytëzimin racional të tokës, pra dendësim dhe plotësimin e zonave të ndërtuara. Me hollësisht do të përcaktohet në hartën zonale të komunës (HZK) dhe me planet rregulluese të hollësishme (PRrH) për zonat për të cilat do të hartohen ato plane. HZK do të përcaktojë saktësisht dendësinë për çdo lagje të zonës urbane dhe rurale.

Banimi - në qytetin e Kamenicës do të rritet dendësia e banimit por edhe rregullohet infrastruktura përcjellëse publike. Qeverisja komunale duhet të krijojë fondin për banim në mënyrë që të ofrojë zgjidhje për strehim për të gjitha grupet e shoqërisë që kanë nevojë si dhe të lehtësojë menaxhimin/administrimin e ndërtesave ekzistuese në bashkëpronësi. Qeverisja komunale duhet të sigurojë nga numri i përgjithshëm i njësive

të reja të banimit për vit, minimum 5% të jenë me çmim të përballueshëm. Ky veprim do të mundësojë që familjet e reja të kenë qasje në njësi banimi me çmim të përballueshëm, duke adresuar kërkesat për banim në mënyrë të kontrolluar. Këtij synimi duhet t'i paraprijë hartimi i strategjisë lokale për banim të përballueshëm dhe për banim social si dhe rregullore komunale.

Duke patur parasyshë që ka një tendencë në rritje që qytetarët, të cilët janë shpërngulur më herët nga malësia e Kamenicës në drejtim të komunave tjera të R. së Kosovës por edhe në diasporë, të kthehen të investojnë në ndërtim të njësive akomoduese, si dhe shtëpive të pushimit, pra në zhvillim të turizmit rural e malor, sidomos në pjesët ku aktualisht po investohet në infrastrukturën rrugore, disa lokacione në Malësinë e Komunës së Kamenicës, janë destinuar si hapësirë për banim. Arsyeja është sepse kjo zonë është në kufi me shtetin fqinjë, Serbinë, dhe rrjedhimisht ideja ka qenë që t'u ofrohet mundësi qytetarëve tanë të ndërtojnë në këtë zonë. Për më shumë, kjo zonë ka mundësi të mëdha të zhvillimit të turizmit rural dhe malor, dhe duke marr parasysh këtë potencial komuna e Kamencës vetëm se ka filluar ndërtimin dhe asfaltimin e rrugëve të brezit kufitar në fshatrat: Sfircë, Shahiq, Zhujë, Polickë, Vriqec, Velegllavë, Tërstenë, Desivojcë, Sedllarë, Krenidell, Krilevë dhe Zajqec. Si rrjedhojë e këtyre mundësive dhe zhvillimeve të fundit në fshatrat e cekura më lartë, në malësi janë planifikuar hapësirat për banim, për zhvillim të turizimit rural e malor, siç janë paraqitur në hartën e shfrytëzimit të tokës nr. 34.

- **Infrastruktura e transportit dhe transporti**

Komuna duhet të avancojë lëvizshmërinë në kuptim të lehtësimit të lëvizjes motorike, mundësimit të lëvizjes jo-motorike dhe rritjes së sigurisë për të siguruar zhvillim më të qëndrueshëm dhe rritje ekonomike.

Rrjeti rrugor - Komuna duhet të siguroj planifikimin dhe konsolidimin e rrjetit rrugor ekzistues nëpër vendbanime, me qëllim të krijimit të rrjeteve funksionale të qarkullimit. Në rrugën nacionale duhet të sigurohet lëvizja e banorëve përmes rregullimit të trotuareve, sidomos në segmentet që kalojnë përmes vendbanimeve, me qëllim të ofrimit të kushteve për lëvizje të sigurt të këmbësorëve. Po ashtu, do të aplikohen masa për menaxhimin e shpejtësisë së qarkullimit motorik, me qëllim të uljes së rrezikut në trafik. Të gjitha rrugët në vendbanime duhet të pajisen me trotuare, dhe në hapësirat rurale ato duhet të plotësohen me trotuare së paku në një anë të rrugës. Përveç trotuareve, rrugët kryesore duhet të pajisen me shteg të biçikletave dhe brez të gjelbërimit të ulët dhe të lartë. Gjelbërimi i lartë përgjatë rrugës është i domosdoshëm për ofrimin e hijes gjatë ecjes, pastrimit të ajrit si dhe zvogëlimit të zhurmës. Për të ofruar siguri të plotë të qarkullimit në trafik, do të ndërmerren masa si aplikimi i brezit të gjelbër i cili ndikon në uljen e shpejtësisë së qarkullimit motorik dhe kufizim për të gjitha rrugët residenciale ne maximum 25kmh.

Transporti publik - përderisa brenda vendbanimeve duhet të i jepet përparësi lëvizjes (transportit) të shëndetshëm i cili realizohet përmes ecjes dhe biçikletave, si dhe plotësimit me transport publik. Jashtë vendbanimeve duhet të jepet përparësi zhvillimit te transportit publik. Të gjitha vendbanimet duhet të përfshihen me transport publik dhe

të ofrohet transporti peri-urban pas orës 19:00 dhe gjatë pushimit veror të nxënësve. Vendet e ndalesave të autobusëve duhet të ndërtohen ashtu që të ofrojnë strehim nga kushtet atmosferike, vend për ulje dhe për vendosjen e orarit të operimit.

Transporti i pa-motorizuar, këmbësorë dhe biçikleta – shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta, dhe hapësirat publike duhet të jenë në harmoni me konceptin e transportit të qëndrueshëm. Të gjitha intervenimet në transport do të marrin parasysh kërkesat për persona me aftësi të veçanta.

- **Infrastruktura teknike**

Vlen te theksohet qe kapacitetet e Infrastrukturës teknike që përfshinë infrastrukturën rrugore, rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet nëntokësore dhe mbitokësore për furnizimin e energjisë elektrike, telekomunikacionit dhe instalimeve të tjera të ngjashme, duhet te harmonizohen me planifikimin e banimit dhe duhet të mbështesin zhvillimin ekonomik të komunës.

Ujësjellësi – duhet të kryhet hulumtimi për kapacitete të shtesë të burimeve ujore me qellim që ujësjellësi të mundësoj sigurimin e furnizimit me ujë për të gjitha vendbanimet, si dhe të mbuloj kapacitetet që nevojiten për zhvillimin e veprimtarive ekonomike. Sisteme te reja të ujësjellësit të aplikohen aty ku nuk ka ujësjellës fare, përderisa në vendbanime ku ka vështirësi në furnizim, do të bëhet funksionalizimi i këtyre sistemeve. Me intensitet te lartë duhet të punohet drejt rregullimit dhe zëvendësimit të rrjetit te vjetruar të ujësjellësit dhe eliminimit te kyçjeve ilegale. Gjithashtu, gradualisht duhet te eliminohen furnizimi me ujë nga bunarët e cektë dhe të pambrojtur.

Kanalizimi - vendbanimet do të përfshihen me sisteme përkatëse për menaxhimin dhe shkarkimin e tyre. Përderisa ne qytet të Kamenicës si dhe vendbanimet Berivojcë, Ruboc, Koretin dhe Topanice do të bëhet kompletimi i sistemeve ekzistuese, projekte të kanalizimit nevojiten në tërë vendbanimet tjera. Të gjitha vendbanimet duhet të pajisen me rrjet kanalizimi qe bën trajtimin mekanik dhe fizik, duke eliminuar gradualisht prezencën e gropave septike.

Planifikimi i kanalizimit duhet të orientoj të gjithë gypat e kanalizimit duhet do të jenë në drejtim të rrugës kryesore pasi që kolektori kryesor do të jetë në këtë drejtim. Secila rrugë duhet të ketë gypin e vetë të kanalizimit fekal dhe atmosferik dhe kahja e tyre do të caktohet varësisht nga konfiguracioni i terrenit. Kolektorët do të zbatohen në rrjedhë të lumenjve nga nën qendrat komunale në drejtim të Ranillugut (Dheu i Bardhë), ndërsa impianti për trajtim të ujerave të zeza do të shfrytëzohet ai që planifikohet të ndërtohet në Ranillug. Kanalizimi atmosferik duhet të shpërndahet në te gjitha vendbanimet e komunës. Menaxhimi i ujërave atmosferik do të bëhet përmes sanimit të sistemeve ekzistuese në qytetin e Kamenicës, si dhe ndërtimit të sistemeve të hapura përgjatë rrugëve ku ato mungojnë. Duhet te ndahet plotësisht nga rrjeti i kanalizimit, si dhe trajtimi i tij duhet te përfshijë filtrim dhe ruajtje (neper rezervuare) ne mënyrë qe te

zvogëlohet ngarkimi i zonave te banimit, biznesi dhe industriale gjate sezonës se reshjeve.

Ujitja - Furnizimi për ujitjen e tokave do të bëhet përmes akumulacioneve ekzistuese ujore afër fshatrave Hogosht, si dhe akumulacioneve të reja afër fshatrave Desivojcë, (në plan afatmesëm) dhe Gjyrishec, Kremenatë (në plan afatgjatë), përderisa bartja e ujit deri në toka bujqësore do të bëhet përmes sistemeve të ujitjes, siç është kanali i ujitjes në Muçiverc.

Furnizimi me energji elektrike – masat për rritjen e efiçiencës energjetike duhet te kenë prioritet me qëllim të mbështetjes së një furnizimi cilësor me energji, si dhe shfrytëzim racional të saj. Në kuadër të ndërtesave dhe hapësirave publike, rritja e efiçiencës bëhet përmes aplikimit të masave konkrete teknike. Ndërkaq në shkallë më të gjerë, planifikon të aplikojë masa për vetëdijesimin e qytetarëve për rëndësinë dhe përfitimet nga efiçienca energjetike, sidomos në objektet e banimit. Në kuadër të ndërtesave dhe hapësirave publike, rritja e efiçiencës duhet të bëhet përmes aplikimit të masave efiçiente. Ndërkaq, nga masat e buta duhet të aplikohen masa për vetëdijesim rreth rëndësisë dhe përfitimeve ekonomike nga efiçienca energjetike. Duhet të shpërndahet rrjeti i ndriçimit publik për të gjitha rrugët e lagjeve duke shfrytëzuar llamba ekonomike LED.

Duhet të zvogëlohen emetimete $CO_2$ duke aplikuar prodhim të energjisë së ripërtërishme dhe duke bërë përmirësimin e efiçencës energjetike përmes aplikimit të teknologjive moderne që shfrytëzohen për prodhimin e energjisë përmes; biomasës, energjisë solare, energjisë me erë, energjisë së kombinuar dhe përmes stimulimeve për sektorin privat që të investojnë në objekte e pajisje të tilla.

Menaxhimi i mbeturinave – prioritet duhet të jetë zgjerimi i shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave për tërë territorin e komunës si dhe eliminimi i vazhdueshëm i deponive ilegale. Duhet t'i jepet prioritet aktiviteteve të reduktimit, minimizimit dhe procesimit të mbeturinave karshi deponimit të tyre. Ndër masat e buta, kërkohet të vijojnë fushata vetëdijesimi dhe masa për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që hedhen, duke zbatuar projekte të klasifikimit të mbeturinave dhe përkrahja e bizneseve të riciklimit dhe kompostimit të mbetjeve organike.

### 2.3.2. Skenarët e propozuar

Koncepti i zhvillimit hapësinor është hartuar bazuar në skenarët për zhvillim. Skenarët janë mjet që shërbejnë për të vizuelizuar dhe analizuar rezultatet e së ardhmes të cilat janë rezultat i vendimeve të tanishme. Për më shumë skenarët "një shikim i njëtrajtshëm i asaj çfarë e ardhmja mund të jetë – dhe jo parashikim, mirëpo vetëm çfarë rezultati i mundshëm mund të jetë (Porter 1985)".

Në këtë kontekst analiza e skenarëve shërben për të menduar se cilat janë implikimet hapësinore bazuar në zhvillimet e propozuara. Hartimi dhe vlerësimi i skenarëve është punuar duke përdorur të dhëna nga gjendja ekzistuese, kërkesat për të ardhmen dhe potencialet e komunës për zhvillim.

Komuna e Kamenicës është duke ndërtuar zhvillimin e saj mbi potencialet e saja natyrore dhe të krijuara për zhvillim të mirëfilltë: natyra, toka bujqësore, bizneset dhe industria. Duke u bazuar në trendët e kaluar të zhvillimit dhe gjendjes së tashme urbane dhe hapësinore në komunë, janë analizuar dy skenarë të zhvillimit.

- Skenari Zero: vazhdim i zhvillimeve sipas trendit të deritanishëm
- Skenari A: Zhvillimi i Qëndrueshëm Policentrik me nën qendrat: Rogoqice, Hogosht, Strezovc dhe Topanicë

**Skenari Zero – vazhdim i zhvillimeve sipas trendit të deritanishëm**

Skenari zero apo skenari i trendit ekzistues te zhvillimit paraqet vendimin që të ndiqet ritmi i njëjtë, pra i deritanishëm i zhvillimit. Duke ndjekur ne tërësi trendet e zhvillimeve ne Kamenicë, mundësohet rritjen graduale te dendësisë se banimit në qytet si dhe shpërndarjen e ambienteve te ndërtuara në pjesë periferike, gjithmonë duke pas parasysh trendin e ngadalshëm qe ka dominuar viteve te fundit. Përderisa, qëllimi kyq i planifikimit është të i prijë dhe të orientoj zhvillimet, skenari zero mundëson të ndodhë e kundërta, trendi do të vazhdoj ku zhvillimet ndodhin dhe planifikimi pason.

Skenari zero mundëson që zhvillimet të shpërndahen pa planifikim adekuat, një pjesë më e madhe e zhvillimeve realizohet në parcela te reja të ndërtimit, rrjedhimisht rriten kërkesat për investime ne infrastrukture rrugore, rriten varësia ne transport individual në vetura personale. Skenari zero vazhdon ne krijimin e një strukture qyteti që është e kushtueshme për të shërbyer, jo e qëndrueshme. Krijohen kushte për rritjen e shpenzimeve buxhetore në infrastrukture te re publike dhe sociale. Jo domosdoshmërish duke krijuar lagje te qëndrueshme me banore rezident, por duke mbajt fokusin ne qëllimet ekonomike te ndërtueseve dhe investitorë apo blerës potencial te njësive te banimit. Nuk do të ketë ndonjë përmirësim të dukshëm ne mundësitë qe ofrohen për shfrytëzim të hapësirave publike të hapura. Tokat e pëlleshme vazhdon të menaxhohet pa koordinim, përderisa bujqësia vazhdon të subvencionohet me nisma nga niveli qendror dhe lokal, jo domosdoshmerishte nisma qe ndërlidhen apo specializohet në cilësi. Skenari zero dështon në sigurimin e mundësive për banim e shërbime cilësore si dhe ekonomi të qëndrueshme, ne përgjithësi dështon ta vendos qytetarin në qendër të vëmendjes.

Ne anët pozitive, vlen te theksohet qe qasja e pakontrolluar nga ky skenar ofron mundësi të mira për ndërtim dhe është më i lehtë për t'u zbatuar, kërkon më pak planifikim dhe menaxhim, dhe është më pak kompleks.

| Përparësitë | Mangësitë |
| --- | --- |
| • Kosto e ulet ne afat shkurt<br>• Menaxhimi zhvillimeve me resurse te limituara<br>• Potencial për shpërndarja të infrastrukturës baze: teknike dhe sociale përgjatë territorit te komunës<br>• Lidhjet rrugore në ne mes te fshatrave dhe qytetit Kamenicë<br>• Potencial zhvillimi për sektorin privat, duke ju mundësuar zhvillimin spontan dhe shtrirje ne tërë territorin komunal<br>• Procese zhvillimore te adaptuara ne sistem dhe menaxhimi i zhvillimeve vazhdohet me lehtësi | • Degradim i rrezikshëm i hapësirave të banueshme dhe resurseve natyrore<br>• Zbrazja fshatrave<br>• Zgjerimi i mëtejmë i zhvillimeve kryesisht në tokën bujqësore<br>• Rritja e varësisë ne mjete personale motorike dhe rritja e kostos ne transport (kohore dhe financiare)<br>• Rënie e cilësisë se shërbimeve nga shërbime publike<br>• Humbja potenciale e fondeve zhvillimore te gjelbra<br>• Krijimi i hapësirave/lagjeve pa banor resident, si barrë për shërbimet publike si dhe rrezik social |

Në përmbledhje, me ecurinë e skenarit zero ka pakënaqesi nga të gjitha shtresat e shoqërisë, dhe ky skenar nuk reflekton kërkesat nga deklarata e vizionit si dhe qëllimet dhe objektivat. Duke konsideruar vlerësimet e dhëna për skenarin zero, vlerësohet qe ky skenari zero nuk është i përshtatshëm për zhvillim më tutje.

**Skenari A – Zhvillimi i Qëndrueshëm Policentrik me nën qendrat – qendrat sekondare – qendrat bazike: Rogoqice, Hogosht, Strezovc dhe Topanicë**

Pas analizave ekonomike, mjedisore dhe sociale, si dhe ato politike qe prekin shoqërinë tonë, është vendos të përcillet skenari A, si bazë e mundshme të zhvillimit hapësinorë të Kamenicës. Duhet u bërë zhvillimi i vendbanimeve me konceptin e zhvillimit hapësinor policentrik me tri segmente lineare, sic janë renditur me poshtë:

- Segmenti i parë Kamenicë -Rogaqicë
- Segmenti i dytë Kamenicë – Hogosht
- Segmenti i tretë Kamenicë – Strezoc.




Skenari A – Zhvillimi i Qëndrueshëm Policentrik me nën-qendrat: Rogoqicë, Hogosht, Strezovc dhe Topanicë

Për plotësimin e rrjetës urbane të vendbanimeve me funksione dhe përmbajtje dhe për një zhvillim më të baraspeshuar hapësinor të territorit të komunës së Kamenicës, vlerësohet prioritare zhvillimi i shpejtë i qytetit të Kamenicës, Rogaqicës, Hogoshtit, Strezocit dhe disa nën – qendrave si që janë Koretini, Topanica, Hodonoci, si dhe Muqiverci, si në funksion të lidhjeve, shërbimeve, dendësimit dhe ushtrimit të funksioneve tjera plotësuese sociale, ekonomike e mjedisore.

Ky koncept i konsideruar si racional dhe efikas nga grupet punuese për zhvillim të planifikuar Komunal, si bosht të vetin orientues për arritjen e vizionit të Komunës së Kamenicës konsideron nevojën e zhvillimit të sinkronizuar. Qyteti i Kamenicës duhet te orientohet e ndërtohet me të gjitha elementet e strukturës urbane komplete. Ajo do të siguroj mënyrën urbane të jetesës, me të gjitha funksionet dhe përmbajtjet që i përgjigjen urbanizimit të qëndrueshëm, zhvillime të rëndësishme në disa pajisje dhe përmbajtje urbane duhet pritur edhe në Rogaqicë, Hogosht, Strezoc dhe Topanicë të cilat do ti përgjigjen funksionit të Kamenicës në hapësirë, komunë, regjion dhe nivel të Kosovës.

Nën qendrat – qendrat sekondare do të jenë në pozitën e vendbanimit komplementar në kuptimin se funksionet themelore të këtyre vendbanimeve plotësojnë funksionet e vendbanimeve tjera, brenda ndarjes hapësinore policentrike, ashtu që këto të sigurojnë edhe lidhjen funksionale të rregullt dhe të mirë të mbarë hapësirës brenda kësaj komune dhe rajonit.

Skenari A ofron plotësimin dhe dendësimin në zonën urbane qytetin e Kamenicës por edhe për Koretinin, Topanicën, Rogoçicën, Hogoshtin, Strezocin dhe disa vendbanime tjera. Krijon kushte për mbajtjen nën kontroll të të gjitha vendbanimeve rurale dhe qytetit Kamenicës, duke mos lejuar shtrirje të reja në funksion të mbrojtjes së tokës bujqësore. Në anën tjetër ofron edhe mundësi të rritjes së banorëve që synojnë të zhvillojnë bujqësinë dhe shërbimet komunale në vendbanime rurale dhe kontribuon në zhvillimin e bujqësisë.

| Përparësitë | Mangësitë |
|---|---|
| • Zhvillim dhe mbrojtje e tokës bujqësore<br>• Zhvillim ekonomik, social dhe mjedisor të qëndrueshëm dhe të baraspeshuar<br>• Ofrim të shërbimeve dhe mundësive sa ma afër, shpejtë dhe lirë për qytetarët<br>• Korridori zhvillimor Kamenicë-Berivojcë-Koretinin-Topanicë<br>• Integrimi i zonave zhvillimore të komunës , në pjesën veriore ku planifikohet zhvillimi kryesisht i Turizmit malor, rekreativ dhe Pylltarisë, dhe pjesës jugore ku planifikohet zhvillimi kryesisht i Banimit, Agrikulturës dhe Zhvillimit Ekonomik, me këtë koncept për Komunën e Kamenicës.<br>• Integrimin e potencialeve për prodhim të energjisë<br>• Marrja në konsideratë e mundësive nga autostrada e Gjilanit dhe rrugës së planifikuar turistike që e lidhë Kamenicën me Prishtinën dhe kalon përgjatë zonës malore në pjesën veriore. | • Kostoja financiare dhe njerëzore për menaxhim te zhvillimit të qëndrueshëm<br>• Proces kompleks i menaxhimit te zhvillimit |

Skenari A promovon qasje te integruar në mes të sektorëve të zhvillimit, infrastrukturë funksionale si dhe mjedis të qëndrueshëm dhe ndërlidhet ngushtë me deklaratën e Vizionit si dhe objektivat e qëllimet e Planit. Duke pasur parasysh faktin që ky Skenari A ka shumë më tepër përparësi në krahasim me Skenarin zero atëherë është skenar favorit i zhvillimit te Kamenicës. Skenari A do të zhvillohet më tutje edhe se nga ajo që kemi prezantuar më lart për Kamenicën është skenari kryesorë.

### 2.3.3. Elementet e konceptit

Elementet e ndërlidhura hapësinore: nyjat – banim, punësim dhe rekreacion; rrjete të infrastrukturës; hapësirat natyrore dhe korridoret për zhvillim e përbëjnë konceptin e zhvillimit. Intensiteti i lëvizjes së qytetarëve dhe shërbimeve krijojnë një hierarki nyjash dhe korridore që lidhin këto nyje, që i përkasin kategorive të ndryshme. Nyjat janë të

lidhura ndërmjet vete përmes korridoreve duke zhvilluar hapësirat përmes: plotësimit dhe dendësimit; kontrollit të zhvillimit – përcaktimi i kufirit të qytetit; mbrojtjes së resurseve natyrore dhe të trashëgimisë kulturore; ri zhvillimit të zonave ekzistuese apo zhvillimit të zonave të reja të pa ndërtuara. Elementet hapësinore paraqiten në bazë të shtresave, në të cilat elemente të ndryshme të zhvillimit vendosen njëra mbi tjetrën bazuar në karakteristikat e tyre të përbashkëta.

Koncepti i zhvillimit për komunën e Kamenicës promovon zhvillim kompakt dhe të balancuar duke vendosur kufi të qartë në mes të zonës urbane dhe rurale. Vendbanimet do të zhvillohet sipas karakterit dhe funksionit që e ushtrojnë, duke ofruar shërbime përkatëse për banorët e zonës rurale dhe vendbanime në afërsi gjeografike.

Duke marr parasysh trendin negativ të rritjes së popullsisë zona urbane do të zhvillohet në kufijtë aktual, duke ofruar hapësira për dendësim, ri zhvillim dhe zhvillim të zonave të reja. Përcaktimi i sasisë së tokës për zhvillim do të bëhet duke përfillur rritjen natyrore të popullsisë, migrimin e brendshëm dhe kërkesat e tregut.

Toka bujqësore e kualitetit të lartë në lindje do të vazhdojë të përdoret për qëllime të bujqësisë duke u mbrojtur nga çdo zhvillim i ardhshëm negativ. Në nën-qendrat Rrogaqicë, Hogosht, Muuciverce, dhe Hodonoc mund të zhvillohen kapacitete të vogla përpunuese në ferma dhe qendra për ruajtjen e produkteve bujqësore.

Lidhja e tërësive hapësinore përmes infrastrukturës dhe ofrimit të shërbimeve me asetet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore do të mundësoj ruajtjen e tyre dhe përfitim ekonomik. Zhvillimi i terësisë hapësinore të malësisë do të bazohet në turizëm të qëndrueshëm me qëllim të vetëm mbrojtjen dhe promovimin e vlerave natyrore të kësaj zone. Zona do të akomodojë zhvillim të intensitetit të ulët duke mundësuar zhvillimin e konceptit bed & breakfast. Ndërsa, destinacionet e pikave të trashëgimisë kulturore do të ndërlidhen me rrjete të infrastrukturës duke përfshi shënjëzimin duke krijuar korridor turistik.




Harta 29 Harta e Konceptit të Zhvillimit Hapësinor

### 2.3.4. Tërësitë hapësinore

Skenari i përzgjedhur promovon modelin e zhvillimit kompakt dhe të baraspeshuar, të mbështetur me zhvillimin e qëndrueshëm të tërësive hapësinore të komunës. Sistemi hierarkik i vendbanimeve do të zhvillohet më tutje me fuqizimin e qytetit të Kamenicës si pikë e rëndësishme ne rajon dhe zhvillimi intensiv i nën-qendrave si ofruese të shërbimeve publike dhe sociale për banorët e zonës rurale që gravitojnë në drejtim të tyre. Vendbanimet do te kenë kufijtë te ndërtimit dhe nuk lejohet banim i përhershëm jashtë kufijve te ndërtimit.

Karakteristikë identifikuese e komunës se Kamenicës janë tri tërësi hapësinore te cilat dallojnë nga natyra e tyre e zhvillimit mjedisor dhe shfrytëzimi i tokës. Rrjedhimisht, potencimi i veçorive dhe pikave te përbashkëta përmes funksionit të tërësive hapësinorë është i domosdoshëm për arritjen e Vizionit, qëllimeve dhe objektivave të komunës. Ne këtë kontekst, ky dokument i ka identifikuar tri tërësitë hapësinore, tërësia dinamike komunale, tërësia Malësisë dhe tërësia e Rrafshit. Veçoritë e këtyre tri tërësive njëherit paraqesin edhe potencialin për zhvillim të ardhshëm. Përderisa, kusht themelor është integrimi - krijimi i lidhjeve funksionale dhe infrastrukturore - ndërmjet tërësive hapësinore që mundëson shfrytëzimin e qëndrueshëm dhe arritjen e efekteve më të mira ekonomike.




Harta 30 Harta e tërësive hapësinore

### Tërësia dinamike komunale

Kjo tërësi hapësinore përbëhet nga vendbanimi urban Kamenica, si dhe vendbanimet e përafërta Berivojcë, Koretin, Topanicë, Hodonoc. Rogaçicë, Muçiverc te cilat ofrojnë kushte për zhvillim te shërbimeve kyçe dhe biznesit. Kjo tërësi hapësinorë konsiderohet të ketë potencialin më të madh për një zhvillim më të hovshëm ekonomik. Në këtë pjesë janë të koncentruar pjesa më e madhe e shërbimeve, infrastrukturës, etj. Zhvillimet e ardhshme duhet të kenë kushte për avancim të disa prej veprimtarive te shumta ekonomike duke përfshi industrinë, bizneset, shërbimet etj. Për me tutje, duke konsideruar qe kjo tërësi hapësinore përmban një sipërfaqe të konsiderueshme të tokës bujqësore, këtu duhet te krijohen edhe kushte për kultivimin e drithërave dhe pemëve e perimeve.

Qyteti Kamenicës me promovimin e ngjarjeve kulturore dhe kapacitetet e hotelerisë do të kthejnë Kamenicën në destinacion atraktiv. Zona urbane si qendër komunale kyqe është  bartëse kryesore e zhvillimit të komunës. Është udhëheqëse e zhvillimit, social dhe ekonomik, për shkak të potencialeve, kërkesave, dhe presionit të vazhdueshëm për zhvillim.

**Tërësia Pejsazhet-Malësia**

Zhvillimi i tërësisë hapësinore të Pejsazheve-Malsia do të orientohet në intensifikimin e turizmit të qëndrueshëm, bazuar në mbrojtjen dhe promovimin e vlerave natyrore. Mjedisi natyror dhe cilësia vizuale e rritë atraktivitetin dhe potencialin zhvillimor të zonës. Prandaj është e domosdoshme që ai të ruhet dhe mirëmbahet për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të zhvillimit të turizmit. Aspekte të rëndësishme në këtë drejtim janë menaxhimi i mjedisit dhe kontrolli i zhvillimit krahas sigurimit të infrastrukturës së transportit. Veprimtaritë ekonomike kyçe për zhvillim në këtë tërësi hapësinore janë: pylltaria, turizmi, bujqësia, blegtoria, industria e ambalazhimit të ujit, dhe industria e përpunimit të drurit.

**Pylltaria** si veprimtari duhet praktikuar prerje të kontrolluar dhe politika pro-aktive të pyllëzimit. Duhet te stimulohen krijimi i kushteve për prodhimtari të vogla të zdrukthëtarisë dhe prodhimit të biomasës për ngrohje – për shërbim rezidencial, pra prodhim energjie nga burimet e qëndrueshme.

**Turizmi** si veprimtari për aktivitete rekreative dhe ato qe stimulojnë turizmin alternativ. Aktivitetet të cilat mund të zhvillohen këtu janë ecja, shëtitja, çiklizmi, alpinizmi, kampimi dhe gjuetia, gjithsesi ne forma te kontrolluara duke pas kujdes të shtuar për ndikimet potenciale negative, sidomos për aktivitetin e gjuetisë.

Duhet të promovohet turizmi ambiental bazuar në asetet e trashëgimisë natyrore që do të akomodon zhvillime të intensitetit të ulët të orientuara në agroindustri, industri e lehët dhe biznese të vogla. Gjatë zhvillimit të kapaciteteve turistike duhet të sigurohet që natyra, shkalla dhe pamja e zhvillimit të jenë të përshtatshme dhe të ndjeshme ndaj mjedisit natyror dhe karakterit rural të zonës. Lidhur me këtë rëndësi kyçe kanë aspektet e tilla si menaxhimi i mjedisit, kontrolli i zhvillimit dhe standardet arkitekturore. Objektet e karakterit përkohshëm (tërësisht me materiale te përkohshme dhe miqësore ndaj mjedisit) dhe shërbimet përkatëse tipike të turizmit që mund të zhvillohen në këtë tërësi hapësinore përfshijnë:

- Shtëpitë mikpritëse (vilat malore)/ fjetje me mëngjes
- Qendrat e konferencave dhe trajnimeve
- Restorantet
- Qendra rehabilituese shëndetësore
- Qendra rekreativo sportive

**Bujqësia** mjekuese si veprimtari ekonomike mundëson kultivimin e bimëve të ndryshme mjekësore të cilat mund të përdoren në industrinë farmaceutike.

**Blegtoria** si veprimtari ekonomike duhet te zhvillohet edhe ne afërsi te vendbanimeve rurale. Përkrahja e blegtorisë duhet të fokusohet në rritjen e numrit të bagëtisë dhe më pas edhe rritjen e prodhimtarisë blegtorale duke synuar eko-produkte që do të ishin shumë konkurruese në treg.

**Industria e ambalazhimit te ujit.** Malësia e Kamenicës njihet për burime të pasura me ujë kualitativ të pijes, ku viteve të fundit është vërejtur një hov i zhvillimit të industrisë së ambalazhimit të ujit të pijes.

**Industria e përpunimit të drurit.** Komuna e Kamenicës njihet për sipërfaqe të pasura me pyje të larta, prandaj edhe ka pasur një zhvillim të NVM-ve qe bejne përpunimin e produkteve drurit.

**Tërësia Bujqësia-Fusha**

Zhvillimi i tërësisë hapësinore Bujqësia-Fusha duhet ta promovoj karakterin rural, përderisa zgjerimi i fshatrave duhet të kufizohet në nivel të nevojave për shtim natyror të popullsisë dhe me fokus të ruajtjes së tokës bujqësore. Zhvillim më intensiv planifikohet në nën-qendra, në kuadër të kufijve të përcaktuar të zgjerimit. Duhet te promovohet intensifikimi i prodhimtarisë bujqësore dhe blegtorale, ngritjen e pikave për grumbullimin dhe distribuimin e produkteve bujqësore, si dhe kapaciteteve të vogla përpunuese në kuadër të ekonomive bujqësore. Nën-qendrat e kësaj zone mund të zhvillohen kapacitete të vogla përpunuese në ferma dhe punkte të ruajtjes së produkteve bujqësore. Funksionet kyçe për zhvillim në këtë tërësi hapësinore janë bujqësia, industria dhe veprimtari të lehta ekonomike. Në këtë zonë është planifikuar ndërtimi i Pendës së Desivojcës, e cila do ta ketë edhe funksionin e ujitjes. Gjithashtu planifikohet të ndërtohet edhe kanali i ujitjes i cili është paraqitur në Hartën e sistemit të ujitjes dhe drenazhimit nr. 31.

Duhet të theksohet që Zona Mbrojtëse përreth sipërfaqes ujore të Pendës (zona buffer 500m), siç është paraqitur në hartën e shfrytëzimit të tokës nr. 34, dhe në Hartën e sistemit të ujitjes dhe drenazhimit nr. 32, ka ndryshuar sipërfaqën e saj para dhe pas shqyrtimit publik. Ky ndryshim është bazuar në të dhënat e Departamentit të Ujërave, MMPHI, të cilat janë marr vetëm pas përfundimit të shqyrtimit publik.

Ne vijim, janë radhitur hartat e planifikuara te Planit Zhvillimor komunal 2025-2033:




Harta 33 Harta e tërësive hapësinore




Harta 34 Harta e zhvillimit hapësinor të planifikuar




Harta 35 Harta e shfrytëzimit të planifikuar të tokës_ZONA URBANE




Harta 36 Harta e shfrytëzimit të planifikuar të tokës Komuna Kamenicë




Harta 37 Harta e planit të zhvillimit ekonomik




Harta 38Harta e planit të infrastrukturës së transportit




Harta 39 Harta e planit të transportit urban dhe rural




Harta 40 Harta e planit të energjisë elektrike dhe termike




Harta 41 Harta e planit të hapësirave sportive




Harta 42Harta e planit të hapësirave të hapura publike dhe të gjelbra



Harta 43 Harta e planit për menaxhimin e mbeturinave dhe riciklim



Harta 44 Harta e planit për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore




Harta 45 Harta e planit për mbrojtjen nga rreziqet natyrore




